

DEÇANI



**Draft- Plani i Veprimit Komunal për Energjinë dhe Klimën (PVKEK) 2023 - 2030**

Nëntor 2022



Implemented by  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

**Deklarim:**

Ky Plan është mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Energji në bashkëfinancim me Komunën e Deçanit.

Studimi, mbledhja e të dhënave dhe hartimi i planit është realizuar nga [Shoqata për Efikasitet të Energjisë së Ripërtitshme](#) (SH.E.E.R). Pikëpamjet e hartueseve të këtij plani (SH.E.E.R) si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

## Përmbledhje

1.Hyrje .....	7
1.1Kontekst .....	7
1.1.1 Objektivi i PVKEK .....	7
1.1.2 Kuadri ligjor dhe politik - PVKEK.....	8
1.1.3 Aktivitetet dhe procesi përgatitor.....	9
1.1.4 Zhvillimi i PVKEK .....	11
1.1.5 Zbatimi i PVKEK dhe përfitimet e pritshme .....	14
1.1.6 Miratimi si dokument zbatues - PVKEK.....	15
1.1.7 Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit dhe raportimi - PVKEK.....	15
2.Përmbledhje e plotë.....	16
2.1 NDRIÇIMI PUBLIK .....	17
2.2 SEKTORI I BANIMIT .....	18
2.3 Sektori Komercial .....	18
2.4 Sektori bujqësisë .....	18
2.5 Sektori Transporti .....	19
2.6 POTENCIALI I KURSIMIT SIPAS PVKEK .....	19
3. Informacioni bazë për komunën e Deçanit .....	19
3.1 Pozicioni dhe topografia - PVKEK.....	20
3.2 klima Lokale .....	21
3.3 Popullsia dhe vendbanimet .....	21
3.4 Struktura administrative lokale dhe ajo organizative për zbatimin e Planit të veprimit Për energji dhe të klimës (PVKEK).....	22
3.5 Rëndësia me politikat vendore, kombëtare dhe të tjera përfshirja e autoriteteve lokale	24
3.6 Përvoja në zbatimin e Masave të eficientë të energjisë.....	25
4.Treguesit e energjisë komunale (furnizimi dhe prodhimi i energjisë komunale) .....	25
4.1 Elektricitet.....	25
Furnizimi me elektricitet.....	25
4.2 Fosilet djegëse.....	27
Diesel .....	27
Gasolinë .....	27
Naftë e rëndë .....	27
LPG .....	27
Qymyr - linjit .....	27
Biomasa.....	28

Dru zjarri.....	29
Pelet.....	29
Nga ngrohja qendrore .....	29
Prodhimi i energjisë sipas sektorëve.....	30
5. Analiza e konsumit të energjisë sipas sektorëve.....	30
5.1 Konsumi i energjisë në ndërtesat në pronësi komunale.....	32
5.1.1 Ndërtesat administrative .....	32
5.2 Konsumi i energjisë në ndërtesa e arsimit .....	33
5.3 Konsumi i energjisë në ndërtesat e kujdesit shëndetësor.....	35
5.4 Konsumi i energjisë në ndërtesat e kulturës dhe sportit .....	35
5.5 Konsumi i energjisë në ndriçimin publik të rrugëve.....	36
5.6 ANALIZA PËRFUNDIMTARE E SEKTORIT TË NDËRTESAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT.....	36
6. Konsumi i energjisë në shërbimet publike.....	37
6.1 Konsumi i energjisë në Furnizimin me ujë.....	37
6.2 Konsumi i energjisë në sektorin e Mbledhjes së Mbeturinave .....	38
6.3 Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë .....	38
6.4 Konsumi i energjisë në sektorin e transportit .....	38
6.4.1 Flota komunale.....	39
6.4.2 Transporti publik (nëse komuna ka kompani publike) .....	40
6.4.3 Konsumi total i energjisë në transportin publik.....	41
6.4.4 Automjetet personale dhe komerciale.....	42
7. Objektivat dhe shënjestrimet lokale.....	48
7.1 Reduktimet e gazrave serrë.....	49
7.2 Energji e rinovueshme .....	50
7.3 Efiçienca e energjisë .....	51
7.4 Varfëria energjetike .....	51
7.5 Analizat e Emetimeve të gazrave serrë.....	52
7.5.1 Inventari referencial i CO <sub>2</sub> .....	52
8. Politikat dhe masat për përmirësimin e efiçencës të energjisë, emetimi, BRE dhe GS.....	54
8.1 Politikat dhe masat lokale .....	55
8.2 Masat e efiçencës së energjisë .....	55
8.2.1 Masat për efiçencë të energjisë në ndërtesat e banimit.....	56
9. Zbatimi i masave të EFIÇENCËS SË ENERGIJISË në ndërtesat administrative, arsimit dhe shëndetsise .....	60

9.1	Sektori i KULTURËS DHE SPORTIT.....	68
9.2	Ndriçimi publik i rrugëve.....	68
9.3	Furnizimi me ujë dhe sektori i ujërave të zeza .....	69
9.4	Mbledhja e mbeturinave/sektori i menaxhimit .....	70
9.5	Bujqësia.....	71
9.6	TRANSPORTI.....	72
9.7	Flota komunale.....	73
9.8	Transporti publik.....	73
9.9	Automjete private dhe komerciale .....	75
10.	Masat e BRE .....	76
10.1	Sektori i banimit.....	76
10.2	Sektori publik.....	81
10.3	sektori i bujqësisë.....	82
10.4	sektori i transportit .....	83
10.6	Masat ndërsektoriale - ngritja e Vetdies, informacioni dhe ngritja e kapaciteteve.....	83
10.7	Masat Per reduktimit të gazrave serrë nga viti 2030 në Komunën e Deçanit.....	85
	10.7.1 reduktimin e gazrave ser gjer ne vitin 2030 per skenarin biznes si ZAKONISHT(BSZ).....	85
10.8	Vlerësimi i emisioni të CO2 në vitin 2030 për sektorin e transportit .....	86
	10.8.1 Vlerësimi i emisioneve të CO2 gjer në vitin 2030 për sektorin e ndërtesave.....	88
	10.8.2 Vlerësimi i emisioneve totale të CO2 gjer në vitin 2030 në skenarin BSZ .....	90
	10.8.3 Vlerësimi i emisioni të CO2 gjer në vitin 2030 për skenarin me masa .....	91
	10.8.4 Vlerësimi i emisioneve të CO <sub>2</sub> gjer në vitin 2030 për sektorin e ndërtesave .....	91
	10.8.5 Vlerësimi i emisioni të CO <sub>2</sub> gjer në vitin 2030 për sektorin e transportit.....	92
	10.8.6 Vlerësimi i emisioneve totale të CO2 nga viti 2030 ne skenarin me masa.....	93
	10.8.7 Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO <sub>2</sub> në vitin 2030 në bazë të skenarëve.....	93
	10.8.8 Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO <sub>2</sub> në vitin 2030 në bazë të skenarëve për sektorin e ndërtesave.....	93
	10.8.9 Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO2 në vitin 2030 në bazë të skenarëve për sektorin e transportit .....	94
11.	Plani i veprimit.....	97
	11.1 ZBATIMI I MASAVE TË POLITITKAVE LOKALE, TË PROMOVIMIT DHE NDRYSHIMIT TË SHPREHIVE E SJELLJES .....	97
	11.2 ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGIJISË NË SEKTORIN PUBLIK .....	98

11.3 Zbatimi i masave në bujqësi .....	98
11.4 Zbatimi i masave në transport.....	98
11.4.1 Automjetet komunale.....	99
11.4.2 transporti publik.....	99
Zbatimi i masave ne sektorin e banimit .....	99
12. Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e PVKEK/Planit të Veprimit .....	100
12.1 Menaxhimi i energjisë komunale (mund të përdoret nga skema e menaxhimit të energjisë, e përgatitur nga GIZ) - PVKEK .....	100
12.2 Koordinimi – PVKEK.....	101
12.3 Raportimi .....	101
12.4 Monitorimi dhe raportimi i brendshëm - PVKEK .....	105
12.5 Raportimi te qeveria qendrore (KEEA)- (mvp- software)- PVKEK .....	105
13. Modeli dhe burimet e financimit të zbatimit të masave të Efiçencës së Energjisë - PVKEK dhe PVKEK .....	105
13.1 Financimi me Buxhetin Komunal .....	106
13.2 Financimi nga Buxheti i Qeverisë Qendrore .....	106
13.3 Financimi nga donatorët dhe kredit .....	107
13.4 Financimi nga BE- .....	107
14. Përmbyllje.....	108
15. Referenca .....	108

## 1.HYRJE

### 1.1KONTEKST

#### 1.1.1 OBJEKTIVI I PVKEK

Plani Komunal i Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) është dhënia e kontributit domethënës për zvogëlimin e CO<sub>2</sub> të emetuar në nivel Komunal përmes masave të EE, BRE dhe promovimit që kontribuon edhe në nivel vendi, edhe në arritjen e caqeve të eficiencës së energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Planet e tilla të veprimit mund të konsiderohen si zhvillim pasues pas një periudhe të implementimit të Planeve Komunale të Veprimit për Eficiencë të Energjisë hartimi dhe implementimi i të cilave është obligim komunal që buron nga Ligji për Eficiencë të Energjisë 06/L-079, tani PVKEK do të jetë parapërgatitje për PNEK si dhe për periudhat afatmesme të monitorimit dhe raportimit.

Përfitimi parësor i Komunave nëpërmjet zhvillimit dhe implementimit të PKVEK është kursimi i energjisë përkatësisht diversifikimi i formave të prodhimit të energjisë me fokus në burimet e ripërtëritshme dhe në këtë mënyrë përmirësimi i mjedisit në nivel komunal dhe atë kombëtar si rezultat i zvogëlimit të emitimit të CO<sub>2</sub>. Përfitime tjera anësore të cilat do të rezultojnë në këtë rast për komunat kanë të bëjnë me:

- Zhvillimin lokal ekonomik
- Përmirësimin e infrastrukturës energjetike komunale
- Rritjen e cilësisë së ndërtimeve nëpërmjet zbatimit të standardeve përkatëse në kontekstin e performancës energjetike të ndërtesave
- Përmirësimin e shërbimeve publike lidhur me energjinë dhe mjedisin
- Përmirësimin e kushteve dhe komfortit të banimit në territorin e Komunës
- Zvogëlimi i emetimeve të CO<sub>2</sub> në të gjithë sektorët duke zbatuar masat e eficiencës së energjisë, duke përdorur burimet e ripërtëritshme të energjisë, duke menaxhuar konsumin, përmes trajnimit dhe masave të tjera;
- Ngritja e vetëdijes e kreatorëve të politikave për kursim të energjisë, operatorëve dhe përdoruesve fundor.

Nëpërmjet implementimit të suksesshëm të PKVEK, komuna e Deçanit përpos arritjes së caqeve afatshkurtra në kuptimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji ka për synim të bëjë progres domethënës drejt vizionit të saj për komunë të pastër, energjetikisht të qëndrueshme dhe ekonomikisht të zhvilluar duke u bazuar në parimet e ekonomisë së gjelbër dhe të riciklimit.

### 1.1.2 KUADRI LIGJOR DHE POLITIK - PVKEK

Hapat e parë drejt krijimit të Politikave Energjetike të Kosovës janë bërë në vitin 2004 me përshtatjen e tri ligjeve bazike për energjinë, Ligji mbi Energjinë, Ligji mbi Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Një progres substancial drejt krijimit të një kornize të qëndrueshme ligjore për energjinë është arritur pas nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore në vitin 2005. Gjatë dekadës së kaluar disa dokumente ligjore janë miratuar dhe ndryshuar në mënyrë që legjislacioni për energjinë të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-s. Korniza ligjore për energjinë në Republikën e Kosovës përbëhet prej dokumenteve strategjike, ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve administrative.

#### **-Ligjet dhe rregulloret kombëtare**

Ligjet në lidhje me Eficiencën e Energjisë

Ligji 05 / L-081 për Energjinë

Ligji 05 / L-085 për Energjinë Elektrike,

Ligji 06 / L-079 për Eficiencën e Energjisë,

Ligji 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa

Ligji 05/L 052 -për Energjinë Termike

Ligji 03 / L-116 për Ngrohje Qendrore

Ligji 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

Ligji 04/L-110 për Ndërtim

Ligji 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit

Ligji 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale

#### **Udhëzimet Administrative**

Udhëzim administrativ (MEA) Nr. 03/2020 lidhur me kërkesat për Eficiencën e Energjisë për blerjen e produkteve shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror.

Udhëzim administrativ (MZHE) Nr. 01/2017 për promovimin e investimeve të përbashkëta rajonale në sektorin e energjisë.

Udhëzim Administrativ (MEA) Nr. 10/2020 për metodat dhe parimet e përbashkëta për llogaritjen e ndikimit të Eficiencës së Energjisë.

Udhëzim Administrativ (ME) Nr.05\_2021 për kornizën e përgjithshme të Raportimit për Eficiencë të energjisë.

Udhëzim Administrativ (ME) Nr.06\_2021 për shërbimet e energjisë (ESCO)

Udhëzimi Administrativ nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë



Udhëzimi Administrativ nr. 14/2012 për promovimin e eficiencës së energjisë të përdoruesit fundor dhe shërbimet energjetike;

Udhëzimi Administrativ nr. 09/2012 për pajisjet e etiketimit që përdorin energjinë

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2012 për Auditimin e Energjisë;

Udhëzimi Administrativ nr. 05/2017 për Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme;

Udhëzimi Administrativ nr. 06/2017 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme;

## **Rregulloret**

Rregullore (MEA) Nr.01/2020 për Kriteret Minimale për Auditimet e Energjisë Përfshirë ato të Kryera si Pjesë e Sistemeve të Menaxhimit të Energjisë

Rregullore (MEPTINIS) Nr. 05/2020 për sistemin e ofruesve të shërbimit energjetik dhe kriteret minimale për auditimin energjetik

Rregullore (MEA) Nr.02/2020 Për Kërkesat Minimale për Faturimin dhe Informacionin e Faturimit Bazuar në Konsumin Aktual

Rregullorja nr.02/18 për Metodologjinë Kombëtare për Kalkulimin e Performancës së Integruar Energjetike të Ndërtesave;

Rregullorja nr.03/18 për Procedurën e Çertifikimit të Përformancës Energjetike në Ndërtesë;

Rregullorja nr.04/18 për Kërkesat Minimale të Përformancës Energjetike të Ndërtesave;

### **1.1.3 AKTIVITETET DHE PROCESI PËRGATITOR**

Hapi fillestar për përgatitjen e PVKEK është gatishmëria përkatësisht tregimi i vullnetit politik nga ana e kreut komunal. Kjo nënkupton që parakusht i realizimit të nismës për përgatitjen e PVKEK me rëndësi vendimtare është sigurimi i mbështetjes nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës së Deçanit. Me hartimin e draftit të PVKEK Komuna e Deçanit do të ketë mundësi edhe të përafimit të nismës së Konventës së Kryetarëve tregon një qëndrim pozitiv të Qeverisë Komunale drejt zhvillimit të qëndrueshëm energjetik të Komunës së Deçanit, por ky është vetëm hapi i parë në këtë drejtim. Për arritjen e caqeve që përkojnë me zhvillimin e qëndrueshëm energjetik, është e domosdoshme të ndërmerren veprime tjera, ndër të cilët më të rëndësishmet janë sigurimi i resurseve njerëzore dhe fondeve të nevojshme financiare. Këtu

duhet shtuar që kthimi i investimit financiar do të realizohen kryesisht nëpërmjet kursimit të energjisë si rezultat i zbatimit të masave lidhur me përmirësimin e efikasitetit të energjisë, BRE-ve dhe reduktimin e CO<sub>2</sub>, të cilat janë pjesë e PVKEK. Për këtë arsye, , përgjegjësit kryesor të qeverisë komunale duhet të përfshihen në mënyrë aktive dhe qysh në fillim në procesin e zbatimit të këtij dokumenti të rëndësishëm komunal. Ata, në kuadër të drejtave dhe autorizimeve të tyre, duhet të japin mbështetje në të gjitha fazat e zbatimit të procesit, sepse vetëm me mbështetjen e tyre të plotë është i mundur zbatimi i suksesshëm dhe cilësor i PVKEK-s gjer në vitin 2030.

Detyrat e qeverisë komunale në realizimin e PVKEK-s janë si vijojnë:

- Integrimi i suksesshëm i objektivave dhe masave të PVKEK-s në strategjinë e zhvillimit të tërësishëm të Komunës së Deçanit;
- Sigurimi i kuadrit profesional për zbatimin e kursimeve të energjisë, aplikimin e masave të efikasitetit të energjisë, zhvillimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe lëndëve djegëse ekologjike të pranueshme;
- Sigurimi i mjeteve financiare për zbatimin e PVKEK;
- Monitorimi i vazhdueshëm i realizimit të kursimeve të energjisë dhe kursimeve financiare;
- Mbështetje e zbatimit të masave të parapara në gjithë periudhën e paraparë të zbatimit PVKEK, pra deri në vitin 2030;
- Raportimit lidhur me dinamikën e zbatimit PVKEK deri në vitin 2030;
- Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve lidhur me shkallën e zbatimit të PVKEK;
- Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të të gjithë akterëve të rëndësishëm dhe qytetarëve në tërë periudhën e zbatimit të PVKEK
- Si vlere e shtuar e këtij plani është edhe mundësia për përfshirjen në rrjetin e qyteteve që kanë nënshkruar Konventën e Kryetareve të komunave me qëllim të shkëmbimit të përvojave të vazhdueshme pozitive dhe promovimit të energjisë ndërmjet tyre me qëllim të zhvillimit të zonave të energjisë.

Përfundimi i suksesshëm i procesit lidhur me PVKEK nënkupton zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e PVKEK-s, në ç' rast do të përfitojë Komuna e Deçanit dhe qytetarët e saj, por edhe do të forcohet pushteti politik i administratës së Komunës, e cila nëpërmjet zbatimit të suksesshëm të gjithë procesit, do të arrijë të:

- Demonstron përkushtimin e saj për zhvillim të qëndrueshëm energjetik të Komunës së Deçanit në koherencë me parimet e mbrojtjes së mjedisit, rritjen e efikasitetit të energjisë dhe zhvillimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë, që paraqesin tri shtyllat e qëndrueshmërisë energjetike në shekullin 21;
- Vendos themelet për një zhvillim të qëndrueshëm energjetik të Komunës së Deçanit;
- Inicijon mekanizma të rinj të financimit për zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në Komunën e Deçanit;

- Paraqet pasqyrën afatgjatë të konsumit me energji për Komunën e Deçanit;
- Përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve (përmirësimi i cilësisë së ajrit, furnizimi stabil me energji, zvogëlimi i bllokimit të trafikut, përmirësimi i ndriçimit publik të rrugëve dhe shesheve etj.).

Nga zhvillimi dhe zbatimi i suksesshëm i PVKEK, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthorët do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Komunës së Deçanit të cilët duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në të gjitha fazat e zbatimit të këtij dokumenti nëpërmjet palëve të interesuara.

Përfshirja sa më e gjerë e palëve të interesuara është hapi i parë në procesin e ndryshimit të qëndrimit dhe sjelljes së qytetarëve në lidhje me energjinë.

Procesi i zhvillimit dhe zbatimit të PVKEK duhet të përfshijë të gjithë akterët:

- Interesi të cilëve në ndonjë mënyrë lidhet me PVKEK;
- Aktivitetet e të cilëve në ndonjë mënyrë kanë ndikim në PVKEK;

Hapi i parë është identifikimi i akterëve, dhe hapi tjetër është përcaktimi i roleve të tyre të veçanta në zhvillimin e PVKEK-s, zbatimin dhe monitorimit e procesit.

#### 1.1.4 ZHVILLIMI I PVKEK

PVKEK përbëhet nga 10 aktivitete të rëndësishme:

1. Përcaktimi i afatit kohor për zbatimin e PVKEK përmes përzgjedhjes së vitit bazë (referent ) është viti 2017;
2. Klasifikimi i konsumatorëve të energjisë në Komunën e Deçanit sipas sektorëve;
3. Analizimi i konsumit të energjisë sipas sektorëve;
4. Përcaktimi i sektorëve me prioritet për veprim, bazuar në rezultatet e analizës të konsumit të energjisë;
5. Zhvillimi i inventarit të emisioneve bazë të CO<sub>2</sub> (IEB);
6. Zhvillimi i PVKEK i cili synon arritjen e zvogëlimin të emisioneve të CO<sub>2</sub> për së paku 40% gjer në vitin 2030;
7. Përcaktimi i orarit dhe programit të zbatimit të PVKEK-s;
8. Përcaktimi i mekanizmave të financimit për zbatimin e PVKEK-s;
9. Zhvillimi i potencialit të BRE-ve dhe masave të EE për të gjithë sektorët e konsumit të energjisë
10. Krijimi i kornizës ligjore për zbatimin e PVKEK-s

Mund të thuhet se ekzistojnë 5 aktivitete kryesore të zhvillimit të PVKEK në përputhje me metodologjinë e KE të cilat janë prezantuar më poshtë.

## **5 Aktivitetet kryesore të zhvillimit të PVKEK-s në përputhje me përmbajtjen e draft PVKEK**

*Krijimi i strukturës komunale për zhvillimin e PVKEK*

*Përcaktimi i vitit referent 2017*

*Analiza e konsumit të energjisë në ndërtesa, transport dhe sektorin e ndriçimit publik*

*Përgatitja e Inventarit të emisioneve të CO2*

*Identifikimi i masave për përmirësimin e EE përkatësisht zvogëlimin e emisioneve të CO2 gjer në vitin 2030 për së paku 40 %*

*Burimet e ripërtëritshme të energjisë*

Veprimi i parë që duhet bërë për zhvillimin e PVKEK të Komunës së Deçanit është përcaktimi vitit referent (viti bazë), për të cilën do të përgatitet Inventari referent i Emisioneve të CO2. Afati kohor për implementimin e PVKEK, është periudha mes vitit referent dhe vitit 2030. Zbatimi i PVKEK duhet të bëhet brenda kësaj periudhe, dhe si rezultat duhet të arrihet zvogëlimi i emitimit të CO2 për së paku 40 % deri në vitin 2030, krahasuar me emitimin CO2 në vitin referent.

Komisioni Evropian rekomandon që viti 1990 duhet të merret si vit referent, nëse komuna e ka informacionin e kërkuar mbi konsumin e energjisë dhe emisionet e CO2. Nëse komuna nuk i ka të dhënat e kërkuara për vitin 1990, rekomandohet që si vit referent të merret viti për të cilin Komuna i ka në dispozicion të dhënat e kërkuara.

Bazuar në diskutimin e realizuar me ekipin e Komunës së Deçanit, në takimin fillestar më 06.08.2022, është konstatuar se viti 2017 është viti në të cilin komuna ka arritur të siguroj të dhëna të besueshme lidhur me konsumin e energjisë në sektorët që kërkohen. Rrjedhimisht, si vit referent për zhvillimin e PVKEK në komunën e Deçanit është vendosur të merret viti 2017 në takimet me grupin punues për Draft hartimin e PVKEK.

Sa i përket konsumatorëve të energjisë në Komunën e Deçanit, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian, të njëjtit janë të kategorizuar në tre sektorë:

11. Ndërtesat;
12. Transporti;
13. Ndriçimi publik.

Me qëllim të trajtimit më të detajuar, sektori i ndërtesave më tej është ndarë në tre nënsektorët e mëposhtëm:

14. Ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit;
15. Ndërtesat e sektorit komercial dhe të shërbimeve (zyrat e kompanive private, bankave, veprimtarive tregtare, shkollave private, shërbimeve mjekësore private etj.);
16. Ndërtesat e banimit.

Ndërsa sektori i transportit është ndarë në tre nënsektorët vijues:

17. Flota komunale e automjeteve në pronësi të Komunës së Deçanit;
18. Transporti publik në Komunën e Deçanit;
19. Automjete private dhe komerciale.

Sektori i ndriçimit publik nuk ka nevojë të ndahet në nënsektor, për shkak të thjeshtësisë së tij.

Një hap tjetër i rëndësishëm për analizimin e konsumit të energjisë në sektorët dhe nënsektorët e përcaktuar është procesi i mbledhjes së të dhënave. Të dhënat e besueshme janë parakusht i një analize të mirëfilltë të konsumit të energjisë në të gjithë sektorët dhe nënsektorët dhe bazuar në rezultatet e një analize të tillë do të mund të përcaktohet Inventari i Emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin referent. Rrjedhimisht ***grumbullimi dhe përpunimi sistematik i të dhënave të mbledhura është një nga aktivitetet më komplekse dhe më të rëndësishme në procesin e zhvillimit të PVKEK.***

Me qëllim të analizimit të konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave, përkatësisht në të gjithë nënsektorët e ndërtesave, nevojitet grumbullimi i të dhënave vijuese për vitin 2017:

20. Numri i ndërtesave dhe karakteristikat e tyre;
21. Konsumi energjisë elektrike;
22. Konsumi i energjisë për ngrohje nga sistemi i ngrohjes në largësi (ngrohjes nga qyteti);
23. Konsumi i lëndëve të tjera djegëse për ngrohje (dru zjarri, nafta, qymyri etj.).

Në anën tjetër, të dhënat të cilat nevojitet për të analizuar konsumin e energjisë në sektorin e transportit, për vitin 2017 janë:

24. Struktura e flotës komunale të automjeteve në pronësi të Komunës së Deçanit, sipas llojit të karburantit;
25. Struktura dhe karakteristikat e transportit publik në Komunën e Deçanit;
26. Numri dhe lloji i automjeteve të udhëtarëve dhe atyre komerciale (automjeteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive biznesore);
27. Konsumi i llojeve të ndryshme të karburantit për flote komunale e automjeteve në pronësi të Komunës së Deçanit;
28. Konsumi i llojeve të ndryshme të karburanteve për transport me autobus në Komunën e Deçanit.

Bazuar në numrin dhe llojin e automjeteve të udhëtarëve dhe atyre komerciale (automjeteve në pronësi private), do të vlerësohet kilometrazhi dhe konsumi i llojeve të ndryshme të karburantit.

Për dallim nga dy sektorët paraprak, analiza e konsumit të energjisë në sektorin e ndriçimit publik në Komunën e Deçanit është më e thjeshtë. Për këtë lloj analize janë të nevojshme të dhënat e mëposhtme:

29. Struktura dhe karakteristikat e rrjetit të ndriçimit publik (numri i llambave, lloji dhe karakteristikat, distanca midis shtyllave të ndriçimit etj.);
30. Konsumi i energjisë elektrike në komunë në vitin referent.

Kosova si pale nënshkruese e Traktatit të Komunitet të Energjisë ka marr obligime në përmirësimin e energjisë, ruajtjen e mjedisit, zbatimin e masave të EE dhe BRE, që kontribuojnë edhe në reduktimin e CO<sub>2</sub>. Bazuar në të dhënat e emisioneve të CO<sub>2</sub> për sektorë përkatësisht nënsektorë të ndryshëm të konsumit të energjisë në komunë, analizat e energjisë për vitin 2017, bilancet kombëtare të konsumit të viteve të kaluara, parashikimin konsumit të energjisë për periudhën gjer më 2030 si dhe bazuar në dokumentet zyrtare të Komunës së Deçanit (Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë të Komunës së Deçanit 2015 - 2020, Planin Zhvillimor Urban, Planin Zhvillimor Komunal, Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2012-2017), duhet të identifikohen masat dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren për rritjen e eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë me qëllim të zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> për më shumë se 40% gjer në vitin 2030.

Për të identifikuar masat dhe aktivitetet, zbatimi i të cilave rezultojnë në reduktim të ndjeshëm të emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 me parametra të kënaqshëm ekonomik dhe energjetik, do të përpunohen parametrat e mëposhtëm lidhur me masat e propozuara për kursimin e energjisë:

31. Kursimet e mundshme të energjisë gjer në vitin 2030;
32. Afati dhe orari i zbatimit;
33. Mundësitë e financimit;
34. Kostot e zbatimit;
35. Reduktimi potencial i emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030.

Duhet theksuar se një nga aspektet më të rëndësishme të PVKEK-s është harmonizimi i tij me kornizën ligjore. Të gjitha masat dhe aktivitetet e propozuara duhet të harmonizohet me legjislacionin përkatës të Komunës së Deçanit, të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

### 1.1.5 ZBATIMI I PVKEK DHE PËRFITIMET E PRITSHME

Zbatimi i masave të identifikuar për përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe BRE, këto aktivitete do të rezultojnë në zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub>, gjer në vitin 2030, është faza më e vështirë e procesit të zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të PVKEK-s, aktivitet ky që kërkon kohë dhe përpjekje, si dhe burime të konsiderueshëm financiare. Miratimi i PVKEK-s si dokument zyrtar shënon fillimin e zbatimit të tij, proces ky shumë kompleks që varet nga faktorë të ndryshëm ekonomik, social dhe teknik si dhe që kërkon organizim dhe bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë ndërmjet shumë palëve të interesuara në komunë.

Parakusht i koordinimit të suksesshëm është hartimi dhe zbatimi i një strategjie efektive të komunikimit në dy nivele. Në nivelin e parë është shkëmbimi i vazhdueshëm i informatave që duhet të sigurohet ndërmjet zyrave të ndryshëm të Komunës, shërbimeve dhe departamenteve, pra në mes të gjitha subjekteve të përfshira në zbatimin e projekteve të eficiencës së energjisë dhe personave përgjegjës për zbatimin e projekteve (projektantëve, ndërtuesve, etj).

Në nivelin e dytë, informatat lidhur me të gjitha aktivitetet gjatë implementimit të PVKEK duhet t'iu komunikohen qytetarëve dhe grupeve të interesit. Komunikimi i mirë si dhe përvoja e duhur profesionale dhe aftësitë e anëtarëve të grupit punues, janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të PVKEK.

### 1.1.6 MIRATIMI SI DOKUMENT ZBATUES - PVKEK

Pranimi i PVKEK si dokument zyrtar detyruar në Komunën e Deçanit është elementi kyç për zbatimin e tij të suksesshëm dhe, në fund, arritjen e zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030. Për këtë arsye, është e rëndësishme që njerëzit kryesor nga ekzekutivi i Komunës të janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të PVKEK. Për më tepër, është gjithashtu shumë e rëndësishme që të krijohet një zyrat për energjisë sipas Udhëzimi Administrativ nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë si organ këshillëdhënës që do të monitoroj dhe vlerësoj të gjitha fazat e realizimit të PVKEK. Pasi Këshilli i Energjisë ta miraton PVKEK si dokument teknikisht të qëndrueshëm dhe praktikisht të obligueshëm, administrata e Komunës duhet ta shpall atë dokument si dokument zyrtar të obligueshëm, gjë që është një parakusht për zbatimin e tij.

#### ***Zbatimi i PVKEK***

Hapi i parë i zbatimit të PVKEK, është krijimi i grupit punues për zbatimin e PVKEK (në tekstin në vijim grupi punues) dhe emërimi i koordinatorit të grupit. Detyra kryesore e grupit punues është që të koordinojë procesin e implementimit të PVKEK. Parakusht i koordinimit të suksesshëm është hartimi dhe zbatimi i një strategjie efektive të komunikimit në dy nivele. Në nivelin e parë është shkëmbimi i vazhdueshëm i informatave që duhet të sigurohet ndërmjet zyrave të ndryshëm të Komunës, shërbimeve dhe departamenteve, pra në mes të gjitha subjekteve të përfshira në zbatimin e projekteve të efijencës së energjisë dhe personave përgjegjës për zbatimin e projekteve (projektantëve, ndërtuesve, etj.). Në nivelin e dytë, informatat lidhur me të gjitha aktivitetet gjatë implementimit të PVKEK duhet t'iu komunikohen qytetarëve dhe grupeve të interesit. Komunikimi i mirë si dhe përvoja e duhur profesionale dhe aftësitë e anëtarëve të grupit punues, janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të PVKEK.

### 1.1.7 MONITORIMI DHE KONTROLLI I ZBATIMIT DHE RAPORTIMI - PVKEK

Faza e monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të PVKEK-s duhet të kalojë nëpër disa nivele njëkohësisht:

1. Monitorimi i afatit të zbatimit për secilën masë të identifikuar;
2. Monitorimi i performancës së zbatimit për secilën masë të identifikuar;
3. Monitorimi dhe kontrolli i kursimit të energjisë të arritur për secilën masë të identifikuar;
4. Monitorimi dhe kontrolli i kursimeve të energjisë të arritur në sektorët dhe nënsektorët e konsumit të energjisë;
5. Monitorimi dhe kontrolli i kursimit të përgjithshëm të energjisë të arritur në për të gjitha masat e zbatuara;
6. Monitorimi dhe kontrolli i zvogëlimin të emisioneve të CO<sub>2</sub> të arritur për secilën masë të identifikuar;

7. Monitorimi dhe kontrolli i zvogëlimin të emisioneve të CO2 të arritur nëpër sektorët dhe nënsektorët e konsumit të energjisë;
8. Monitorimi dhe kontrolli i zvogëlimet total të arritur të emisioneve të CO2 për të gjitha masat e zbatuara.

Zyret per energji do të monitorojë kohën e zbatimit dhe performancën e masave te zbatuara qe rezultojnë nga ky plan. Nëse shfaqet nevoja, për shkak të ngarkesës së madhe të punës Zyret per energji mund të krijojë grupin mbikëqyrës për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të PVKEK-s.

Vetëm përdorimi i një metodologjie të njëjtë, e bën te mundur krahasimin dhe i përgjigjet pyetjes nëse objektivat për vogëlimin e emisioneve të vendosura për CO2 janë duke u përmbushur.

## **2.PËRMBLEDHJE E PLOTË**

Pasi janë grumbulluar dhe përpunuar të dhënat në bashkëpunim me grupin punues të Komunës së Deçanit është vrejtur një ndryshim i të dhënave për vitin 2020 dhe 2021 në raport me vitin 2018 dhe 2019 ka rritje të konsumit të energjisë, ky ndryshim ka ardhë për shkak të masave të pandemisë, duke pasur parasysh këtë është marrviti bazë 2017, në mënyrë që rezultatet afatgjate të jenë sa më të sakta dhe stabile në të ardhmen si edhe në hartimin e PVKEK.

PVKEK paraqet nje pasqyre te kuartë lidhur me konsumin e energjisë në objektet publike komunale siç janë objektet administrative, arsimore, kulturore, shëndetësore, të ndriçimit publik dhe flotës së transportit ato Rezident.

Plani i Veprimit te Komunës për Energji dhe Klimë paraqet gjetjet dhe rekomandimet kryesore për energjinë në komunën e Deçanit, për te gjithë sektorët që konsumojnë energji si: sektori i shërbimeve, rezidencial, industri, transport, bujqesi dhe ndriçimit rrugor si sektorët më të rëndësishëm.

Përmes, Planit të Veprimit Komunal për Energji dhe Klimë, komuna e Deçanit promovon një planifikim afatmesëm për arritjen e objektivave mjedisore dhe ekonomike. Në kuadër të këtij plani, rëndësi e veçantë i është kushtuar potencialit të kursimit të energjisë, BRE, Reduktimit të CO2 dhe identifikimit të prioriteteve për investime në periudhën afatmesme.

Përmbledhje e konsumit te energjisë ne te gjithë sektorit e konsumit është paraqitur ne tab: 1, 2 dhe 3.



**Tabela 1- Potenciali i gjithmbarshëm për kursim te energjisë**

Sektori	Konsumi [MWh/vit]	Potenciali për kursim [MWh /vit]
Administrata	249.98	37.50
Arsim	3,234.72	646.94
Shëndetësi	563.67	73.28
Kulture sport	125.00	6.25
<b>Total</b>	<b>4,173.38</b>	<b>763.97</b>

Meqë një numër i konsiderueshëm i llambave, në Deçan, janë Llamba Natriumi, rekomandohet ndërrimi i këtyre llambave që do të rezultonte me kursim prej 82 MWh/vit.

## 2.1 NDRIÇIMI PUBLIK

**Tabela 2 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin endriçimit publik**

<i>Raporti i shpenzimeve para zbatimit te masave te EE</i>	
<b>Konsumi i energjisë elektrike [kWh/vite]</b>	<b>1,815,954.20</b>
<i>Çmimi i energjisë elektrike [€/kWh]</i>	0.11
<b>Kostoja vjetore e energjisë elektrike dhe mirëmbajtja [€]</b>	<b>259,754.96 €</b>
<b>Emitimi i tCO2</b>	<b>2,596.81</b>
<i>Raporti i shpenzimeve pas zbatimit te masave të EE</i>	
<b>Konsumi vjetor i energjisë elektrike [kWh]</b>	<b>1,089,572.52</b>
<b>Kursimi vjetor i energjisë elektrike [kWh]</b>	<b>726,381.68</b>
<i>Çmimi i energjisë elektrike [€/kWh]</i>	0.11
<b>Kostoja vjetore e energjisë pas zbatimit te masave te EE [ €]</b>	<b>119,852.98 €</b>
<b>Reduktimi i Emetimit te tCO2</b>	<b>1,558.09</b>

Siç shihet ne tab. shpenzimet vjetore aktualisht janë **1,815,954.20 KWh/vite** ose **259,754.96 €** ku me zbatimin e masave te efijencës se energjisë do te reduktohet fatura e energjisë elektrike ne **119,852.98€** ose **1,089,572.52 kWh/vit** ndërsa do te kursehet energji elektrike ne **726,381.68 kWh/vite**.

Në këtë llogaritje të potencialit për kursim te energjisë është përfshire i ter sistemi i ndriçimit publik.

## 2.2 SEKTORI I BANIMIT

**Tabela 3 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin Banimit**

Lloji I konsumit	Konsumi total kWh/vit	Emetimi i [tCO2 vit]	Kursimi i energjisë kWh/vite	Reduktimi i [tCO2 vit]
Konsumi elektrik për ngrohje	7,292,733	10,428.61	2,187,820.05	3,128.58
Konsumi për ngrohje me biomas	98,610,568	3,086.51	29,583,170.34	925.95
<b>Totali</b>	<b>105,903,301</b>	<b>13,515</b>	<b>31,770,990</b>	<b>4,055.00</b>

Sektori i banimit si konsumatori me i madh i energjisë del te jetë potenciali me i madh i kursimit te energjisë me **31,770.99 MWh/vite** dhe reduktim te emitimit te CO2 4,055.00t/vit.

## 2.3 SEKTORI KOMERCIAL

**Tabela 4 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin Komercial**

Lloji I konsumit	Konsumi total kwh/vit	Emetimi i [tCO2 vit]	Kursimi i energjisë kWh/vite	Reduktimi i [tCO2 vit]
Konsumi elektrik për ngrohje	1,304,871	1,865.97	391,461.38	559.79
Konsumi për ngrohje me biomas	52,353,428	1,638.66	15,706,028.39	491.60
<b>Totali</b>	<b>53,658,299</b>	<b>3,505</b>	<b>16,097,490</b>	<b>1,051</b>

Sektori i komercial si konsumatori i dytë pas sektorit te banimit, del te jetë me potenciali te kursimit te energjisë me **16,097.49 MWh/vit** dhe reduktim te emitimit te **CO2 3,505.00t/vit**.

## 2.4 SEKTORI BUJQËSISË

Ne baze te regjistrimit te bujqësisë ne vitin 2014 nga ASK, ne komunën e Deçanit janë gjithsejtë 1,319.00 makineri ne bujqësore qe konsumojnë nafta, ne vlerë 316,560.00 litra/vit. Potenciali i kursimit te energjisë ne bujqësi është 329.22MWh/vit, ndërsa reduktim te emitimit 11.19 [tCO2 vit].

**Tabela 5- Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e bujqësisë**

Lloje i automjeteve të regjistruara	Nr. i automjeteve	Naftë / l	Konsumi total i energjisë (kWh)	Emitimi i t CO2/vit	Kursim i energjisë (kWh)	Reduktimi i CO 2
Traktorë	1,319.00	316,560.00	2,532,480.00	86.10	329,222.40	11.19

<b>Totali</b>	<b>1,319</b>	<b>316,560.00</b>	<b>2,532,480.00</b>	<b>86.10</b>	<b>329,222.40</b>	<b>11.19</b>
---------------	--------------	-------------------	---------------------	--------------	-------------------	--------------

## 2.5 SEKTORI TRANSPORTI

Transporti ne komunën e Deçanit për te gjithë sektorët, Publik, Komercial dhe Individual.

**Tabela 6- Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e transportit**

Sektori	Konsumi i energjisë nafta [MWh/vit]	Emetimi i [tCO2 vit] nga nafta	Kursim [MWh /vit]	Reduktimi i emetimit [tCO2 vit]
<b>Transporti në Komunën e Deçanit</b>	40,584.96	11,039.11	6,899.44	1,876.65

## 2.6 POTENCIALI I KURSIMIT SIPAS PVKEK

Dokumenti identifikon masat për ngritje kapacitetesh dhe vetëdijesim të banorëve të Komunës e Deçanit për rëndësinë e kursimit të Energjisë, masat për renovime të stokut të ndërtesave publike sipas radhës së përcaktuara në bazë të kriterëve të përvetësuar, masat elementare te EE ne sektor te banimit dhe ndriçim publik.

Efektet e masave të rekomanduara rezultojnë me vlerat sikur në tabelën në vijim.

**Tabela 7 - Të dhënat përmbledhëse**

Sektori	Kursimet i energjisë [MWh/ vit]	Investime për tri vite [EUR]	Reduktimi I [tCO2 vit]
Politika komunale, promovim	/	150,000.00	/
Ndërtesat komunale	540.40	620,556.00	772.77
Ndriçim publik	726.38	2,400,000.00	1,038.73
Banimit	31,770.99	21,306,048.00	27,308.73
Komercial	16,097.49	8,716,800.00	4,625.60
Transporti	6,899.44	435,000.00	1,876.65
Bujqesia	329.22	350,000.00	90.13
<b>Gjithsej</b>	<b>56,363.93</b>	<b>33,828,404.00</b>	<b>35,712.61</b>

## 3. INFORMACIONI BAZË PËR KOMUNËN E DEÇANIT

Buxheti i Komunës së Deçanit është i përbërë nga të hyrat vetanake, garantet qeveritare, dhe potencialisht prej huamarrjes nga bankat komerciale. Totali i buxhetit komunal për vitin 2022 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në kuadër të buxhetit të Kosovës për Komunën e Deçanit është përafërsisht. 10.3 mil €.

Bazuar në ndarjen e të hyrave komunale vetanake dhe granteve kombëtare, të hyrat vetanake paraqesin 9% të buxhetit total të komunës të cilat janë mbledhur nga burimet e mëposhtme:

Taksat dhe tatimet komunale në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të lejeve për ndërtesa/konstruktivim;

Taksat komunale, licencat dhe lejet, certifikatat dhe dokumentet e tjera zyrtare, taksa për automjete, etj;

Taksat dhe tatimet komunale për veprimtaritë ekonomike të bizneseve të vogla, të ardhurat nga qiraja, restorantet, kafenetë dhe shërbime të tjera;

Taksat dhe tatimet tjera të parapara me ligj.

Me ligjin për vetëqeverisjen lokale 03/L-040 dhe ligjin për financimin e qeverisjes lokale 03/L-049, komunat janë të autorizuar që në mënyrë të pavarur të krijojnë të hyra për të financuar funksionet ekskluzive nën juridiksionin e tyre.

Qeveria qendrore siguron fonde për komunat për t'i përmbushur kërkesat për sigurimin e funksioneve të përbashkëta dhe të deleguara posaçërisht në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Granti i qeverisë është i përbërë nga granti i përgjithshëm, granti i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe granti për arsim.

Strukturat ekzistuese të buxhetit përfshijnë të gjitha burimet dhe shpenzimet e fondeve. Struktura e të ardhurave dhe financimit janë paraqitur më poshtë.

Instrumentet kryesore të financimit në nivel komunal janë nga këto burime financiare;

Të hyrat vetanake komunale;

Grantet e operimit dhe barazimit,

Huamarrja Komunale dhe zotimet,

Bankat lokale, dhe

Instrumentet ndërkombëtare të financimit.

### 3.1 POZICIONI DHE TOPOGRAFIA - PVKEK

Komuna e Deçanit ka pozitë të mirë gjeografike, shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, me 37 fshatra, me 40.954 banorë dhe me Qendër Administrative në Qytetin e Deçanit. Ka një sipërfaqe prej 288.40 km<sup>2</sup> ose 28.840 ha, ku janë:

940,4 ha / tokë pjellore

420 ha / pyje dhe

479,6 ha / kullosa

Territori përbëhet nga:

Ultësira, që është pjesa e rrafshit të Dukagjinit dhe;

Në pjesën e lartësisë gjeografike – bjeshkët (Alpet Shqiptare).

Në kufirin kadastral kufizohet me:

Në perëndim kufizohet më Junikun.

Në veri-perëndim kufizohet më Malin e Zi.

Në veri kufizohet më Komunën e Pejës.

Në jug-lindje dhe jug kufizohet më Komunën e Gjakovës.

Bjeshkët -Alpet Shqiptare shtrihen në pjesën perëndimore të Komunës së Deçanit.

Nga lumenjtë kryesor duhet veçuar, Lumëbardhin e Deçanit, dhe Lumbardhin e Lloqanit. Këta dy lumenj burojnë në pjesët më të larta të Bjeshkëve tona.

Në mbarim të Grykës së Deçanit, gjegjësisht në afërsi të Manastirit të Deçanit, gjendët një burim i ujit mineral.

### 3.2 KLIMA LOKALE

Deçani ka klimë kontinentale me dimra të gjatë, në ultësira vërehet prania e ndikimit të klimës mediterane.

Bjeshkët tona janë më një florë dhe faunë të pasur dhe vlen për të veçuar llojet e drurëve halor dhe gjetherënës siç janë: Pishat, gështenjat që janë të përhapura në gjithë brezin e malor.

Komuna e Deçanit ndahet në katër zona turistike: Zona turistike e qytetit të Deçanit më rrethinë; Zona turistike e Grykës së Deçanit: Bjeshka e Deçanit, e Roshkodolit, Pleqja, Bjeshka e Baballoqit, e Belegut etj. Zona turistike e Grykës së Lloqanit, Zona turistike e Bjeshkëve të Strellcit.

Resurset e shumta natyrore si dhe vlerat trashëgimisë kulturore, i mundësojnë komunës së Deçanit zhvillim ekonomik, në veçanti zhvillimin e sektorit të turizmit dhe të bujqësisë.

### 3.3 POPULLSIA DHE VENDBANIMET

Komuna e Deçanit ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës. Kufizohet me Pejën në veri, Gjakovën në lindje, Junikun në jug dhe Malin e Zi në perëndim. Ka gjithsej 37 fshatra në territorin e komunës. Zona përfshin një hapësirë prej 180 km<sup>2</sup>. Së bashku me komunat Gjakova, Rahovec dhe Junik, komuna formon Rajonin Gjakova.

Regjistrimi i vitit 2011 tregoi që komuna e Deçanit kishte 40.019 banorë, nga të cilët 39.402 ishin shqiptarë, 393 egjiptianë nga Ballkani, 60 boshnjakë, 42 ashkali, 33 romë, 3 serbë dhe një goranë.

#### **Tabela 8 Numri i banorve në komunën e Deçanit**

Zona	Nr.i banorëve	Meshkuj	Femra	Shqiptar	Serb	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptjan	Të tjerë.
Zona Urbane	3803	1895	1908	3781	3	-	1	-	1	9	6
Zona Rurale	36216	18230	1908	35621	-	-	59	33	41	384	15
Komuna e Deçanit	40,019	20,125	19,894	36,154	3	-	60	33	42	393	19

### 3.4 STRUKTURA ADMINISTRATIVE LOKALE DHE AJO ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E PLANIT TE VEPRIMIT PËR ENERGJI DHE TË KLIMËS (PVKEK)

Procesi i Zhvillimit, Implementimit dhe Monitorimit të PVKEK në Komunë është detyrë jashtëzakonisht e ndërlikuar që paraqet shumë sfida për të gjithë personat e përfshirë.

PKVEK- hartohet ne përputhje me kërkesat dhe ndërlidhjen e planeve lokale me Planin Kombetar per Energji dhe Klime (PKEK) qe pritet te aprovohet vitin tjetër.

Për të mbështetur komunat e Kosovës në harmonizimin e kërkesave dhe detyrimeve që dalin nga PKEK dhe për t'i përshtatur ato me planet e tyre komunale të energjisë dhe klimës, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) përmes “Projekti për mbështetje të Komunave të Kosovës në rritjen e kapaciteteve në hartimin e Planeve Komunale për Energji dhe Klimë ” të mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes GIZ, ka hartuar draftin e Shabllonit për PKVEK si dhe një udhëzues për procedurat dhe proceset e hartimit të këtyre planeve komunale. Forma finale e këtyre dy dokumenteve do të miratohet pas aprovimit të Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK).

Modeli i PKVEK-se është krahasuar dhe zhvilluar në përputhje me Modelin e PKEK-së të ofruar nga Komuniteti i Energjisë dhe përmban të gjitha elementet e PKEK-së që e afektojnë/kanë ndikim në nivelin lokal. Udhëzuesi është dokument mbështetës që ofron udhëzime, informata dhe përshkruan procedurat dhe procesin për hartimin PKVEK-së.

PKVEK e Komunes se Decanit eshte hartuar duke u bazuar në këto dy dokumente të përgatitura nga AKK

Për një proces të suksesshëm është e rëndësishme që të ndërtohet një strukturë efektive organizative, në mënyrë që ajo ta ketë të qartë që nga fillimi se çfarë duhet të bëjë, si dhe kur. Për shkak të kompleksitetit të procesit, dhe me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të palëve të interesuara në proces, është me rëndësi të madhe krijimi i organeve punuese dhe mbikëqyrëse dhe përcaktimi i detyrave të tyre në fillim.

Hapi i parë drejt ndërtimit të strukturës organizative për implementimin e procesit është që të emërojë koordinatoren. Koordinatorin e procesit është personi kyç për tërë procesin, i cili do të merr të gjitha vendimet e rëndësishme pas emërimit të tij, dhe do t'i propozojë të gjitha trupat punuese dhe mbikëqyrëse të nevojshme për zbatimin e hapave kryesorë në këtë proces. Kjo PVKEK rekomandon që Koordinatorin e Procesit duhet të jetë Kryesuesi i Drejtorisë për

Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike ose i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit i mbështetur nga Koordinatori i Energjisë.

Organet mbikëqyrëse dhe punuese, të cilat duhet të krijohen sipas hapave të procesit, janë si më poshtë:

Këshilli i Energjisë;

Grupi Punues për zbatimin e PVKEK-s.

Këshilli i Energjisë është organ mbikëqyrës dhe këshillëdhënës i cili duhet të themelohet në fillim të procesit. Me qëllim të lehtësimit të komunikimit dhe monitorimit të procesit, rekomandohet që koordinatori i procesit duhet të jetë Kryetari i Këshillit të Energjisë. Këshilli i Energjisë duhet të përbëhet nga përfaqësues të administratës komunalë dhe palët kryesore të procesit.

Detyrat kryesore të Këshillit të Energjisë do të jenë:

Monitorimi i të gjitha fazave të zhvillimit, implementimit dhe monitorimit të PVKEK;

Komunikimi me palët e interesit dhe qytetarët;

Rishikimi i PVKEK;

T'i rekomandon administratës të komunës që PVKEK të bëhet dokument zyrtar obligues i Komunës;

Të monitoron operacionet e grupit punues për zbatimin e PVKEK-s;

Të monitoron dhe kontrollon zbatimin e PVKEK-s;

T'i raporton periodikisht administratës së komunës për rezultatet e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të PVKEK-s;

Rekomandohet që Këshilli i Energjisë i Komunës të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

Administrata e Komunës,

Institucionet shkencore dhe të edukimit nga fusha e energjisë,

Shoqatat civile,

Ndërmarrjet publike,

Shoqatat e konsumatorëve.

Përveç përfaqësuesve të institucioneve të lartpërmendura, Këshilli i Energjisë i Komunës duhet të jetë i hapur për ekspertë të shquar në fushën e energjisë me përvojë të gjatë në një nga fushat e mëposhtme:

Energjia, eficientia e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë;

Ndërtimtaria, zhvillimi urban dhe planifikimi hapësinor;

Shërbimet publike;

Trafiku dhe transporti.

Grupi punues për zbatimin e PVKEK-s është organ punues që është kryesisht përgjegjës për iniciimin dhe koordinimin e zbatimit të projekteve të veçanta dhe masave të eficientës së energjisë, shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit, në

përputhje me afatet e zbatimit të PVKEK-s. Është e rëndësishme që koordinatori i grupit punues të jetë ekspert i shquar me përvojë të gjatë në menaxhimin e projekteve të mëdha për eficiencën e energjisë. Grupi punues duhet të krijohet gjatë fazës së zhvillimit të PVKEK-s, në mënyrë që zbatimi i PVKEK-s të mund të fillojë shumë shpejt, pasi ajo të miratohet si dokument zyrtar.

Meqë është ngarkese e madhe e punës, rekomandohet që të gjitha aktivitetet përgatitore për themelimin e Grupit Punues duhet të ndërmerren sa më shpejt të jetë e mundur.

Grupi Punues do të:

Menaxhon dhe koordinon zbatimin e PVKEK-së;

Krijon strategji të komunikimit;

Menaxhon tenderët publikë për hartimin e dokumentacionit teknik për masat e PVKEK-s dhe projektet;

Menaxhon tenderët publikë për zbatimin e projekteve dhe masave të PVKEK-s;

Menaxhon prokurimin publik për pajisjet e nevojshme për projektet e PVKEK-s dhe zbatimin e masave;

Monitoron dhe kontrollon zbatimin e të gjitha masave dhe projekteve të PVKEK-s;

Përgatit raportet periodike për rezultatet e zbatimit të PVKEK-s.

### 3.5 RËNDËSIA ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE TË TJERA PËRFSHIRJA E AUTORITETEVE LOKALE

Zhvillimi i programit të eficiencës së energjisë është bazuar në analizën e të dhënave komunale për energjinë për vitin 2019 dhe parashikon një periudhë zbatimi nga 2022 deri në 2030. PVKEK ndërlidhet edhe me një numër të dokumenteve tjera si:

**Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021-** në kuadër të këtij dokumenti, Shtylla 4 përfshin: infrastrukturën me 4 masa prioritare, masa 3 - ulja e konsumit të energjisë përmes masave të eficiencës së energjisë.

**Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2024-** jan paraparë disa masa në rishikimin e legjislacionit, akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjik në permismin e eficiencës së energjisë në sektorin e rezident dhe privat.

**Programi i Kosovës për Reforma në Ekonomi-**masa 5- Ulja e konsumit të energjisë nëpërmjet masave të eficiencës së energjisë – kjo masë synon të kontribuojë në arritjen e caktuar të kursimit të energjisë për 11%, nëpërmjet zbatimit të masave të EE dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë në sektorin rezident, privat dhe publik, dhe duke vendosur kornizën ligjore për eficiencë të energjisë në sektorin privat. Kjo masë është e ndërlidhur me rekomandimin e politikave nga Dialogu Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, 23 maj 2017.



**Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë 2019-2021-** është përgatitur sipas Ligjit për Eficiencën e Energjisë Nr.04 / L-016 dhe paraqet dokumentin e parë të Komunës i cili është përqendruar në adresimin e eficiencës së energjisë në nivelin komunal. PVKEK paraqet analizën e konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave publike, ndërtesave rezidenciale, ndriçimin publik dhe sektorin e transportit, potencialin e eficiencës si dhe liston projektet që duhen zbatuar në drejtim të zhvillimit të EE.

### 3.6 PËRVOJA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Në vitet e fundit, komuna e Deçanit ka zbatuar një numër të madh të projekteve në fushën e EE, tani ka nënshkruar edhe marrveshje për shërbime të energjisë me FKEE për tri ndërtesa dhe ESCO për ndriçim publik dhe ndriçim të ndërtesave. Kjo dëshmon se stafi i komunës ka përvojë mjaft të mirë në zbatimin e masave të EE. Përvoja e tyre lidhet, sidomos në përgatitjen e TeR/specifikacionit teknik, tenderimit, mbikëqyrjes, monitorimit dhe raportimit lidhur me rezultatet e arritura.

Komuna e Deçanit e ka të caktuar zyrtarin për energji, mirëpo edhe më tej nuk ka zyre për energji sipas Udhëzimit Administrativ nr. 09/2017, e cila do koordinojë aktivitetet me sektorë të tjerë në proces të realizimit të projekteve. Me krijimin dhe funksionalizimin e sistemit komunal për menaxhimin e energjisë dhe me vendosjen e të dhënave në softuerin ENMASOFT, zyrtari/menaxheri komunal i energjisë do të ketë më të lehtë menaxhimin e të dhënave nga terreni për ndërtesat komunale dhe ndriçimin publik, si dhe në krijimin e Planit të Veprimit Komunal për Energji dhe Klime (PVKEK). Ky softuer është një mjet i cili do të lehtësojë procesin e planifikimit, monitorimit dhe raportimit lidhur me projektet në fushën e EE.

## 4.TREGUESIT E ENERGJISË KOMUNALE (FURNIZIMI DHE PRODHIMI I ENERGJISË KOMUNALE)

### 4.1 ELEKTRICITET


#### FURNIZIMI ME ELEKTRICITET

Problemi i furnizimit me energji elektrike në Kosovë e ka gjenezën në shkatërrimin e qëllimshëm të sistemit të energjisë elektrike në të gjitha elementet e tij, nga regjimi pushtues, veçanërisht në vitet e 90-ta. Që nga viti 1984 nuk ka pasur ndërtime të kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, me përjashtim të disa kapaciteteve të vogla hidrike, por që nuk kanë pasur ndikim në zgjidhjen e problemit të sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Aktualisht shumica e blloqeve të termocentraleve janë në fundin e jetës teknike të tyre. Sikur të kishte pasur një zhvillim në kushte stabile të furnizimit me energji elektrike, praktikisht të gjitha kapacitetet gjeneruese të TC “Kosova A” do të duhej të ishin ose të dekomisionuara ose

të rehabilituara (siç ka ndodhur në shumicën e rasteve të ngjashme në vendet e Evropës Jug-Lindore(EJL)).

Me gjithë problemet dhe vështirësitë me të cilat është përballur sistemi i prodhimit të energjisë elektrike, në 15 vitet e fundit ka pasur rritje të vazhdueshme në prodhimin e energjisë elektrike.

Se si qëndrojnë sektorët në konsumin e energjisë elektrike në nivel vendi, tregojnë figurat e mëposhtme.



*Figura 1. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorët ekonomik (%)<sup>1</sup>*

Nga figura 4 shihet se sektori i amvisërisë në nivel vendi është konsumuesi më i madh i energjisë elektrike, me rreth 56%.

#### Shpërndarja e energjisë elektrike

Mbulimi i kërkesave për energji elektrike bëhet nga prodhimi vendor dhe një pjesë nga importi. Prej vitit 2000 deri në vitin 2015 janë shpenzuar 538.25 milionë euro për importin e energjisë elektrike. Në disa raste ka pasur ndërhyrje të Qeverisë për subvencionimin e importit, që nga viti 2012 janë ndërprerë subvencionimet për import, por në vitin 2021 ka pasur krizë energjetike ka filluar përsëri subvencionimi i energjisë elektrike. Pas privatizimit të kompanisë për shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike, kostoja e importit të energjisë elektrike ka rënë ndjeshëm, veç tjerash edhe si pasojë e procedurave më efikase të blerjes së energjisë elektrike. Kapacitetet infrastrukturore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike nuk kanë mundur të përcjellin në masën e duhur rritjen e kërkesës, si pasojë, në radhë të parë, e investimeve të pakta në rrjetin shpërndarës. Për pasojë sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike është tej ngarkuar vazhdimisht, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit.

<sup>1</sup> Balanca Vjetore e Energjisë në Republikën e Kosovës për vitin 2017-ASK

Në maj të vitit 2013 sistemi i shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike ka kaluar në pronësi private. Në fund të vitit 2014 ka përfunduar procesi i shthurjes ligjore të OSSH-së nga aktiviteti i furnizimit. Në vitet e fundit, sidomos pas privatizimit të rrjetit të shpërndarjes, janë bërë investime mjaft të mëdha në rrjetin e shpërndarjes (rreth 20 milionë euro në vit) dhe vazhdohet të investohet në projekte të planifikuara nga OSSH-ja.

## 4.2 FOSILET DJEGËSE

### DIESEL

Karburantet e lëngëta: nafta, mazuti, gazi i lëngëzuar i naftës (GLN) importohen dhe janë të shtrenjta, por ofrojnë komoditet të mirë për ngrohje. GLN është një burim eficient, miqësor me ambientin. Ekziston një treg relativisht i mirë i furnizimit nga sektori privat me tendencë rritjeje.

Në Kosovë nuk ka prodhim të naftës dhe gazit natyror. Në Kosovë, gjithashtu nuk ka rafineri naftë dhe duhet theksuar se nënproduktet e naftës zënë një pjesë të rëndësishme të furnizimit të burimeve energjetike në nivel vendi dhe në nivel komune.

### GASOLINË

Në komunën e Deçanit nuk konsumohet ky produkt.

### NAFTË E RËNDË

Ne komunën e Deçanit nuk konsumohet ky produkt.

### LPG

Nuk janë ofruar të dhënat për LPG dhe bujqësi.


### QYMYR - LINJIT

Kosova ka rreth 12.5 miliardë ton të linjtit si rezerva gjeologjike, duke vendosur Kosovën në vendin e dytë në Evropë dhe në vendin e pestë në botë me këto rezerva. Linjiti është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon 97% të prodhimit total të energjisë elektrike (TC “Kosova A” dhe TC “Kosova B”).

Hulumtimet e para të qymyrit në Kosovë kanë filluar në fillim të shekullit XX, ku është konstatuar se në Kosovë ekzistojnë rezerva të mëdha të qymyrit. Në vitin 1922 fillon shfrytëzimi nëntokësor në minierën e Hadës e më vonë edhe në Babush të Lipjanit. Hulumtimet sistematike gjeologjike të qymyrit në basenin e Kosovës kanë filluar në periudhën kohore 1952-1957. Gjatë kësaj periudhe është bërë përgatitja për kalimin e shfrytëzimit të qymyrit në basenin e Kosovës, nga shfrytëzimi nëntokësor në atë sipërfaqësor duke shqyrtuar mundësitë e shfrytëzimit masiv për nevojat e termocentraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe përpunimin industrial të qymyrit.

**Tabela 9. Rezervat e qymyrit në Republikën e Kosovës**

Basenet qymyrbajtëse	REZERVAT (t)		
	Gjeologjike	Bilance*	Jo bilance**
Kosovës	10, 091, 000,000	8,772,000,000	1,319,000,000
Dukagjinit	2, 244, 830,000	2,047,700,000	197,130,000
Drenicës (f. Skenderaj)	106, 631,000	73,188,000	33,443,000
Gjithsej	12,442,461,000	10,892,888,000	1,549,573,000



*Figura 2. Basenet qymyrbajtëse të Kosovës*

Megjithatë bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 06/74 të datës 06.11.2018, përdorimi i thëngjillit për ngrohjen e institucioneve publike është i ndaluar.

## BIOMASA

Sipërfaqja pyjore në Kosovë është mjaftë e qëndrueshme me rreth 481 000 ha (44.7% e sipërfaqes totale). Rreth 38% e sipërfaqes pyjore është në pronësi private, ndërsa 62% janë pyje publike. Pyjet cungishte dominojnë sipërfaqet pyjore me 84%. Pyjet e pastra fletore mbulojnë pothuajse 83% të sipërfaqes pyjore.

\* Rezervat bilance janë ato rezerva ku fuqia kalorike e qymyrit është mbi 5.450 kJ/kg

\*\* Rezervat jashtë bilance janë ato rezerva ku fuqia kalorike e qymyrit është nën 5.450 kJ/kg

## DRU ZJARRI

Sipas të dhënave zyrtare te Drejtorisë se Arsimit te komunës se Deçanit, sasia e druve të zjarrit është 33,380.00 m<sup>3</sup>/vit per sektorin publik.

Bazuar ne te dhënat e KEDS-it, te konsumit te energjisë elektrike për vitin 2019, sektori i banimit për ngrohje konsumon energji elektrike rrethe 7% ndërsa energji termike si burim drurin me rrethe 93% ose 98,610.57 m<sup>3</sup>.

Ndarja e llojet te konsumit te energjisë është bazuar ne studimin EPTISA: “Konsumi mesatar i energjisë për m<sup>2</sup> të amvisërive”.

**Tab.10 vlerat kalorike te drurit sipas lagështisë**

Biomasë	Njësia	kJ	kgoe	toe	ktoe
<b>Druri (20 % - lagës</b>	m <sup>3</sup>	6,155,095.80	147.17	1.47E-01	1.47E-04
<b>Druri (40 % - lagës</b>	m <sup>3</sup>	3,596,585.77	85.9	8.59E-02	8.59E-05
<b>Druri ( 45 % - lagës</b>	m <sup>3</sup>	3,507,670.18	83.77	8.38E-02	8.38E-05

## PELET

Ne komune e Deçanit nuk është raportuar ndonjë ndertës qe konsumen Pelet per ngrohje. Peleti është një produkt energjetik që fitohet në mënyrë artificiale nga biomasa me origjinë drurore, respektivisht nga byku (tallashi), ashklat, pjesët e imëta dhe lëvorja e drurit. Diametri i peletit sillet rreth 6-12 mm, kurse gjatësia tij është 5-45 mm. Dendësia e peletit të hedhur (grumbullit të peletit duke përfshirë zbrazëtirat) sillet rreth 650 kg/m<sup>3</sup>, përmbajtja e lagështisë nga 8-10 % kurse nxehtësia e djegies 4.9-5.4 kWh/kg.

## NGA NGROHJA QENDRORE

Në Komunën e Deçanit nuk ka ngrohtore qendrore të qytetit. Objektet që menaxhohen nga komuna, kryesisht kanë të instaluar kalldajat e tyre vetanake për ngrohje të cilat përdorin si lëndë për djegie drurin, dhe më pak përdoret nafta. Burimet energjetike të cilat përdoren për ngrohje sigurohen nga komuna e Deçanit sa i përket sektorit publik.

## PRODHIMI I ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Prodhimi i energjisë në sektorin e ndërtimit (banesa, ndërtesa publike)

Në sektorin rezidencial të komunës së Deçanit nuk ekzistojnë centrale (impiante) të cilat prodhojnë energji elektrike, mund të ketë gjeneratorë të cilët shfrytëzojnë karburantet e lëngëta për prodhimin e energjisë elektrike. Këta gjeneratorë kryesisht përdoren në kohën kur ka mungesë të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi publik.

Gjithashtu, në sektorin rezidencial, ekzistojnë disa sisteme të vogla të paneleve diellore kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar.

## 5.ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Burimi i të dhënave relevante për analizën e konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave të Komunës së Deçanit janë të mbledhura nga burimet e mëposhtme:

- Zyrtarët e Komunës,
- Agjencia e Statistikave të Kosovës: "Banesat dhe ndërtesat sipas komunave" 2013
- Banka Botërore: "Studimi Nacional për Efiçencën e Energjisë në ndërtesa për Kosovën" 2013
- Shpërndarja Elektrike në Kosovë dhe Kompania e Furnizimit (KEDS): Të dhënat mbi Konsumin e Energjisë Elektrike për nga viti 2017 deri 2019
- Banka Botërore: " Studimi i sektorit energjetik të ngrohjes në Kosovë" 2007
- EPTISA: "Konsumi mesatar i energjisë për m2 të amvisërive"

Për nevojat e analizës së konsumit të energjisë, sektori i ndërtesave në Komunën e Deçanit është i ndarë në nënsektorët e mëposhtme:

- Ndërtesat në pronësi të komunës dhe të kompanive publike;
- Ndërtesat e banimit (amvisëritë);
- Ndërtesat komerciale dhe të shërbimeve

Në bazë të dhënave të mbledhura, për të gjithë nënsektorët e sektorit të ndërtesave në Komunën e Deçanit janë dhënë parametrat e mëposhtëm:

- Informacionet e përgjithshme për nënsektorin;
- Sipërfaqja totale e nënsektorit (m<sup>2</sup>);
- Numri i ndërtesave në nënsektor;
- Konsumi total i energjisë elektrike në nënsektor (kWh);
- Konsumi specifik i energjisë elektrike në nënsektor (kWh/m<sup>2</sup>);
- Konsumi i energjisë elektrike për ngrohje në nënsektor (kWh );
- Konsumi i druve të zjarrit për ngrohje në nënsektor (kWh )

- Konsumi i naftës për ngrohje në nënsektor (kWh)
- Konsumi i gazit për ngrohje në nënsektor (kWh)
- Konsumi i linjtit për ngrohje në nënsektor (kWh)
- Konsumi specifik i energjisë për nevoja tjera nga ato të ngrohjes (kWh/m<sup>2</sup>)
- Konsumi specifik i energjisë për ngrohje (kWh/m<sup>2</sup>)

#### Konsumi i energjisë në ndërtesat e banimit (PVKEK)

Të dhënat e përdorura për analizën e konsumit të energjisë në sektorin e banimit të komunës së Deçanit janë mbledhur nga burimet e mëposhtme:


- Agjencia e Statistikave të Kosovës: „Banesat dhe ndërtesat e komunave“,Regjistrimi 2011
- Banka Botërore: „National Building Energy Efficiency Study“ 2013

Sipërfaqja e shfrytëzueshme e për nevoja të banimit në Komunën e Deçanit, bazuar në Regjistrimin e vitit 2011 është **665,814 m<sup>2</sup>**,. Bazuar në vlerësimin e numrit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Bazuar në të dhënat e KEDS-it për vitin 2019, shuma totale e energjisë elektrike të shpenzuar ngrohje në vitin 2019 ishte **7,292,733 kWh/vit** e cila jep konsumin specifik të energjisë elektrike prej **158.74 kWh/m<sup>2</sup>** referuar sipërfaqes totale të shfrytëzueshme ndërsa për konsumin e energjisë termike është **98,610,568 kWh/vit** kurse specifik **159.08 kWh/m<sup>2</sup>**.

**Tabela 11 Parametrat e konsumit të energjisë termike dhe elektrike në sektorin e banimit në Komunën e Deçanit**

Lloji i konsumit	Vlera kWh/vit	Konsumi specifik kWh/m <sup>2</sup>	Pjesëmarrja
Konsumi total për ngrohje	105,903,301	159.06	100%
Konsumi total për ngrohje, me energji elektrike	7,292,733	158.74	6.9%
Konsumi për ngrohje me dru dhe pelet (lëndët tjera për ngrohje konsiderohet nuk janë përdorur)	98,610,568	159.08	93.1%



*Fig 3 Konsumi i energjisë ne amvisëri*

Analiza e konsumit të energjisë në sektorin e amvisërive të Deçanit tregon potencial të madh për kursime të energjisë, posaçërisht për energji termike. Për këtë arsye, një mori masash të shumta të efijencës së energjisë duhet të ndërmerren vazhdimisht në mënyrë që të racionalizohet konsumi i energjisë dhe të zvogëlohen emisionet e CO<sub>2</sub>.

## 5.1 KONSUMI I ENERGISË NË NDËRTESAT NË PRONËSI KOMUNALE

### 5.1.1 NDËRTESAT ADMINISTRATIVE

Kategoria e ndërtesave të administratës komunale dhe objektet afariste (biznesit) në Komunën e Deçanit përbëhet prej 4 ndërtesave:

- Ndërtesa e Kuvendit Komunal
- QPS- Deçan
- Zyra e vendit- Deçan

Sipërfaqja e përgjithshme e kësaj kategorie është **3,710 m<sup>2</sup>**. Shuma e përgjithshme e energjisë elektrike për qëllime të tjera përveç termike në vitin 2017 ishte **121,450 kWh** e cila i jep një konsumin specifik të energjisë elektrike prej **32.74 kWh/m<sup>2</sup>**.

Ngrohja e ndërtesave administrative në pjesën më të madhe bëhet me naftë dhe një pjesë e vogël edhe me dru zjarri. Konsumi i përgjithshëm i energjisë termike nga nafta është 123.750 kWh, ndërsa nga drutë 34,480 kWh. Konsumi total i energjisë termike në ndërtesat administrative për vitin 2017 ishte **158,230 kWh**, e cila jep një konsum specifik prej **42.65 kWh/m<sup>2</sup>**.

Tabela 12 tregon parametrat e konsumit të energjisë termike për burim energjie në ndërtesat e administratës komunale.



**Tabela. 12. Parametrat e konsumit të energjisë termike në ndërtesat e administratës komunale**

Burimi i energjisë	Sipërfaqja e përgjithshme e cila ngrohet (m <sup>2</sup> )	Konsumi i energjisë termike (kWh)
<b>Energjia elektrike</b>	0,00	0,00
<b>Nafta</b>	3,334	123,750
<b>Dru</b>	485	34,480
<b>Gjithsejtë</b>	<b>3,710</b>	<b>128,530</b>

## 5.2 KONSUMI I ENERGISË NË NDËRTESTA E ARSIMIT

Ndërtesat arsimore në Komunën e Deçanit janë të ndara në tri kategori:

- Kopshtet- 1 objekt, sipërfaqja totale 1,890 m<sup>2</sup>
- Shkollat fillore – 18 objekte, sipërfaqja totale 25,523 m<sup>2</sup>;
- Shkollat e mesme - 2 objekte, me sipërfaqe totale 5,200 m<sup>2</sup>

Komuna e Deçanit ka një kopshte të fëmijëve dhe atë kopshtin “Fatosat” me 1,890 m<sup>2</sup>

Shkollat fillore të cilat ekzistojnë në këtë komunë janë si vijon:

- Beleg,
- Irzniq,
- St. Epërme,
- Grama
- Maznik
- Rat. Ultë
- Isniq
- Prapaqan
- Lumbardh
- Deçan
- Dranoc
- Preilep
- St. Ultë
- Voksh
- Glllogjan

- Baballoq
- Lukë e Epërme
- Rastavic

Komuna e Deçanit, ka gjithsejt 2 shkolla të mesme në Deçan secila me një sipërfaqe prej 2600 m<sup>2</sup>, respektivisht me një sipërfaqe totale prej 5200 m<sup>2</sup>.

Numri i përgjithshëm i institucioneve arsimore në Komunën e Deçanit është 21, me sipërfaqe të përgjithshme e cila ngrohjet në vlerë **32,613 m<sup>2</sup>**.

Në asnjërin prej nënsektorëve të ndërtesave nuk është raportuar që energjia elektrike konsumohet për nevoja të ngrohjes. Rrjedhimisht e tërë energjia elektrike e konsumuar është përdor për nevoja tjera nga ato të ngrohjes.

Konsumi total i eneregjisë elektrike në ndërtesa te arsimit **171,101 kWh**. Meqë energjia elektrike në këtë nënsektor nuk shfrytëzohet për ngrohje të hapësirave, rezulton që e tërë energjia elektrike e konsumuar në vitin 2017, pra vlera prej **171,101 kWh**, është konsumuar për nevoja tjera nga ato të ngrohjes. Vlera e konsumit specifik të energjisë elektrike referuar sipërfaqes që ngrohjet është **3.94 kWh/m<sup>2</sup>a**.

Shuma e përgjithshme e konsumit të energjisë termike në ndërtesat arsimore në vitin 2017 ishte **2,885,976 kWh**, e cila e jep konsumin specifik **88.49 kWh/m<sup>2</sup>**.

**Tabela 13 Parametrat e konsumit te energjisë termike në ndërtesat arsimore**

Burimi i energjisë	Sipërfaqja e përgjithshme qe ngrohjet (m <sup>2</sup> )	Konsumi i energjisë termike (kWh/vit)
Energjia elektrike	0,00	0,00
Dru zjarri	25,523	2,885,976
Lignit	0	0
Nafta	7,090	177,645.6
<b>Gjithsejtë</b>	<b>32,613</b>	<b>3,063,621.6</b>

### *Institucionet kulturore*

Në Komunën e Deçanit, në kategorinë e ndërtesave kulturore me një sipërfaqe të përgjithshme prej 3,500 m<sup>2</sup>, bënë pjesë Pallati i Kulturës “Jusuf Gërvalla”

Energjia elektrike nuk përdoret për qëllime termike në pallatin e kulturës. Energjia termike sigurohet nëpërmjet naftës. Shuma e përgjithshme e energjisë termike për nevoja të ngrohjes të pallatit të kulturës në vitin 2017 ishte **29,700 kWh**, e cila jep konsumin specifik prej **8.5 kWh/m<sup>2</sup>**.

Konsumi specifik i ultë i energjisë termike për nevoja të ngrohjes, rezulton nga përdorimi i sistemit të ngrohjes vetëm në rastin e organizimit të ngjarjeve kulturore.

### 5.3 KONSUMI I ENERGISË NË NDËRTESAT E KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kategoria e institucioneve shëndetësore, në Komunën e Deçanit përbëhet nga 10 objekte vijuese:

- QKMF & Emergjenca- Deçan
- 3 Qendra të Mjekësisë Familjare
- 6 Ambulanca nëpër Fshatra

Sipërfaqja e përgjithshme e kësaj kategorie është **4,030 m<sup>2</sup>**. Shuma e përgjithshme e energjisë elektrike për qëllime të tjera përveç energjisë termike në vitin 2017 ishte **184,286 kWh** e cila i jep një konsumin specifik të energjisë elektrike prej **45.73 kWh/m<sup>2</sup>**.

Energjia termike në institucionet shëndetësore të komunës së Deçanit sigurohet nëpërmjet naftës dhe nëpërmjet druve të zjarrit. Konsumi i përgjithshëm i energjisë termike nga nafta është 242.897 kWh, ndërsa nga drutë 137,920 kWh. Konsumi i përgjithshëm i energjisë termike në institucionet shëndetësore për vitin 2017 ishte **380,817 kWh**, e cila jep një konsum specifik prej **94.5 kWh/m<sup>2</sup>**.

Tabela 14 tregon parametrat e konsumit të energjisë termike për burim energjie në institucionet shëndetësore.

**Tabela 14 Parametrat e konsumit të energjisë termike në institucionet shëndetësore**

Burimi i energjisë	Sipërfaqja e përgjithshme e cila ngrohet (m <sup>2</sup> )	Konsumi i energjisë termike (kWh)
Energjia elektrike	0	0,00
Dru për zjarr	1,690	137,920
Lignit	0	0
Naftë	2,340	242,897
<b>Gjithsejtë</b>	<b>4,030</b>	<b>380,817</b>

### 5.4 KONSUMI I ENERGISË NË NDËRTESAT E KULTURËS DHE SPORTIT

Kategoria e ndërtesave sportive përbëhet vetëm nga një objektet vijuese:

- Salla sportive në Deçan me sipërfaqe 2,640 m<sup>2</sup>
- Salla sportive në Strellc me sipërfaqe 2,640 m<sup>2</sup>
- Salla sportive në Reastavicë me sipërfaqe 2,400 m<sup>2</sup>

Sipërfaqja totale e ndërtesave sportive është **7,680 m<sup>2</sup>**

Shuma e përgjithshme e energjisë elektrike për qëllime të tjera përveç energjisë termike e konsumuar në vitin 2017 ishte **125 kWh** e cila i jep një konsumin specifik të energjisë elektrike prej **0.016 kWh/m<sup>2</sup>**.

Bazuar ne te dhënat zyrtare te Komunës se Deçanit, ndërtesat e sportit nuk përdoret fare energjia elektrike dhe termike për ngrohje, shpenzimet e energjisë elektrike janë vetëm për nevoja tjera si ndriçim etj.

## 5.5 KONSUMI I ENERGJISË NË NDRIÇIMIN PUBLIK TË RRUGËVE

Konsumi i energjisë në ndriçim publik ka qen 187.46MWh/vit ne përudhen 2017-2019, rrjeti i ndriçimit publik për përudhen 2019-2021 është rritur shumë, konsumi i energjisë elektrike ka arritur në 1,815.95MWh/vit, janë rritur edhe shpenzimet në mirëmbajtje.

Vlen te theksohet se sipas te dhënave te ofruara nga DSHP, sistemi i ri i ndriçimit është vendosur LED me eficiencë te lartë.

**Tabela 15 Konsumi i energjisë në ndriçim publik**

Njësia	Konsumi i energjisë kWh/vite	Operimi/vit	Tarifa sipas faturës ekzistuese kWh/euro	Mirëmbajtja Vjetore (euro)	Shpenzimet ne vite/euro
<b>Gjendja ekzistuese</b>	<b>1,815,954.20</b>	<b>4015h</b>	<b>0,11 €</b>	<b>60,000.00 €</b>	<b>209,754.962 €</b>


## 5.6 ANALIZA PËRFUNDIMTARE E SEKTORIT TË NDËRTEHAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

Bazuar ne te dhënat zyrtare te komunës se Deçanit, sipas rezultateve të analizës së energjisë të kryer në sektorin e ndërtesave të Komunës së Deçanit, më së shumti energji është konsumuar në nën sektorin e banimit, e ndjekur nga nënsektori i ndërtesave komerciale .

Komunës (Tabela 16 dhe figura 4

**Tabela 16. Analiza e konsumit ne ndërtesat e komunës se Deçanit**

Nësektori	Sipërfaqja totale e dyshemesë ngrohur (m <sup>2</sup> )	Konsumi i energjisë termike (kwh)	Konsumi i energjisë elektrike (kwh)	Konsumi total i energjisë (kwh)
<b>Institucionet Arsimore</b>	32,613	3,063,622	171,101	3,234,723.00
<b>Ndërtesat Shëndetësore</b>	4,030	380,817	182,857	563,674.00
<b>Ndërtesat Administrative</b>	3,710	128,530	121,450	249,980.00
<b>Ndërtesat kulturore</b>	3,500	29,700	110	29,810.00
<b>Ndërtesa e ndërmarrjeve publike</b>	180	0	23	23
<b>Ndërtesa e sportit</b>	7,680	0	125	125
<b>Totali</b>	<b>51,713.00</b>	<b>3,602,669.00</b>	<b>475,666.00</b>	<b>4,078,335.00</b>
<b>Ndërtesa rezidenciale</b>	665,814	98,610,568	7,292,733	105,903,301.00
<b>Ndërtesat Komerciale</b>	272,400	52,353,428	1,304,871	53,658,299
<b>Totali</b>	<b>989,927.00</b>	<b>154,566,665.00</b>	<b>9,073,270.00</b>	<b>163,639,935.00</b>



*Figura 4: Struktura e konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave sipas nënsëktorëve*

Përfundimi kryesor i analizës së energjisë i kryer në sektorin e ndërtesave të Komunës së Deçanit është se zbatimi i masave të ndryshme të efijencës së energjisë dhe BRE-ve mund të rezultojë në kursimin e energjisë dhe zvogëlimin e ndotjes. Në mënyrë të veçantë, për nënsëktorin e ndërtesave në pronësi të Komunës një parakushti i rëndësishëm është kryerja e auditiveve të detajuar të energjisë.

## 6. KONSUMI I ENERGISË NË SHËRBIMET PUBLIKE

### 6.1 KONSUMI I ENERGISË NË FURNIZIMIN ME UJË

Bazuar ne informatat zyrtare te ofruara nga Komuna e Deçanit, furnizimi me ujë te pijes për edhe te ujitjes se tokave bujqësore behet përmes rënjës se lirë, dhe nuk ka konsum te energjisë elektrike ne këtë sektor.

## 6.2 KONSUMI I ENERGISË NË SEKTORIN E MBLEDHJES SË MBETURINAVE

Kjo kategori e nën sektorit të ndërtesave të kompanive publike përbëhet nga zyrat e kompanisë së ujësjellësit dhe të higjienës, me sipërfaqe të përgjithshme prej **180 m<sup>2</sup>**.

Bazuar në të dhënat e komunës së Deçanit ndërmarrja për grumbullimin e mbeturinave posedon 5 kamion të cilët konsumojnë 23,082.00L naft/vit.

Konsumi i përgjithshëm i energjisë **184.66MWh/vit** ndërsa emetimi **6.28 t CO<sub>2</sub>**.

## 6.3 KONSUMI I ENERGISË NË SEKTORIN E BUJQËSISË

Komuna e Deçanit shtrihet në një sipërfaqe prej 288.4 km<sup>2</sup> ose 28,884 ha.

Sipas Agjensionit Statistikor të Kosovës sipërfaqja e tokës për shfrytëzim në Komunën e Deçanit (duke përfshi livadhe dhe kullosa) është 13,447.57 ha.

Sipërfaqja pyjore përshin: 15.436.43 ha

Tokë bujqësore e shfrytëzuar 10,396.18 ha:

Drejtoria e bujqësisë në komunën e Deçanit ka prezantuar 597 biznese që merren me bujqësi dhe numrin e makinerisë që konsumojnë karburant janë 1,319.00 traktor.

Konsumi i naftës nga sektori i bujqësisë është 316,560.00litra/vit

**Tab.17 Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë**

Lloje i automjeteve të regjistruara	Nr. i automjeteve	Naftë / l	Konsumi total i energjisë (kWh)	Emitimi i t CO <sub>2</sub> /vit	Kursim total i energjisë (kwh)	Reduktim i CO <sub>2</sub>
Traktore	1,319.00	316,560.00	2,532,480.00	86.10	329,222.40	11.19
<b>Totali</b>	<b>1,319</b>	<b>316,560.00</b>	<b>2,532,480.00</b>	<b>86.10</b>	<b>329,222.40</b>	<b>11.19</b>

## 6.4 KONSUMI I ENERGISË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT

Sektori i transportit në Komunën është i ndarë në nënsektorët e mëposhëm:

- Auto parku Komunal;
- Transporti publik;
- Automjetet private dhe komerciale.

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të karburanteve në sektorin e transportit janë siguruar nga zyrtarët e Komunës.

Bazuar në të dhënat e në dispozicion, parametrat e mëposhtëm janë përcaktuar për të gjithë nënsektorët e sektorit të transportit në Komunë:

- Të dhënat e përgjithshëm nënsektoriale;
- Struktura e auto parkut sipas përdorimit të automjeteve;
- Klasifikimi i automjeteve sipas llojit të karburantit që përdoret;
- Konsumi i llojeve të ndryshme të karburantit për nënsektor dhe kategoritë e automjeteve brenda sektorit.

#### 6.4.1 FLOTA KOMUNALE

Auto parku në pronësi të Komunës së Deçanit përfshin 41 automjete të përdorura nga institucione të ndryshme publike:

- Administrata komunale – 17;
- Institucionet arsimore – 3
- Institucionet shëndetësore – 12;
- Kompanitë publike dhe zjarrfikësit - 18
- Institucioni sportive –1;

Shumica e automjeteve përkatësisht 90.2 % e tyre përdorin diezelin si karburant ndërsa 9.8 % përdorin benzinën. Në tabelën 18, është paraqitur konsumi i karburanteve për vitin 2017.

**Tabela 18 Konsumi i karburanteve për flotën e automjeteve te komunës në vitin 2017**

	Nr. i automjeteve	Konsumi i dizelit (litra)	Konsumi i benzinës (litra)	Konsumi i karburanteve (kWh)
<b>Administrata komunale (3588 /auto)</b>	17	60,000	1,000	603,300
<b>Institucionet arsimore</b>	3	2,100	0	29,790
<b>Institucionet shëndetësore</b>	12	22,000	1,000	227,100
<b>Kompanitë publike dhe zjarrfikësit</b>	18	35,000	5000	351,150
<b>Institucionet sportive</b>	1	1,500	0	14.850

Struktura e auto parkut te komunës sipas llojit te automjeteve është paraqitur në figurën 5.1 dhe struktura e konsumit te karburanteve sipas llojit të tyre është paraqitur në figurën 5.2.

### Struktura e automjeteve të flotës komunale




Figura 5: Struktura e automjeteve te auto parkut te komunës




Figura 6: Struktura e konsumit të karburanteve sipas llojit të tyre

#### 6.4.2 TRANSPORTI PUBLIK (NËSE KOMUNA KA KOMPANI PUBLIKE)

Flota e transportit publik në komunën e Deçanit përbëhet prej 10 autobusëve dhe 24 taksive. Të gjitha atomjetet e transportit publik, funksionojnë me dizelin si karburant.

Të dhënat lidhur me transportin publik me autobus janë prezantuar në tabelën 19.

**Tabela 19 Karakteristikat e transportit publik me autobusë në territorin e Komunës së Deçanit**

Transporti publik me autobusë për vitin 2017		
<b>Numri i autobusëve</b>	Konsumi i dizelit (t/vit)	Energjia e konsumuar (kWh)



<b>10</b>	72.3	715,808
-----------	------	---------

Rekomandimi i këtij dokumenti është që të bëhet një pilot projekt për të prezantuar autobusë me burimet të energjisë që janë miqësorë ndaj mjedisit, të tilla siç është gazi i lëngëzuar i naftës ose biodizeli për të verifikuar në realitet avantazhet e përdorimit të automjeteve me këto lëndë djegëse.

### **Transporti publik me taksì**

Shërbimet e taksive në territorin e komunës ofrohet nga 24 automjete të cilat operojnë duke shfrytëzuar dizelin si karburant. Për të vlerësuar konsumin mesatar të karburantit nga ana e taksive, janë shfrytëzuar shënimet e nxjerra për Decan, në kuadër të hartimit të Planit të veprimit për energji dhe klimë të qëndrueshme (PVKEK) në këtë komunë. Bazuar në të dhënat e tilla, konsumi mesatar vjetor i veturave të taksive është 1744 litra/vit. Shënimet e përmbledhura lidhur me konsumin vjetor të karburantit nga taksit në komunën e Deçanit janë prezantuar në tabelën 20.

**Tabela 20 Karakteristikat e shërbimeve të taksive në Komunën e Deçanit**

<b>Transporti publik me taksì për vitin 2017</b>		
<b>Numri i Taxive</b>	Konsumi i dizelit (t/vit)	Energjia e konsumuar (kWh)
<b>24</b>	41.8	414,257

### **6.4.3 KONSUMI TOTAL I ENERGISË NË TRANSPORTIN PUBLIK**

Konsumi i përgjithshëm i karburanteve sipas kategorive të transportit publik në vitin 2017 është paraqitur në tabelën 21., ndërsa pjesëmarrja e burimeve të ndryshme të energjisë të transportit publik në është paraqitur në figurën 5.3.

**Tabela 21 Konsumi i karburantit në sektorin publik**

<b>Kategoria</b>	<b>Konsumi total i energjisë, kWh</b>			
	Nafta	Benzina	LPG- Gazi	Gjithsejte
<b>Transporti publik me autobus</b>	715,808	0	0	715,808
<b>Transporti me taksì</b>	414,257	0	0	414,257
<b>Gjithsejtë</b>	<b>1,130,064</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,130,064</b>

### Struktura e konsumit të karburantit në transportin publik




Figura 7: Pjesëmarrja e konsumit të karburanteve në sektorin e transportit publik

#### 6.4.4 AUTOMJETET PERSONALE DHE KOMERCIALE

Struktura e automjeteve të regjistruara sipas pronësisë dhe llojit është dhënë në tabelën 22 dhe figurat 8 dhe 9.

Tabela 22 Struktura e automjeteve të regjistruara sipas pronësisë dhe llojit në vitin 2017

AUTOMJETET E REGJISTRUARA								
2017	Total	Mopedë	Motoçikleta	Automjete personale	Automjete për shumë destini me	Automjetet të detyrës dhe shërbimeve	Automjetet komerciale	Tjera
<b>GJITHSEJ</b>	4600	20	53	3631	272	138	360	126
<b>Subjektet fizike</b>	4032	0	53	3539	272	0	130	38
<b>Subjektet juridike</b>	568	20	0	92	0	138	230	88

### Struktura e mjeteve të regjistruara sipas pronësisë




Figura 8: Struktura e automjeteve të regjistruara sipas pronësisë

### Struktura e mjeteve të regjistruara sipas pronësisë




Figura 9: Struktura e automjeteve të regjistruara sipas llojit

Struktura e automjeteve të regjistruara ose që operojnë në komunën e Deçanit përbëhet nga automjetet në pronësi private në masën prej 87.65 % ndërsa 12.35 % janë në pronësi të entiteteve legale. Kur bëhet fjalë për llojin e automjeteve, pjesa më e madhe i takon automjeteve personale (të udhëtarëve) që përbëjnë **78.93 %** të numrit të përgjithshëm të automjeteve. Nga pjesa tjetër e automjeteve automjetet komerciale marrin pjesë me **7.83 %**, automjetet për shumë destinime me **5.91 %**, automjetet e detyrës dhe shërbimeve me **3.00 %**, moped dhe motoçikletat me **1.58 %** dhe automjetet tjera me **2.74 %**.


### *Konsumi i karburantit të automjeteve personale dhe komerciale*

Nënsektori i automjeteve personale dhe komerciale të Komunës së Deçanit përbëhet nga kategoritë vijuese: automjetet personale, automjetet zyrtare dhe të ndërmarrjeve publike, automjetet komerciale, autobusët, mopedët dhe motoçikletat. Parametrat e konsumit të karburanteve nga automjetet personale dhe komerciale janë dhënë në tabelën 23 dhe figurën 9

**Tabela 23 Konsumi i karburanteve**

Konsumi i karburantit në vit	Benzinë (t)	Diesel (t)	GLN (t)	Konsumi energjisë (kWh)
Automjetet personale	428.3	1512.1	21.4	19,590,481
Automjete të detyrave dhe shërbimeve	0.0	173.9	0.0	1,721,412
Moped dhe motocikleta	14.3	0.0	0.0	133,362
Automjete komerciale	0.0	1728.0	0.0	17,107,200
Automjete tjera	0.0	205.3	0.0	2,032,502
<b>TOTALI</b>	<b>442.6</b>	<b>3619.3</b>	<b>21.4</b>	<b>40,584,957</b>

Struktura e konsumit të karburantit të transportit privat dhe tregtar




*Figura 9: Pjesëmarrja e konsumit të karburanteve sipas llojit të karburantit*

Në nënsektorin e automjeteve personale dhe komerciale, dizeli ka përqindjen më të lartë në konsumin total të karburantit të këtë nënsektor me **89.38 %**. Përqindja e konsumit të karburantit të benzines është **10.27 %**, dhe përqindja e gazit arrin në **0.35 %** të konsumit total të nënsektorit


Struktura e konsumit të karburantit për kategorinë e automjeteve dhe llojet e karburanteve janë dhënë në figurën 10 dhe 11

**Struktura e konsumit të karburantit të transportit privat dhe tregtar sipas kategorive**



*Figura 10: Struktura e konsumit te karburanteve sipas kategorisë së automjeteve*

**Konsumi i karburantit të transportit privat dhe komercial**



*Figura 11: Konsumi i karburanteve sipas kategorisë së automjeteve dhe llojit të karburantit*

Nga konsumit total i karburantit në nënsektorin e automjeteve personale dhe komerciale, **48.27%** shkon për veturat personale (te udhëtarëve), **42.15 %** e përbëjnë automjetet komerciale, ndërsa pjesa tjetër i takojnë kategorisë së automjeteve detyrave dhe shërbimeve, mopedëve/motocikletave dhe automjeteve tjera.


### **Analizat totale e energjisë në sektorin e transportit në Komunën e Deçanit**

Të dhënat e konsumit të karburantit për nënsektorët dhe llojit të karburantit në sektorin e transportit të Komunës së Deçanit janë paraqitur në tabelën 24

**Tabela 24 Konsumi i karburantit sipas nënsektorëve dhe llojit të karburantit në sektorin e transportit në Komunën e Deçanit në vitin 2017**

	<b>Benzinë (kWh)</b>	<b>Dizel (kWh)</b>	<b>Gazi (kWh)</b>	<b>GJITHESEJ T (kWh)</b>
<b>Flota e automjeteve komunale Komunës</b>	23,250	1,193,940	0	1,217,190
<b>Transporti publik</b>	0	1,130,064	0	1,130,064
<b>Automjetet udhëtarëve dhe komerciale</b>	4,219,738	39,613,146	145,000	43,977,885
<b>GJITHESEJT</b>	<b>4,242,988</b>	<b>41,937,150</b>	<b>145,000</b>	<b>46,325,139</b>

Struktura e konsumit të karburanteve të sektorit të transportit sipas nënsektorëve është paraqitur në figurën 12



*Figura 12: Struktura e konsumit të karburanteve sipas nënsektorëve në sektorin e transportit në Komunën e Deçanit*

Struktura e konsumit të karburanteve të sektorit të transportit sipas llojit të karburanteve është paraqitur në figurën 13.

### Struktura e konsumit të karburantit sipas llojeve të karburantit




Fig .13 Struktura e konsumit të karburanteve të sektorit të transportit

### Konsumi i karburantit të transportit privat dhe komercial




Figura 14: Konsumi i karburanteve në sektorin e transportit sipas llojit të karburanteve dhe nënsektorëve

Analiza e energjisë në sektorin e transportit në Komunën e Deçanit në vitin 2017 tregon se pjesa më e madhe e konsumit të karburantit i takon nënsektorit të automjeteve personale dhe komerciale (figura 5.9). Prandaj, masat e propozuara për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serë për sektorin e transportit janë të bazuara kryesisht në përpjekjet për të ndryshuar përqindjet e paraqitura në favor të transportit publik dhe në vetëdijesimin dhe promovimin e mënyrave të transportit të cilat janë miqësore për mjedisin.

Karburanti dukshëm më i konsumuar në krahasim me karburantet tjera është nafta me një pjesëmarrje prej **89.91 %** në konsumin e përgjithshëm. Pjesa tjetër e karburantit të konsumuar

është benzina me një pjesëmarrje prej **9.75 %**, dhe gazi i lëngëzuar i naftë (GLN) me një pjesëmarrje të vogël prej **0.33%** .

Konsumi i përgjithshëm i energjisë në sektorin e transportit të Komunës së Deçanit në vitin 2017 ka qenë **43,978 MWh** nga të cilat **94.5 %** i përkasin nënsektorit të automjeteve personale dhe komerciale, **2.7 %** në nënsektorin e transportit publik, dhe **2.9 %** të flotës së automjeteve komunale dhe të kompanive publike.

Nga analiza është evidente se nënsektori i automjeteve personale dhe komerciale është më i rëndësishmi, si në aspektin e konsumit të energjisë dhe në aspektin e kursimit potencial të energjisë. Rrjedhimisht, shumica e masave të propozuara do të synojnë kursime të konsiderueshme në nënsektorin e automjeteve personale dhe komerciale në sektorin e transportit të Komunës së Deçanit deri në vitin 2030.

## **7. OBJEKTIVAT DHE SHËNJESTRIMET LOKALE**

Objektivi i përgjithshëm i PVKEK është zvogëlimi i konsumit të energjisë në - ndërtesa publike, transport, ndriçim publik, ndërtesa rezidentciale dhe rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë, krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Deçanit, shfrytëzimi i burimeve të energjisë së ripërtëritshme.

PVKEK, pritet që në komunën e Deçanit, të ndikojë si në vijim:

- Krijimin dhe zhvillimin e sistemit për menaxhim të energjisë;
- Krijimin e kapaciteteve profesionale për planifikim, monitorim dhe raportim MVP;
- Ngritjen e vetëdijes për kursimin e energjisë të vendim marrësit, operatorët, dhe përdoruesit fundor;
- Përmirësimin e shërbimeve komunale;
- Zvogëlimin e konsumit të energjisë në objektet publike komunale, në ndriçimin publik dhe në transport;
- Reduktimin e kostove të energjisë për buxhetin komunal;
- Renovimin e sistemeve të energjisë dhe ndërtesave;
- Përmirësimin e kushteve sanitare dhe nivelit të rehatisë në ndërtesat publike;
- Ruajtjen e mjedisit përmes reduktimit të emetimeve të CO<sub>2</sub> dhe gazrave tjera me efekt serë përmes zbatimit të masave të EE.



## Përfitimet

- **Përfitimet financiare** - Kursimet në kostot e energjisë sjellin një përmirësim të bilancit fiskal. Prandaj EE paraqet një mundësi për komunën për të zvogëluar buxhetin për kostot e energjisë;
- **Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik** - Investimet në EE kanë ndikim pozitiv ekonomik, pasi ato kontribuojnë në zhvillimin e një industrie moderne që ofron punë dhe një sërë mundësish për zhvillimin e biznesit. Përveç kësaj, ato krijojnë të ardhura nga taksat për punët ndërtimore të nevojshme për zbatimin e masave të EE;
- **Rritja e komoditetit/rehatisë** - përmes investimeve në fushën e EE rritet rehatia, gjë që mund të ndikojë në rritjen e produktivitetit;
- **Siguria e furnizimit me energji** - Përmirësimi i efikasitetit të energjisë sjell besueshmëri dhe siguri më të madhe të furnizimit me energji dhe demonstroi gatishmërinë e komunës për të qenë një shembull për të promovuar agjendën kombëtare për EE;
- **Mbrojtja e mjedisit** - zvogëlimi i konsumit të energjisë, zvogëlon nevojën për rritjen e prodhimit dhe kapaciteteve të prodhimit të energjisë, kjo ndikon drejtpërdrejtë në zvogëlimin e emisioneve të dëmshme për ambientin.

### 7.1 REDUKTIMET E GAZRAVE SERRË

Masat e përgjithshme përfshijnë masat të cilat vlejnë për tërë sektorin e ndërtesave në Komunën e Deçanit janë të ndara në dy nënkategori kryesore:

- Masat për eliminimin e pengesave që pengojnë monitorimin dhe kontrollin e konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave të Komunës së Deçanit;
- Skemat e bashkëfinancimit për zbatimin e masave të identifikuar të efikasitetit të energjisë në të gjithë nënsektorët

Masat për eliminimin e pengesave që pengojnë monitorimin dhe kontrollin e konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave të Komunës së Deçanit janë:

- Miratimi i metodologjisë për mbledhjen e treguesve përkatës të energjisë për sektorin e ndërtesave të Komunës së Deçanit, në përputhje me klasifikimin e ndërtesave të përdorura në këtë PVKEK (1. ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit, 2. ndërtesat e banimit; 3. ndërtesat komerciale dhe të shërbimeve);
- Mbledhja e treguesve (indikatorëve) përkatës të energjisë duke përdorur metodologjinë e zhvilluar në çdo vit, muaj apo ditë (në varësi të llojit të treguesit). Treguesit do të mbledhen nga sistemet automatike të kontrollit nga largësia ose me dorë, për kontrollin shtesë;

- Përgatitja e sistemit të informacionit të menaxhimit të energjisë për Komunën e Deçanit që do të përmbajë të gjitha të dhënat dhe treguesit e mbledhur dhe do të mundësojë përgatitjen e të gjitha analizave të nevojshme.

Duhet vënë në pah se këto masa janë shumë të rëndësishme, sepse nuk është e mundur që të monitorohen tendencat reale në konsumin e energjisë dhe zvogëlimin e emisioneve korresponduese të CO<sub>2</sub> në sektorin e ndërtesave, pa mbledhjen e treguesve përkatës të energjisë në përputhje me metodologjinë e qartë. Rrjedhimisht, nuk do të jetë e mundur për të përcaktuar nëse është arritur apo jo qëllimi i përcaktuara nga PVKEK që duhet të realizohet gjer në vitin 2030.

Nën-kategoria tjetër e masave të përgjithshme, me ndikim të fuqishëm në zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> në Komunën e Deçanit përfshin përgatitjen e një skeme të bashkë-financimit të zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë të identifikuar për tërë sektorin e ndërtesave. Përvoja e të gjitha qyteteve evropiane me energji të qëndrueshme dhe të zhvilluara tregon se, pa programet e bashkë-financimit dhe programet tjera të ndryshme mbështetëse të administratës së komunës, zbatimi i masave të mjaftueshme të efikasitetit të energjisë e cila duhet të rezultojë në zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> së paku për 40%, gjer në vitin 2030, nuk mund të pritët.

Masat e përgjithshme të propozuara të kësaj nën-kategorie janë:

- Aplikimi i skemave stimuluese në Komunën e Deçanit (fondet e pakthyeshme, subvencione, dhe të ngjashme) për ndërtimin dhe rindërtimin e ndërtesave sipas shpenzimit të ulët të energjisë dhe standardeve pasive;
- Aplikimi i skemave stimuluese në Komunën e Deçanit (fondet e pakthyeshme, subvencione, dhe të ngjashme) për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në ndërtesa (sisteme foto-voltaike, kolektorët solar, kaldajat me pellet, dhe të ngjashme).
- Lidhur me këtë nën-kategori të masave të përgjithshme, është e vështirë për të vlerësuar në mënyrë sasiore ndikimin e tyre në kursimin e energjisë dhe zvogëlimin korrespondues në emisionet e CO<sub>2</sub>. Por, është e sigurt se, pa realizimin e tyre, nuk do të jetë e mundur të realizohen qëllimet e planifikuara të zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> së paku për 40% gjer në vitin 2030.

## 7.2 ENERGJI E RINOVUESHME

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026 parasheh disa aktivitete për zhvillimin e BRE-ve:

Zhvillimin e Planit të Veprimit për BRE-të për periudhën prej vitit 2021 e me tej në përputhje me kërkesat e Direktivës së BRE-ve dhe bazuar në studimin paraprak.

Thjeshtësimin e procedurave të autorizimit për projektet e BRE-ve dhe harmonizimin e afateve ligjore të pëlqimeve dhe lejeve të nevojshme në përputhje edhe me jetëgjatësinë e teknologjive,

### 7.3 EFIÇIENCA E ENERGISË

Komuna e Deçanit është një ndër Komunitetet e para në Kosovë në aplikimin e masave të EE në sektorin Publik, si dhe hartimin e politikave të EE si dhe zbatimin e tyre.

### 7.4 VARFËRIA ENERGETIKE

Mungesa e burimeve të energjisë, mungesa e ngrohjeve qendrore, mungesa e masave të EE dhe BRE, kushtet ekonomike, të bëjnë që Kosova të jetë në këto pozicione sa i përket varfërisë energjetike, që është ndër nëntë palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, Kosova ka numrin më të madh të amvisërive që jetojnë në varfëri energjetike, apo deri në 40 përqind, ndërsa Mali i Zi më të ulët, apo rreth 8-15%.

Kështu thuhet në studimin e ri që adreson varfërinë energjetike tek anëtarët e Komunitetit të Energjisë, ka raportuar Balkan Green Energy News.

Sipas përkufizimit, varfëria energjetike i referohet individëve, amvisërive apo komuniteteve që nuk kanë çasje dhe nuk mund të mbulojnë mjaftueshëm energji elektrike për nevojat bazike.

Për shkak të mungesës së të dhënave të sakta dhe për shkak të konfidencialitetit të të dhënave, ky studim ka përllogaritur përqindjen e amvisërive me varfëri energjetike në mënyrë të saktë vetëm për katër palët kontraktuese: Mal të Zi 8-15%, Serbi 7-22%, Ukrainë 13-18%, dhe pjesërisht, Gjeorgji – deri në 24.6%

Për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, studimi ka paraqitur vetëm shifra të përafërta.

Deri në 37 përqind të të gjitha amvisërive në Shqipëri vuajnë nga varfëria energjetike, krahasuar me Kosovën ku kjo shifër arritë në 40% dhe Maqedoninë e Veriut, në 33 përqind.

Sipas po të njëjtit raport, praktikat e subvencionimit të konsumatorëve të cenueshëm nuk sigurojnë mbështetje për të gjitha amvisëritë që jetojnë në varfëri energjetike.

Raporti ka theksuar se palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë i përkufizojnë konsumatorët e cenueshëm duke u bazuar në gjendje të tyre sociale, të ardhurat dhe gjendjen shëndetësore, duke lënë mënjanë efikasitetin e energjisë, gjininë dhe nevojat për energji elektrik.

Sipas raportit, një nga mangësitë e kornizave rregulluese ka të bëjë me masat që zbatohen për të ndihmuar konsumatorët që jetojnë në varfëri energjetike.

‘Palët kontraktuese zbatojnë vetëm masa që përkrahin të ardhurat për të mbrojtur konsumatorët e cenueshëm. Këto masa zvogëlojnë varfërinë energjetike vetëm përkohësisht, pa ndikuar në shkaktarët kryesorë të saj’, ka thënë Sekretariati.

Masat e rekomanduara përfshijnë përkrahjen për masa të efikasitetit të energjisë në ndërtesa, zëvendësimin e pajisjeve elektrike, përmirësimin e sistemeve të ngrohjes dhe përkrahjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Raporti i ri ka propozuar që këto masa të përfshihen në planet kombëtare të energjisë dhe klimës (NECP-të) dhe në planet kombëtare të veprimit për efikasitet të energjisë.

Megjithatë në Komunën e Deçanit janë të regjistruar **320** familje si raste sociale për të cilët subvencionohet për familje deri në **250 kWh/muaj** ose total **960MWh/vit** energji elektrike nga Qeveria.

## 7.5 ANALIZAT E EMETIMEVE TË GAZRAVE SERRË

### 7.5.1 INVENTARI REFERENCIAL I CO<sub>2</sub>

Emisioni i CO<sub>2</sub> nga sektori i ndërtesave në Komunën e Deçanit përfshin emisionin nga konsumi i energjisë elektrike, si dhe nga djegia e lëndëve djegëse. Emision nga djegia e lëndëve djegëse llogaritet përmes faktorëve standard të emisionit (niveli i parë i llogaritjes sipas metodologjisë së IPCC), ndërsa për llogaritjen e emisionit nga konsumi i energjisë elektrike është përdorur vlera zyrtare e emisionit në Republikën e Kosovës (tabela 25).

**Tabela 25 : Faktorët e emisioneve të përdorura për përcaktimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> në sektorin e ndërtesave**


Burimi i energjisë	Faktorët e emisionit	
	t CO <sub>2</sub> /TJ	t CO <sub>2</sub> /MWh
Lignit	98.06	0.353
Ngrohja qendrore	60.83	0.219
Dru zjarri	0.00	0.000
Benzina	69.17	0.249
Dizeli	75.56	0.272
LPG - gazi	62.50	0.225
Energjia elektrike	399.44	1.438

Vlerat e emisioneve të CO<sub>2</sub> si rezultat i përdorimit të energjisë në sektorin e ndërtesave janë prezantuar në tabelën 26 dhe Figurën 14.


Emetimet totale duhet të llogariten sipas faktorëve të emetimit në tabelën e mësipërme dhe duhet të paraqiten në formatin e tabelës sipas shembullit më poshtë.

**Tabela 26. Faktori parësor i energjisë**

KATEGORIA	EMISIONI (t CO <sub>2</sub> )				
	Nga konsumi i energjisë elektrike	Nga konsumi i dizelit	Nga Konsumi i Drurit	Nga konsumi i peletit	Gjithsejtë
NDERTESAT KOMUNALE					
Institucionet arsimore	244.67	0	95.89	0	340.57
Ndërtesat e shëndetësisë	261.49	0	11.92	0	273.41
Ndërtesat e administratës	173.67	0	173.67	0	347.35
Ndërtesat e kulturës	0.16	0	0.93	0	1.09
<b>Gjithsejtë</b>	<b>679.99</b>	<b>0.00</b>	<b>282.41</b>	<b>0.00</b>	<b>962.40</b>
Transporti					
<b>Transporti public-</b>	<b>0</b>	<b>11,039.11</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>11,039.11</b>
NDERTESAT KOMERCIALE					
<b>Gjithsejtë</b>	<b>1,865.97</b>	<b>0</b>	<b>1,638.66</b>	<b>0</b>	<b>3,504.63</b>
NDERTESAT E BANIMIT					
<b>Gjithsejtë</b>	<b>10,428.61</b>	<b>0</b>	<b>3,086.51</b>	<b>0</b>	<b>13,515.12</b>
<b>Totali i pergjithshem</b>	<b>12,974.57</b>	<b>11,039.11</b>	<b>5,007.59</b>	<b>0.00</b>	<b>29,021.26</b>




*Fig 14 Emisioni i Co2 ne te gjithë sektorët*



*Figura 15: Pjesëmarrja e llojit individual të energjisë në emisionin total të CO<sub>2</sub> në sektorin e ndërtesave në Komunën e Deçanit*

Në mesin e nënsektorëve në sektorin e ndërtesave, pjesa më e lartë në emisionin total i përket ndërtesave të banimit (**59%**), pasuar nga ndërtesat komerciale dhe të shërbimeve (**40%**), dhe objekteve në pronësi të Komunës së Deçanit (**1%**) (figura 15).



## 8. POLITIKAT DHE MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS TË ENERGIJË, EMETIMI, BRE DHE GS

Ky kapitull përfshin studimin e të gjitha masave që do të rezultojnë, nëse zbatohen, në përmirësimin e efiçencës të energjisë, të BRE dhe reduktimit të emetimeve të CO<sub>2</sub> në Komunë, pavarësisht se cilat do të jenë kostot e investimit, potencialet e kursimit të energjisë dhe qëndrueshmëria ekonomike e energjisë në rast të zbatimit të tyre.

## 8.1 POLITIKAT DHE MASAT LOKALE

Ky kapitull përfshin të gjitha masat për hartimin e politikave komunale, promovimin dhe ndryshimin e sjelljeve si dhe të gjitha masat EE, masat BRE dhe masat e emetimit të CO<sub>2</sub> siç janë paraqitur në nënkapitujt e mëposhtëm

## 8.2 MASAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË

Përshtet masat e efiçencës së energjisë dhe mënyrat e mundshme të zbatimit. Bazuar në studime dhe auditime të ndryshme të energjisë dhe bazuar në rekomandimet e BE -së të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, masat më të favorshme të efiçencës së energjisë në aspektin e raportit kosto/përfitim janë:

- Izolimi termik mbështjellës i ndërtesës
- Zëvendësimi i dritareve me xham të ulët e të dyfishtë ose të trefishtë
- Zëvendësimi i sistemit të ngrohjes me një më efikas
- Instalimi i një sistemi efikas ndriçimi LED

**Tab.27. Caku dhe niveli i kursimit të energjisë në raport me konsumin e përgjithshëm mesatar vjetor të energjisë në të gjithë sektorët**

Sektori	Konsumi mesatar vjetor i energjisë	Kostoja mesatare vjetore e konsumit të energjisë	Caku i kursimit të energjisë në kuadër të planit 2023-2030	Caku i kursimit të energjisë në kuadër të planit 2023-2030	Emetimi i CO <sub>2</sub>	Caku i reduktimit të emetimeve të CO <sub>2</sub> në kuadër të planit 2023-2030	Kosto e investimeve në masa të EE për plotësimin e caktit të kursimit të energjisë
	MWh/v	€/v	MWh/v	%		t	t
<b>Ndërtesat publike komunale</b>	3,602.67	€ 162,120.11	3,782.80	13%	789.34	118.4	587,120.00
<b>Ndriçimi i rrugëve</b>	1,815.95	€ 259,754.96	5,084.67	29%	18,177.70	7,271.08	2,400,000.00
<b>Ndërtesat e sektorit rezidencial</b>	55,651.88	€ 2,504,334.60	222,396.93	36%	12,193.33	6,961.02	21,306,048.00
<b>Ndërtesat Komerciale</b>	10,758.93	€ 484,151.85	112,682.43	60%	2,357.28	3,526.96	8,716,800.00
<b>Transporti</b>	40,584.96	€ 6,087,743.55	48,296.10	15%	77,273.76	13,136.54	350,000.00
<b>Bujqësia</b>	2,532.48	€ 379,872.00	2,304.56	12%	4,821.84	626.84	150,000.00
<b>Gjithsej</b>	<b>114,946.87</b>	<b>9,877,977.07</b>	<b>394,547.49</b>	<b>27.5%</b>	<b>115,613.25</b>	<b>31,640.84</b>	<b>33,509,968.00</b>

## 8.2.1 MASAT PER EFIÇIENCË TË ENERGIJISË NË NDËRTESAT E BANIMIT

Me qëllim të reduktimit të konsumit energjetik, në sektorin e banimit mund të merren masat e efiçencës së energjisë si:

- Izolimi termik i mureve të ndërtesës;
- Ndërrimin e dritareve të vjetra me karakteristika të dobëta termike me dritare të reja me karakteristika termike dukshëm më të mira;
- Izolimi termik i pllakës së tavanit;
- Izolimi termik i dyshemesë - kjo masë duhet analizuar mirë për të parë nëse kostoja e renovimit është e arsyeshme;
- Ndërrimi i poçeve me ato efiçiente – LED;
- Zëvendësimi i sistemeve joefiçiente të ngrohjes me ato efiçiente, duke synuar që si burim energjetik të jetë peleti;
- Instalimi dhe funksionalizimi i sistemeve diellore për ngrohjen e ujit sanitar,

Siç shihet nga të dhënat më lartë, pothuajse shumica e ndërtesave kanë potencial për kursim të energjisë, edhe ato ndërtesa të cilat sipas konsumit aktual nuk konsiderohen se kanë potencial për kursim të energjisë kanë nevojë për zbatim të masave të EE. Megjithatë, është e pa mundur që në periudhën tre vjeçare sa planifikohet të jetë ky plan, të bëhen investime në të gjitha ndërtesat. Mbi bazën e kësaj, janë përzgjedhur ndërtesat për të cilat mund të bëhen investime. Për përzgjedhjen e ndërtesave në kuadër të këtij plani janë trajtuar tre opsione:

Opsioni 1- Përzgjedhja e ndërtesave duke u bazuar vetëm në nivelin e konsumit specifik vjetor të energjisë më të lartë. Bazuar në analizën që është bërë, konsumi specifik nuk është tregues real i gjendjes së një ndërtese, meqë ka ndërtesa të cilat janë në gjendje jo të mirë sa i përket performancës energjetike dhe kanë konsum të vogël specifik vjetor të energjisë dhe anasjelltas.

Opsioni 2. Përzgjedhja e ndërtesave duke u bazuar vetëm në nivelin e kursimit më të lartë vjetor të energjisë. Ky do të ishte një opsion i mirë për komunën meqë do të merreshin masa të EE në ndërtesa që kanë potencial të madh të kursimit Megjithatë mbi bazën e këtij opsioni do të mbesin pa u futur në plan një numër i ndërtesave që janë në gjendje jo të mirë sa i përket komfortit, komponent e cila duhet të merret në vazhdimësi në konsideratë.

Opsioni 3. Sipas të cilit do të merren në konsideratë një numër më i madh i kritereve si në vijim:

- Konsumi specifik vjetor i energjisë;
- Karakteristikat teknike të ndërtesës dhe niveli i masave të EE të zbatuara;
- Investimet që janë bërë në ndërtesë viteve të fundit;
- Prioriteteve të vendosura nga komuna e Deçanit për investime në periudhën 2022-2030;

Për përzgjedhjen e ndërtesave, është marr në konsideratë opsioni 3. Konsiderohet se është opsioni më i mirë duke pasur për bazë gjendjen reale që aktualisht janë ndërtesat.

Këto ndërtesa janë ndarë në dy grupe. Ndarja e tillë është bërë duke u bazuar në konsumin mesatar vjetor të energjisë dhe potencialin e kursimit:



Grupi 1- janë ndërtesat të cilat konsiderohen me prioritet për investime dhe sipas të dhënave të konsumit energjetik në tri vitet e fundit, është llogaritur së këto ndërtesa kanë potencial për kursim të energjisë.

Grupi 2 - janë ndërtesat të cilat konsiderohen me prioritet për investime në masa të EE por sipas të dhënave të konsumit energjetik në tri vitet e fundit, është llogaritur së këto ndërtesa nuk kanë potencial për kursim të energjisë.

Ndërtesat e përzgjedhura për renovim në kudër të këtij plani janë të renditura sipas konsumit specifik vjetor të energjisë.

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Skema e stimulimit për renovimin e shtëpive individuale dhe blloqeve multi-apartament (MFH).</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit ME
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2022-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	35,000 për vit; 350,000 € në total
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	196 MWh Energjia termike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO2)</b>	225
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Komuna e Deçanit - masat e politikave
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Skema e subvencionimit është e bazuar në kriterin e mëposhtme:</p> <p>Cilësia minimale termike për marrjen e subvencionit;</p> <p>Rritjen e subvencionit me përmirësimin e cilësisë termik pas rinovimit;</p> <p>Në sektorin e ndërtesave: mbështetja shtesë sociale për familjet me të ardhura të ulëta,</p> <p>Gjer tani, pjesa dominuese e ndërtesave kolektive në Deçan përbëhet nga ndërtesat shumëkatëshe. Pronarët e tyre nuk janë në gjendje të mbulojnë të gjitha shpenzimet për renovimin e plotë të ndërtesës, e kjo zakonisht është një pengesë e madhe për rinovimin ose çon në rinovimin me cilësi të ulët. Prandaj, skemat e subvencioneve janë instrumente të rëndësishme për rritjen e kualitetit të rinovimit termikë.</p> <p>Bazuar ne te dhënat e KEDS, muajt referent janë marrur gjysma e muajt maje dhe gjysma e muajt shtator duke ber dallimet ne mes te muajve tjerë ka dal se vetëm 7% e energjisë elektrike shpenzohet për ngrohje.</p>

	Me implementimin e masave EE në mbështjellësin e ndërtesave dhe sistemin e ngrohjes, kursimet specifike të energjisë janë 149 kWh/m <sup>2</sup> /vit, (izolimi i fasadave, izolimet e kulmeve dhe ndërrimi i dritareve).
--	---

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>2. Skema e stimulimit për instalimin e kolektorëve diellorë në 500 shtëpi ekzistuese të banimit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	- Sektori i biznesit - Komuna e Deçanit - ME
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2022-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	586,000 € (15% nga kjo shumë do të subvencionohet, 85% do të paguhet nga pronarët e apartamenteve)
<b>Vlerësimi i energjisë së kursyer (MWh)</b>	1,100 Energjia termike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	1,582
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës së Deçanit Donatorët Sektori privat Institucionet financiare
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Arsyeshmëria ekonomike dhe kthimi relativisht i favorshëm për investime mund të arrihet përmes kërkesës së madhe për ujë të ngrohtë në baza ditore dhe vjetore.</p> <p>Hapat e mëposhtëm janë të nevojshëm për të arritur një zbatim efikas të kësaj mase:</p> <p>Subvencionet më shumë se 15%, nga buxheti komunal ose/dhe institucionet e ndryshme financiare;</p> <p>Institucionet akademike dhe shkencore duhet të zhvillojnë projekte të zbatueshme për të ndihmuar prodhuesit vendor të pajisjeve;</p> <p>Të themelohen dhe të akreditohen laboratorët për të testuar cilësinë e pajisjeve të prodhuara;</p> <p>Të organizohet fushata informuese që do t'iu mundëson konsumatorëve që të njihen me cilësinë e pajisjeve të ofruara dhe përfitimet nga përdorimi i tyre.</p>

	Është llogaritur skema e stimulimit për 500 familjet me rreth 109 m <sup>2</sup> hapësira të shfrytëzueshme. Kursimet e energjisë që rrjedhin nga këto masa janë llogaritur se do të jenë 550 kWh/m <sup>2</sup> të sipërfaqes me kolektorë diellorë. Përfundimisht për një shtëpi tipike do të instalohen 4 m <sup>2</sup> kolektorët diellor.
--	---

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>3. Vendosja e sistemeve të ngrohjes me pellet me efikasitet të lartë të shfrytëzimit, në vend të ngrohjes me rrymë në sektorin amvisërisë</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2022-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	37,500
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	Nuk ka kursim të energjisë
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	306
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Kjo masë ka për qëllim zëvendësimin e ngrohjes së familjeve me energji elektrike, nëpërmjet sistemeve të ngrohjes me biomasë në trajtë pelleti. Kaldajat moderne me pellet karakterizohen me efikasitet të lartë të shfrytëzimit ndërsa sa i përket emitimit pelleti konsiderohet neutral ndaj mjedisit. Një masë e tillë rekomandohet të subvencionohet nga Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë.</p> <p>Nëpërmjet kësaj mase planifikohet të zëvendësohen sistemet e ngrohjes në afërsisht 15 objekte familjare, me sipërfaqe mesatare të shfrytëzueshme rreth 109 m<sup>2</sup> për familje.</p> <p>Zbatimi i kësaj mase deri në vitin 2030, nuk do të ketë ndikim në uljen e konsumit të energjisë por do të ketë ndikim të madh në zvogëlimin e CO<sub>2</sub> të emituar, krahasuar me emitimin nga sistemet elektrike të ngrohjes në vitin 2017.</p>

## **9. ZBATIMI I MASAVE TE EFIÇENCËS SË ENERGIJISË NË NDËRTE SAT ADMINISTRATIVE, ARSIMIT DHE SHENDETSISE**

Ky kapitull përfshin të gjitha masat e efiçencë të energjisë që mund të zbatohen në sektorin e ndërtesave publike, të cilat mund të ndahen në tri grupe kryesore: Aktivitetet përgatitore, Aktivitetet e zbatimit të projektit dhe Masat legislative.

Aktivitetet përgatitore mund të jenë si më poshtë:

- Prezentimi i Sistemit Informativ të Menaxhimit të Energjisë
- Mbledhja e centralizuar e të gjitha të dhënave përkatëse për ndërtesat (karakteristikat e ndërtesës, mosha e ndërtesave, viti dhe përshkrimi i rindërtimeve, konsumi i energjisë për të gjitha llojet e energjisë, faturat mujore për energjinë e konsumuar dhe të ngjashme)
- Sistemi i leximit në distancë i energjisë së konsumuar
- Përgatitja dhe përditësimi i vazhdueshëm i regjistrit të ndërtesave
- Kryerja e inspektimeve të energjisë në ndërtesa, etj

Aktivitetet e zbatimit të projektit mund të jenë si më poshtë:

- Izolimi termik mbështjellës i ndërtesës
- Zëvendësimi i dritareve me xham me emetim të ulët e të dyfishtë ose të trefishtë
- Zëvendësimi i sistemit të ngrohjes me një më efikas
- Instalimi i një sistemi efikas ndriçimi LED
- Instalimi i BMS
- Instalimi i valvulave balancuese TRV, etj

Masat legislative mund të jenë si të paraqitura më poshtë:

- Prezentimi i Prokurimit Publik të Gjellbër për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për ndërtesat në pronësi të komunës;
- Marrja e vendimeve nga Kuvendi Komunal i cili kërkon që të gjitha ndërtesat e reja në pronësi të Komunës të përdorin, të paktën, një burim optimal të energjisë së rinovueshme (sisteme fotovoltaike, kolektorë diellorë, pompa për ngrohje, etj.).

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Informimi i punëtorëve / shfrytëzuesve të ndërtesave në pronësi të komunës së Deçanit për menaxhim të energjisë</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	23,000
<b>Vlerësimi i energjisë së kursyer (MWh)</b>	24 - Energjia elektrike 180 - Energjia termike 204 - total
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	34.5 – nga energjia elektrike 7.4 – nga energjia termike 41.9 – total
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës së Deçanit Buxheti nacional Donatorët, IFN
<b>Përshkrimi i shkurte/komentet</b>	<p>Kjo masë përfshin një sërë aktiviteteve arsimore që kërkojnë ndërmarrjen e rregullt – organizimin e ngjarjeve çdo tre muaj dhe duke vepruar në pajtim me të:</p> <p>Organizimi i punëtorëve arsimore për kursimin e energjisë;</p> <p>Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve arsimore (fletushka, postera, stikersa, etj.);</p> <p>Organizimi i diskutimeve dhe ngjarje të ngjashme.</p> <p>Përveç aktiviteteve edukative të parapara në kuadër të kësaj mase, ka nevojë për marrëveshje stimuluese të kursimit të energjisë (p.sh. marrëveshja 50/50) brenda së cilës një pjesë e fondit financiar që vjen nga kursimet e realizuara të energjisë mbetet në dispozicion të institucioneve individuale në të cilat janë realizuar kursimet.</p> <p>Konsumi total i energjisë termike për ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit, në vitin 2017 ishte 3.602,7 MWh/vit, ndërsa konsumi i energjisë elektrike vlerësohet të jetë 475.7 MWh/vit.</p>

Numri/Masa/Emri i aktivitetit	2. Skema e certifikimit për ndërtesa
<b>Autoriteti implementues</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komuna e Deçanit</li> <li>- ME</li> <li>- MMPHI</li> <li>- Ekspertet e pavarur për energji (të certifikuar)</li> </ul>
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	80,000
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	3,500 – energji termike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	189
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Financimi do të paguhet nga institucionet dhe organizatat të cilat janë të obliguara ta bëjnë auditimin e energjisë, si dhe nga pronaret e banesave të cilat do të merren me qira ose të cilat do të shitën.
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	Në përputhje kornizën ligjore (Ligji për Efiçencën e Energjisë dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 01/12 për Auditimet Energjetike), skema e certifikimit të ndërtesave duhet të vihet në zbatim me qëllim të bërjes më transparente të konsumit të energjisë të ndërtesave ndaj konsumatorëve dhe/ose qiramarrësit.

*Ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit*

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Izolimi termik i fasadave dhe kulmeve në 7 ndërtesa në pronësi të Komunës së Deçanit- Arsim, Shëndetësi dhe Administratë</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	587,120.00
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	<b>491.72 - Energjia termike</b>
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	35.5
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Buxheti i komunës se Deçanit</li> <li>• FKKEE</li> <li>• ME</li> <li>• Shërbime te Energjisë ESCO</li> <li>• Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal.</li> </ul>
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Instalimi i plotë i fasadës së murit dhe izolimi termik i çatisë 7 ndërtesa në pronësi të komunës, me sipërfaqe totale që ngrohet prej rreth 7339m<sup>2</sup>. Kursimi i energjisë termike konsiderohet në rreth 67 kWh/m<sup>2</sup>, ndërsa kostoja e investimeve është rreth 80 €/ m<sup>2</sup>.</p> <p>Është e rekomanduar që prioritet në izolimin termik duhet të jepen për institucionet që kanë nevojë për masat e EE ne tri shkolla “Sylejman Vokshi” Prejlep, “Ardhmëria” Beleg dhe “Syle Alaj” Drenoc dhe KK Deçan, si dhe QKMF të Komunës së Deçanit).</p>

Numri/Masa/Emri i aktivitetit	2. Pakoja e instrumenteve për promovimin e instalimit të kolektorëve solar për ngrohjen e ujit
<b>Autoriteti implementues</b>	Buxheti i komunës së Deçanit FKEE ME Shërbime të Energjisë ESCO Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal. Donator tjer
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	750,000
<b>Vlerësimi i energjisë së kursyer (MWh)</b>	E përfshirë në masën 2
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (kt CO<sub>2</sub>)</b>	
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Financimi do të sigurohet kryesisht gjatë Promovimit të tregut të nxehjes së ujit nga sistemet solare. Një fond plotësues mund të sigurohet nga komuna.
<b>Përshkrimi i shkurte/komentet</b>	<p>Zbatimi i suksesshëm i projektit për ngrohëset e ujit nga sistemet solare do të rezultojë në rritjen e shfrytëzimit të ngrohjes së ujit nga sistemet solare në ndërtesa të banimit dhe kështu duke ndikuar në zvogëlimin e madh të konsumit të energjisë elektrike për ngrohjen e ujit.</p> <p>Informimi i konsumatorëve në lidhje me kursimet e vazhdueshme të energjisë në rastin e instalimit të kolektorëve solar</p> <p>Takimet për të promovuar shfrytëzimin racional të energjisë dhe zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> në rastin e instalimit të kolektorëve solar</p> <p>Kursimet e energjisë duke implementuar masat të cilat përfshijnë ngritjen arsimore dhe vetëdijësimin e grupeve të ndryshme të fokusit</p>



<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>3. Instalimi i valvulave termostatike në radiatorë në të gjitha ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	40€ / valve termostatike, total 35,000€
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	80 MWh – energji termike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (kt CO<sub>2</sub>)</b>	3
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës se Deçanit FKEE ME Shërbime te Energjisë ESCO Fondet regjionale (BEI, KfW)
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Kjo masë parasheh instalimin e seteve termike (valvave termostatike) në pjese e mbetur të ndërtesave në pronësi të Komunës së Deçanit deri në vitin 2030, sipërfaqja ngrohëse totale e të cilave është afërsisht 5000m<sup>2</sup>.</p> <p>Bazuar në rezultatet e fituara nga auditimet e shumta të energjisë në ndërtesat publike, numri mesatar i radiatorëve arrin në 0,0517 radiatorë/m<sup>2</sup>, ose 1 radiator për 20m<sup>2</sup>.. Prandaj, kjo masë duhet të përfshijë instalimin e 250 valvave termostatike në të gjithë radiatorët. Kursimi i energjisë termike është vlerësuar në 16 kWh/m<sup>2</sup>, ndërsa çmimi për një komplet të termostatit është rreth 40 €.</p>

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>4. Instalimi i termometrave në çdo dhomë të objekteve në pronësi të Komunës së Deçanit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2020-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	2,500€
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	72 MWh – energji termike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub> / vit)</b>	3
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Buxheti i komunës se Deçanit</li> <li>• Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë</li> </ul>
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Instalimi i termometrave të murit në çdo dhomë (zyrat, dhomat e takimit, etj.) ofron pasqyrën e temperaturës së dhomave dhe lejon rregullimin e temperaturës, dhe rregullon sistemet e ngrohjes/ftohjes.</p> <p>Përveç vendosjes se termometrave, masa parasheh këto aktivitete fillestare arsimore:</p> <p>Termometrat do të mbajnë shenjën e cila tregon: "1°C kursen energji gjer në 6%".</p> <p>Pas instalimit të termometrit në dhomë, përdoruesit do të informohen për qëllimin e masës dhe mënyrat për zbatimin e tij të suksesshëm.</p> <p>Përgatitja dhe shpërndarja e fletushkave.</p> <p>Bazuar në përvojat ndërkombëtare, kjo masë mund të zvogëlojë më shumë se 2% të konsumit të energjisë termike në ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit e cila në vitin 2017 është vlerësuar të jetë 3,603 MWh.</p> <p>Masa mund të zbatohet menjëherë, pasi ajo nuk ka kosto të lartë e as nuk kërkon përgatitje të madhe logjistike për implementim.</p>

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>5. Instalimi i llambave për kursimin e energjisë në ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron (vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	1,300,000.00euro
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	300 MWh - Energjia elektrike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	403
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Buxheti i komunës se Deçanit</li> <li>• FKKEE</li> <li>• ME</li> <li>• Shërbime te Energjisë ESCO</li> <li>• Fondet regjionale (BEI, KfW)</li> </ul>
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Rregullorja e BE-së qe ka të bëjë me produktet e ndriçimit (Rregullorja e KE 244/2009) ka paraparë ndalimin e prodhimit të llambave tradicionale inkandeshente qysh në vitin 2016.</p> <p>Vendimi i Qeverisë me date 14.09.2022 nr 28/96 per masa ne ndriçim</p> <p>UA (MEA) Nr. 03 2020 Lidhur me kërkesat e Efiçencës se Energjisë për Blerjen e Produkteve Shërbimeve dhe Ndërtesave nga Institucionet e Nivelit Qendror.</p> <p>Në këtë mënyrë është të gjitha llambat inkandeshente tashmë është dashur të zëvendësohen me llamba efiçiente. Edhe në rastin e llambave efiçiente fluoreshente, rekomandohet zëvendësimi i tyre me llamba edhe më efiçiente dhe me jetëgjatësi më të madhe siç janë lampat LED</p> <p>Kjo masë synon zëvendësimin e llambave konvencionale ose atyre fluoreshente me llamba LED me qëllim të kursimi të energjisë në të gjithë ndërtesat në pronësi të komunës. Kjo masë do të mundëson rënie të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike gjer në 16% gjer në krahasim me konsumin në vitin 2017</p>

## 9.1 SEKTORI I KULTURËS DHE SPORTIT

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Zbatimi i masave te EE dhe BRE ne Pallatin e Kulturës</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	313,272.08
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	<b>Energjia termike</b>
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	35.5
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës se Deçanit FKEE
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Instalimi i plotë i fasadës së murit dhe izolimi termik i çatisë kjo mase do te zbatohet ne vitin 2023, me sipërfaqe totale që ngrohet prej rreth 3,500 m<sup>2</sup>. Kursimi i energjisë termike konsiderohet në rreth 67 kWh/m<sup>2</sup>, ndërsa kostoja e investimeve është rreth 60 €/ m<sup>2</sup>.</p> <p>Zbatimi i masave te EE tash eshte duke u Aplikuar nga FKEE.</p>

## 9.2 NDRIÇIMI PUBLIK I RRUGËVE

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Instalimi i llambave për kursimin e energjisë në ndriçim publik, Instalimi i kontrollit të ndriçimit publik dhe sistemit të menaxhimit në Komunën e Deçanit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron (vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	1,700,000.00euro
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	1400MWh - Energjia elektrike

<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Buxheti i komunës së Deçanit</li> <li>• Shërbime të Energjisë ESCO</li> </ul>
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Rregullorja e BE-së që ka të bëjë me produktet e ndriçimit (Rregullorja e KE 244/2009) ka paraparë ndalimin e prodhimit të llambave tradicionale inkandeshente qysh në vitin 2016.</p> <p>Vendimi i Qeverisë me datë 14.09.2022 nr 28/96 për masa në ndriçim</p> <p>UA (MEA) Nr. 03 2020 Lidhur me kërkesat e Efiçencës së Energjisë për Blerjen e Produkteve Shërbimeve dhe Ndërtesave nga Institucionet e Nivelit Qendror.</p> <p>Në këtë mënyrë është të gjitha llambat Natrim Merkur dhe inkandeshente tashmë është dashur të zëvendësohen me llamba efiçente. Edhe në rastin e llambave efiçente fluoreshente, rekomandohet zëvendësimi i tyre me llamba edhe më efiçente dhe me jetëgjatësi më të madhe siç janë lampat LED</p> <p>Kjo masë synon zëvendësimin e llambave konvencionale ose atyre fluoreshente me llamba LED me qëllim të kursimit të energjisë në të gjithë rruget në pronësi të komunës. Kjo masë do të mundëson rënie të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike gjer në 60% gjer në krahasim me konsumin në vitin 2019</p>

### 9.3 FURNIZIMI ME UJË DHE SEKTORI I UJËRAVE TË ZEZA

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Studimi i sistemit të ujërave të zeza me qëllim të zbatimit të masave të EE n</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	23,000
<b>Vlerësimi i energjisë së kursyer (MWh)</b>	Nuk dihet kursimi

<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	Nuk dihet reduktimi
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës së Deçanit Buxheti nacional Donatorët, IFN
<b>Përshkrimi i shkurte/komentet</b>	Kjo masë përfshin një sërë aktiviteteve arsimore që kërkojnë ndërmarrjen e rregullt – organizimin e ngjarjeve çdo tre muaj dhe duke vepruar në pajtim me të:  Identifikimi i potencialit të zëvendësimit të pompave dhe mundësia e ramjes të lirë.  Organizimi i diskutimeve dhe ngjarje të ngjashme.  Pergaditja e projektit zbatues.

#### 9.4 MBLEDHJA E MBETURINAVE/SEKTORI I MENAXHIMIT

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2018-2020 parashe këto aktivitete

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	Subvencionimi me kontejner që krijojnë plehra organike, që ka për qëllim zvogëlimin e sasisë së mbeturinave.
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	10,000
<b>Vlerësimi i energjisë së kursyer (MWh)</b>	Nuk dihet kjo masë
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (tCO<sub>2</sub>)</b>	Nuk dihet kjo masë
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës së Deçanit Buxheti nacional Donatorët, IFN
<b>Përshkrimi i shkurte/komentet</b>	Për këtë objekt, komuna apo donatori në vitin 2023, do të buxhetojë mjete për blerjen e kontejnerëve të plastikës për kompostim, 150 kontejnerë.

--	--

## 9.5 BUJQËSIA

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Skema subvencionimit e sektorit te bujqësisë ne zëvendësimin e makineris se bujqsisë.</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	150,000
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	67 .5- Energjia elektrike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	85.6 – nga energjia elektrike
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës se Deçanit Buxheti nacional Donatoret, IFN
<b>Përshkrimi i shkurte/komentet</b>	Kjo masë përfshin një sërë aktiviteteve arsimore që kërkojnë ndërmarrjen e rregullt – organizimin e ngjarjeve çdo tre muaj dhe duke vepruar ne pajtim me të:  Identifikimi i potencialit te zëvendësimit te pompave dhe mundësia e ramjes te lir.  Organizimi i diskutimeve dhe ngjarje të ngjashme.  Pergaditja e projektit zbatues.

## 9.6 TRANSPORTI

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>41. Promovimi i modelit për shfrytëzim të përbashkët të makinave për lëvizshmëri më efikase</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023 - 2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	Kjo është një masë shumë e ndërlikuar, vlerësimi i të cilës kërkon analiza shtesë dhe zhvillimin e studimit të fizibilitetit. Kostot e investimit duhet të përfshijnë ndërtimin e parkingut (ose ndoshta garazhet), instalimin e modeli për shfrytëzimin e përbashkët të veturave, promovimin dhe prokurimin e automjeteve.
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (TJ)</b>	0.48 TJ – Benzina 0.0018 TJ – LPG - gazi 2.72 TJ – Dizeli 3.21 TJ - Totali
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	239 ton
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i Komunës së Deçanit Kreditë (BERZH, bankat komerciale)
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	Ekzistojnë më shumë se 1.000.000 vetura për shfrytëzim të përbashkët të në mbi 2000 qytete në mbarë botën. Bazuar në këto eksperiencia, është e qartë se një veture për shfrytëzim të përbashkët zëvendëson 5-8 vetura personale. Shfrytëzimi i përbashkët do të thotë përdorimi racional i automjeteve private dhe kursen para për personat të cilët nuk kanë nevojë për automjete personale (nuk kanë nevojë të blejnë veture, të paguajnë të gjitha detyrimet dhe sigurimet, mirëmbajtjen ...)  Aktivitetet e nevojshme:  Promovimi i sistemit për shfrytëzimin e përbashkët të veturave si një shërbim i thjeshtë, i cili mund të arrihet me një numër minimal të formularëve të aplikimit, i cili kërkon vetëm pagesën për kohën dhe kilometrazhin (përdorimi aktual i veturës), ku përdoruesit e regjistruar mund të ngasin veturën 24 orë në ditë, duke u regjistruar paraprakisht nga telefoni, internet ose në vendndodhje.



	Futja e sistemit të shfrytëzimit të përbashkët të veturave sjell të ardhura shtesë në komunë, qoftë nga organizatat që ofrojnë veturat në sistemit për shfrytëzimin e përbashkët të veturave, ose përmes dhënies me koncesion për ndërmarrësit e interesuar.
--	--

## 9.7 FLOTA KOMUNALE

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Prokurimi publik i gjelbër për automjetet në pronësi të Komunës së Deçanit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023 - 2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	Nevojiten analiza të mëtejme
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (TJ)</b>	Konsumi i karburanteve nuk do të ketë ndonjë zvogëlim të madh, mirëpo emisionit e gazrave serë do të zvogëlohen dukshëm
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	6
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	- Buxheti i Komunës së Deçanit
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	Hapi fillestar në zbatimin e masës është miratimi i Vendimit për kriteret e Prokurimit Publik të Gjelbër për automjetet në pronësi të komunës në emër të Kuvendit të Komunës.  Prokurimi Publik i Gjelbër për të gjitha automjetet në pronësi të komunës duhet të bazohet blerjen e veturave me emisionet të ulët të CO <sub>2</sub> . (<120g/km) ose vetura me karburant alternativ.

## 9.8 TRANSPORTI PUBLIK

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>2. Stimulimi i transportit me biçikleta në Komunën e Deçanit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030

<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	Vlerësimi i kostos për këtë masë komplekse kërkon analizë të hollësishme dhe kryerjen e studimit të fizibilitetit.
<b>Vlerësimi i energjisë së kursyer (TJ)</b>	0.11 TJ – Benzina 0.0004 TJ – LPG 0.84 TJ – Dizeli 0.95 TJ - Totali
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	71 ton
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i Komunës së Deçanit Kreditë (BERZH, bankat komerciale)
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Tërësia e masave për përmirësimin e transportit me biçikleta në Deçan, përfshinë aktivitetet vijuese:</p> <p>Vendosja e një rrjeti të biçikletave për dhënie me qira, të pajisura me IT mbrojtje kundër vjedhjes, me vend parkingje nën hije dhe ofiçina për riparime dhe njehsor të km të kaluara;</p> <p>Vendosja dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e shtigjeve të biçikletave në tërë zonën e komunës së Deçanit</p> <p>Zbatimi i këtyre masave përfshinë:</p> <p>Vendosjen dhe shënjimin e shtigjeve të biçikletave;</p> <p>Vendosja e tabelave me harta të shënuara për biçikleta;</p> <p>Zvogëlimin e numrit të aksidenteve të mundshme përmes ndarjes së shtigjeve të biçikletave nga trafiku rrugor kurdoherë që është e mundur;</p> <p>Krijimi i hapësirave nën hije (te mbuluara) për biçikleta të pajisura me video mbikëqyrje për parandalim të vjedhjeve, në afërsi të stacioneve hekurudhore ose në lokacione të tjera të përshtatshme;</p> <p>Sigurimi i serviseve për riparime dhe mbajtja e biçikletave private në vende të mbuluara;</p> <p>Blerja e biçikletave për dhënie me qira, duke pasqyruar se biçikletat duhet të jenë të pajisura me mbrojtje nga vjedhja;</p> <p>Promovimi dhe nxitja e ngasjes së të biçikletës, sidomos për distanca të shkurtra;</p> <p>Mirëmbajtja e vazhdueshme e shiritave për biçikleta në tërë rajonin e Deçanit;</p>

	Promovimi i programeve dhe edukimi mbi përparësitë e transportit me biçikleta, në kopshte të fëmijëve, në shkolla, dhe organizimi i paneleve me qytetarët.
--	--

## 9.9 AUTOMJETE PRIVATE DHE KOMERCIALE

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Promovimi i modelit për shfrytëzim të përbashkët të makinave për lëvizshmëri më efikase</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023 - 2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	Kjo është një masë shumë e ndërlikuar, vlerësimi i të cilës kërkon analiza shtesë dhe zhvillimin e studimit të fizibilitetit. Kostot e investimit duhet të përfshijnë ndërtimin e parkingut (ose ndoshta garazhet), instalimin e modeli për shfrytëzimin e përbashkët të veturave, promovimin dhe prokurimin e automjeteve.
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (TJ)</b>	0.48 TJ – Benzina 0.0018 TJ – LPG - gazi 2.72 TJ – Dizeli 3.21 TJ - Totali
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	239 ton
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i Komunës së Deçanit Kreditë (BERZH, bankat komerciale)
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	Ekzistojnë më shumë se 1.000.000 vetura për shfrytëzim të përbashkët të në mbi 2000 qytete në mbarë botën. Bazuar në këto eksperiencia, është e qartë se një veturë për shfrytëzim të përbashkët zëvendëson 5-8 vetura personale. Shfrytëzimi i përbashkët do të thotë përdorimi racional i automjeteve private dhe kursen para për personat të cilët nuk kanë nevojë për automjete personale (nuk kanë nevojë të blejnë veturë, të paguajnë të gjitha detyrimet dhe sigurimet, mirëmbajtjen ...)

	<p>Aktivitetet e nevojshme:</p> <p>Promovimi i sistemit për shfrytëzimin e përbashkët të veturave si një shërbim i thjeshtë, i cili mund të arrihet me një numër minimal të formularëve të aplikimit, i cili kërkon vetëm pagesën për kohën dhe kilometrazhin (përdorimi aktual i veturës), ku përdoruesit e regjistruar mund të ngasin veturën 24 orë në ditë, duke u regjistruar paraprakisht nga telefoni, internet ose në vendndodhje.</p> <p>Futja e sistemit të shfrytëzimit të përbashkët të veturave sjell të ardhura shtesë në komunë, qoftë nga organizatat që ofrojnë veturat në sistemit për shfrytëzimin e përbashkët të veturave, ose përmes dhënies me koncesion për ndërmarrësit e interesuar.</p>
--	--

## 10. MASAT E BRE

### 10.1 SEKTORI I BANIMIT

Numri/Masa/Emri i aktivitetit	2. Edukimi dhe promovimi i efijencës së energjisë për qytetaret e Deçanit
Autoriteti implementues	Komuna e Deçanit Shoqëria civile
Implementimi fillon/mbaron(vitet)	2023-2030
Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €	38,000
Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)	2,354 – elektrike 13,761 – termike 16,115 – total
Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO <sub>2</sub> )	3,385 – elektrike 729 – termike 4,414 – total
Financimi për implementimin e masës	Buxheti i komunës se Deçanit Buxheti nacional Donatoret (GIZ, UNDP, USAID), IFN
Përshkrimi i shkurte/komentet	Kjo mase përfshinë disa aktivitete të cilat duhet të implementohen rregullisht:

Vendosja e info kioskave EE në pjesë të ndryshme të komunës së Deçanit;

Informacioni i vazhdueshëm i konsumatorëve në lidhje me kursimin e energjisë dhe çështjet aktuale të shënohen në anën e pasme të faturave të energjisë;

Kryerja e promovimit dhe fushata informuese me tema specifike për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për efikasitet energjetik të ndërtesave:

Si duhet ndërtuar një shtëpi EE?;

Bërja e rindërtimeve në përputhje me parimet e një ndërtese të qëndrueshëm;

Certifikatat e energjisë - Konsumi i energjisë si kategori e tregut në blerjen, marrjen me qira dhe riparimin e ndërtesave;

“Ndryshimi i sjelljes së qytetarëve” drejt kursimit të energjisë

Masat për eficiencën e energjisë në ekonomitë familjare - valvulet termostatike, sistemet diellore për ngrohjen e ujit sanitar, zdrukthëtari energji-efektive, pajisje në shtëpi me etiketën e energjisë “A +++”;

Etiketa e eficiencën të energjisë - Pse të blejnë vetëm pajisje me klasë të energjisë A +++?

Pajisjet në standby konsumojnë energji elektrike! – Ç kyçni pajisjet nga prizat e rrjetit eklektik pas përdorimit;

Energji-efektive në ndriçimin e shtëpisë;

Ngrohja nga biomasa;

Kolektorët diellore;

Pompat e nxehtësisë;

Ndërtimi Inteligjente - çka është ajo?;

Çfarë është shtëpia me energjisë të vogël" (tri-litra"?)?;

Çfarë është shtëpia pasive ("një-litër"?)?;

Çka është Faktori 10?;

4. Organizimi i takimeve për promovimin e përdorimit racional të energjisë dhe për zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub>:

Kursimi i energjisë duke zbatuar masat që përfshijnë ngritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimi i grupeve të ndryshme të synuara është e vështirë të përcaktohet numerikisht. Bazuar në përvojat e qyteteve evropiane, gjer në vitin 2030 zbatimi i

	vazhdueshëm i këtyre masave duhet të rezultojë në uljen 8% të konsumit të energjisë termike dhe elektrike krahasuar me konsumin në vitin 2017.
--	--

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>2. Skema e stimulimit për renovimin e plotë të blloqeve multi-apartament (MFH).</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit ME
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	35,000 për vit; 350,000 € në total
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	196 MWh Energjia termike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO2)</b>	225
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Komuna e Deçanit - masat e politikave
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Skema e subvencionimit është e bazuar në kriterin e mëposhtme:</p> <p>Cilësia minimale termike për marrjen e subvencionit;</p> <p>Rritjen e subvencionit me përmirësimin e cilësisë termik pas rinovimit;</p> <p>Në sektorin e ndërtesave: mbështetja shtesë sociale për familjet me të ardhura të ulëta,</p> <p>Gjer tani, pjesa dominuese e ndërtesave kolektive në Deçan përbëhet nga ndërtesat shumëkatëshe. Pronarët e tyre nuk janë në gjendje të mbulojnë të gjitha shpenzimet për renovimin e plotë të ndërtesës, e kjo zakonisht është një pengesë e madhe për rinovimin ose çon në rinovimin me cilësi të ulët. Prandaj, skemat e subvencioneve janë instrumente të rëndësishme për rritjen e kualitetit të rinovimit termikë. Është vlerësuar që rreth 80 % e këtyre ndërtesave ngrohen me energji elektrike.</p> <p>Me implementimin e masave EE në mbështjellësin e ndërtesave dhe sistemin e ngrohjes, kursimet specifike të</p>

	energjisë janë 149 kWh/m <sup>2</sup> /vit, (izolimi i fasadave, izolimet e kulmeve dhe ndërrimi i dritareve).
--	--

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>3. Skema e stimulimit për instalimin e kolektorëve diellorë në 500 ndërtesat ekzistuese të banimit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	- Sektori i biznesit - Komuna e Deçanit - Agjencia për Efiçencë të Energjisë
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	586,000 € (15% nga kjo shumë do të subvencionohet, 85% do të paguhet nga pronarët e apartamenteve)
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	1,100 Energjia termike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	1,582
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës së Deçanit Donatoret Sektori privat Institucionet financiare
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	Arsyeshmëria ekonomike dhe kthimi relativisht i favorshëm për investime mund të arrihet përmes kërkesës së madhe për ujë të ngruhtë në baza ditore dhe vjetore.  Hapat e mëposhtëm janë të nevojshëm për të arritur një zbatim efikas të kësaj mase:  Subvencionet më shumë se 15%, nga buxheti komunal ose/dhe institucionet e ndryshme financiare;  Institucionet akademike dhe shkencore duhet të zhvillojnë projekte të zbatueshme për të ndihmuar prodhuesit vendor të pajisjeve;  Të themelohen dhe të akreditohen laboratorët për të testuar cilësinë e pajisjeve të prodhuara;

	<p>Të organizohet fushata informuese qe do t'iu mundëson konsumatorëve që të njihen me cilësinë e pajisjeve të ofruara dhe përfitimet nga përdorimi i tyre.</p> <p>Është llogaritur skema e stimulimit për 500 familjet me rreth 109 m2 hapësira të shfrytëzueshme. Kursimet e energjisë që rrjedhin nga këto masa janë llogaritur se do të jenë 550 kWh/m2 të sipërfaqes me kolektorë diellorë. Përfundimisht për një shtëpi tipike do të instalohen 4 m2 kolektorët diellor.</p>
--	--

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>4. Vendosja e sistemeve të ngrohjes me pellet me efikasitet të lartë të shfrytëzimit, në vend të ngrohjes me rrymë në sektorin e familjeve</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	37,500
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	Nuk ka kursim të energjisë
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	306
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë Shërbimet te energjisë ESCO
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Kjo masë ka për qëllim zëvendësimin e ngrohjes së familjeve me energji elektrike, nëpërmjet sistemeve të ngrohjes me biomasë në trajtë pelleti. Kaldajat moderne me pellet karakterizohen me efikasitet të lartë të shfrytëzimit ndërsa sa i përket emitimit pelleti konsiderohet neutral ndaj mjedisit. Një masë e tillë rekomandohet të subvencionohet nga Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë.</p> <p>Nëpërmjet kësaj mase planifikohet të zëvendësohen sistemet e ngrohjes në afërsisht 15 objekte familjare, me sipërfaqe mesatare të shfrytëzueshme rreth 109 m2 për familje.</p> <p>Zbatimi i kësaj mase deri në vitin 2030, nuk do të ketë ndikim në uljen e konsumit të energjisë por do të ketë ndikim të madh në zvogëlimin e CO<sub>2</sub> të emituar, krahasuar me emitimin nga sistemet elektrike të ngrohjes në vitin 2017.</p>



<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>5. Instalimi i llambave të cilat kursejnë energjinë në të gjitha amvisëritë në zonat e komunës së Deçanit</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Ligji i Tregut
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	Nuk ka kosto
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	3,936 MWh Energji elektrike
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	5,660
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Sektori privat
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Rregullorja e BE-së që ka të bëjë me produktet e ndriçimit (Rregullorja KE 244/2009) ka bërë ndalimin e prodhimit të llambave inkadeshente qysh në vitin 2016. Rrjedhimisht tregu si dhe fushatat e vedijësimit do të ndikojnë në zëvendësimin e llambave inkadeshente me ato eficiente.</p> <p>Duke supozuar se një amvisëri mesatarisht kursen 800kWh/vit të energjisë elektrike për ndriçim, është vlerësuar që në vitin 2017 për ndriçim janë konsumuar 4,920 MWh.</p> <p>Mesatarisht një llambë efiçiente konsumon deri në 80% më pak energji elektrike se sa llamba standarde, prandaj me zbatimin e kësaj mase deri me 2030 do të kursehen rreth 3,936 MWh.</p>

## 10.2 SEKTORI PUBLIK

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>6. Pakoja e instrumenteve për promovimin e instalimit të Fotovoltaikve solar për energji elektrike në 45 ndërtesa në pronësi të Komunës së Deçanit.</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komunës se Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	3,033,495.65

<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (kWh)/vit</b>	3,791.86kWh/vit
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (kt CO<sub>2</sub>)</b>	5.42 ktCO <sub>2</sub>
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• FKEE</li> <li>• ME</li> <li>• Shërbime te Energjisë ESCO</li> <li>• Donator</li> </ul>
<b>Përshkrimi i shkurte/komentet</b>	<p>Zbatimi i suksesshëm i projektit për furnizim me energji elektrike nga fotovoltaik do të rezultojë në rritjen e shfrytëzimit të energjisë nga BRE, duke pasur parasysh se 93% e energjisë elektrike konsumohet gjat ditës ne ndërtesat e Administrates dhe Arsimit</p> <p>Informimi i konsumatorëve në lidhje me kursimet e vazhdueshme të energjisë në rastin e instalimit të Fotovoltaikve</p> <p>Takimet për të promovuar shfrytëzimin racional të energjisë dhe zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> në rastin e instalimit të Fotovoltaikve</p> <p>Kursimet e energjisë duke implementuar masat të cilat përfshijnë ngritjen arsimore dhe vetëdijesimin e grupeve të ndryshme të fokusit.</p>

### 10.3 SEKTORI I BUJQËSISË

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>7. Skema subvencionimit e sektorit te bujqësisë me fotovoltaik.</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023-2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	100,000
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (MWh)</b>	72 .5- Energjia elektrike

<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	95.6 – nga energjia elektrike
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës së Deçanit Buxheti nacional Donatorët, IFN
<b>Përshkrimi i shkurte/komentet</b>	Kjo masë përfshin subvencionimin e sektorit të bujqësisë me PV për nevojat e tyre, për pavarësimin me energji elektrike përmes sistemit solar PV kryesisht për pompa të ujitjes, Sera dhe nevoja të shtallave.

#### 10.4 SEKTORI I TRANSPORTIT

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>8. Promovimi pikave furnizuese me energji elektrike nga PV fotovoltaike për makinat me energji elektrike.</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023 - 2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	Kjo është një masë shumë e ndërlikuar, vlerësimi i të cilës kërkon analiza shtesë dhe zhvillimin e studimit të fizibilitetit. Kostot e investimit bazhet në numrin e makinave të regjistruara në Komunën e Deçanit.
<b>Vlerësimi i energjisë së kursyer (TJ)</b>	0.48 TJ – Benzina 0.0018 TJ – LPG - gazi 2.72 TJ – Dizeli 3.21 TJ - Totali
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	239 ton
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i Komunës së Deçanit Kreditë (BERZH, bankat komerciale)
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	Vendosja e pikave furnizuese me furnizim të energjisë elektrike makinat elektrike. Keta furnizues energjisë elektrike do të marrin nga PV si BRE në parkingje të caktuara të Komunës së Deçanit etj.

#### 10.6 MASAT NDËRSEKTORIALE - NGRITJA E VETDIES, INFORMACIONI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE

<b>Numri/Masa/Emri i aktivitetit</b>	<b>1. Masat dhe aktivitetet për promovimin, informimin dhe arsimimin</b>
<b>Autoriteti implementues</b>	Komuna e Deçanit
<b>Implementimi fillon/mbaron(vitet)</b>	2023 - 2030
<b>Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €</b>	16,000 €
<b>Vlerësimi i energjisë se kursyer (TJ)</b>	0.47 TJ – Benzina 0.0018 TJ – LPG - gazi 2.91 TJ – Dizeli (nafta) 3.39 TJ - Totali
<b>Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO<sub>2</sub>)</b>	253 ton
<b>Financimi për implementimin e masës</b>	Buxheti i komunës se Deçanit Buxheti nacional Donatoret
<b>Përshkrimi i shkurtë /komentet</b>	<p>Masat dhe aktivitetet për promovimin, informimin dhe arsimimin, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së transportit dhe zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> në Deçan përfshijnë:</p> <p>Promovimi i modelit të shfrytëzimit të përbashkët të makinave për të rritur numrin e udhëtarëve;</p> <p>Informimi dhe trajnimi për mënyrat e ekologjike të vozitjes (auto-shkollat);</p> <p>Promovimi dhe përdorimi i lëndëve djegëse alternative;</p> <p>Organizimi i informatave - punëtori demonstruese për qytetarët për përdorimin e automjeteve me lëndë djegëse alternative (energji elektrike, gaz natyror, bio karburante etj.), me mundësinë e përdorimit të automjeteve me karburante alternative;</p> <p>Organizimi i paneleve, punëtorive dhe tryezave të rrumbullakëta, duke kryer sondazhe dhe hulumtime, shpërndarjen e informatave dhe materialeve promovuese etj.;</p> <p>Fushata: Biçikleta është me e shëndetshme!</p>

## 10.7 MASAT PER REDUKTIMIT TË GAZRAVE SERRË NGA VITI 2030 NË KOMUNËN E DEÇANIT

Për vlerësimin e zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> për masat e identifikuar të eficiencës së energjisë në sektorët e ndërtesave, transportit dhe ndriçimit publik në Komunën e Deçanit të shënuara në kapitullin e mëparshëm për vlerësimet mbi trendët e konsumit të energjisë dhe emisionet gjer në vitin 2030 janë zhvilluar dy skenarë:

- **Skenari pa masa** (*skenari biznes si zakonisht - BSZ*) është skenari kryesor, që tregon rritjen e konsumit të energjisë i cili mbështet në trendët e tregut dhe shprehitë e konsumatorëve, pa zbatimin sistematik të masave të eficiencës së energjisë, por mbi supozimin se produktet e reja teknologjikisht të avancuar do të shfaqen në treg me kalimin e kohës.

- **Skenari me masa** parashikon uljen e konsumit të energjisë dhe emisionet përkatëse të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030, nëpërmjet zbatimit të masave të identifikuar të eficiencës së energjisë në sektorin e ndërtesave, transportit dhe ndriçimit publik.

Parashikimet e konsumit të energjisë dhe emisionet për periudhën gjer në vitin 2030 janë bërë duke përdorur paketën e softuerit LEAP (*Sistemi i planifikimit afatgjatë i energjisë alternative*), i zhvilluar nga Instituti i Mjedisit të Stokholmit, i cili përfaqëson një vegël shumë të zhvilluar për strategjitë energjetike dhe planet me fokus në zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë. Sipas të dhënave nga Kombet e Bashkuara, më shumë se 85 vende të botës kanë zgjedhur metodologjinë LEAP për raportim në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike.

### 10.7.1 REDUKTIMIN E GAZRAVE SER GJER NE VITIN 2030 PER SKENARIN BIZNES SI ZAKONISHT(BSZ)

Skenari biznes si zakonisht (skenari pa masa) është skenari bazë i cili supozon rritjen e konsumit të energjisë në përputhje me tendencat e tregut dhe shprehive të konsumatorëve, pa zbatimin sistematik të masave të eficiencës së energjisë, por duke supozuar zbatimin e produkteve të reja të avancuar teknologjikisht dhe shërbimeve në dispozicion në treg në periudhën gjer në vitin 2030.

Parashikimi i konsumit të energjisë dhe emisionet relevante të CO<sub>2</sub> në Komunën e Deçanit për skenarin BSZ gjer në vitin 2030 janë kryer për tri sektorët e analizuara të konsumit të energjisë:

- Sektori i transportit;
- Sektori i ndërtesave;
- Sektori i ndriçimit publik.

Sipas vlerësimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin referent 2017, komuna e Deçanit në atë vit ka pas 41,808 banorë. Në përputhje me trendin aktual të lëvizjes sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë dhe parashikimin e numrit të popullsisë në nivel kombëtar të Kosovës, sipas variantit të mesëm, numri i banorëve në Komunën e Deçanit në vitin 2030 pritet të jetë 43,700 banorë.

## 10.8 VLERËSIMI I EMISIONI TË CO2 NË VITIN 2030 PËR SEKTORIN E TRANSPORTIT

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të PVEKQ-s, për vlerësimin e emisioni të CO2 gjer në vitin 2030 për skenarin BSZ, sektori i transportit është i ndarë në nënsektorët e mëposhtme:

- Auto parku në pronësi të komunës;
- Transporti publik;
- Automjetet personale dhe komerciale të regjistruara në komunë.

Siç është përmendur tashmë, konsumi i karburanteve dhe emisionet e CO2 të llojeve të caktuara të automjeteve për skenarin pa masa janë llogaritur nga modeli LEAP. Projektioni i flotës të automjeteve në pronësi të komunës është vlerësuar duke supozuar se pjesa e emisioneve nga ky sektor është e barabartë me pjesën në vitin 2017.

Për më tepër, është supozuar se parametrat tjerë (distanca e udhëtimit, kategoritë e shpejtësisë, temperatura, etj.) të nevojshme për llogaritjen janë të njëjta si parametrat e përdorura në llogaritjen e emisioneve për vitin bazë 2017.

Duke pasur parasysh shfrytëzimin e përbashkët të veturave të pasagjerëve në vitin 2017 dhe parashikimin e popullsisë së komunës gjer në vitin 2030 bazuar në dokumentin përkatës të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i përgjithshëm i automjeteve në nënsektorin e automjeteve personale dhe komerciale (Tabela 28) është vlerësuar të jetë 7,667 automjete.


**Tabela 28. Vlerësimi i strukturës dhe numri i automjeteve në nënsektorin e automjeteve personale dhe komerciale në vitin 2030**

	Numër i automjeteve në 2017	Pjesëmarrja e llojit të caktuar të automjetit në 2017 (%)	Numri i automjeteve në 2030
Moped dhe motoçikleta	73	1.59	122
Automjete të udhëtarëve	3,631	78.93	6052
Automjete për shumë destinime	272	5.91	453
Automjete për detyra dhe shërbime	138	3.0	230
Automjete komerciale (kamionë nën dhe mbi 3.5 ton)	360	7.83	600
Automjete të tjera (makina të punës, traktor, kombajna)	126	2.74	210
<b>Numri total i automjeteve</b>	<b>4,600</b>	<b>100,00%</b>	<b>7667</b>

Konsumi i energjisë dhe emisionet shoqëruese të CO2 gjer në vitin 2030 për skenarin BSZ, të përcaktuara duke përdorur modelin LEAP, janë të paraqitur në Tabelën 29

**Tabela 29. Parashikimet e konsumit të energjisë dhe emisionet shoqëruese të CO2 në vitin 2030 për skenarin pa masa për sektorin e transportit**

Sektori i transportit Skenari BSZ	Konsumi i energjisë (TJ)		Emisionet ne vitin 2030
	2017	2030	t CO <sub>2</sub>
<b>Flota e automjeteve në pronësi të Komunës</b>			
Benzina	0.08	0.10	6.9
Dizeli	4.40	7.00	528.9
<b>GJITHESEJT</b>	<b>4.38</b>	<b>7.10</b>	<b>535.8</b>
<b>Transporti publik</b>			
Benzina	0.0	0.00	0.0
Dizeli	4.07	6.40	483.6
LPG - gazi	0.0	0.00	0.0
<b>GJITHESEJT</b>	<b>4.07</b>	<b>6.40</b>	<b>483.6</b>
<b>Automjetet personale dhe komerciale</b>			
Benzina	15.19	24.00	1660.0
Dizeli	142.61	225.50	17,037.8
LPG - gazi	0.52	0.70	43.8
<b>GJITHESEJT</b>	<b>158.32</b>	<b>250.20</b>	<b>18,741.6</b>
<b>SEKTORI I TRANSPORTIT - GJITHESEJT</b>	<b>166.77</b>	<b>263.70</b>	<b>19,761</b>



*Fig 16 Konsumi i energjisë dhe emisionet shoqëruese*

Në rast të dështimit të ndërmarrjes së masave për eficiency e energjisë, emisionet e CO<sub>2</sub> nga sektori i transportit në Komunën e Deçanit në vitin 2030 do të rriten nga **12,985.42 tCO<sub>2</sub>** gjer

në **19,761 tCO<sub>2</sub>**, ose do të jenë **52.2 %** më të lartë se emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin 2017 si viti referent.

#### 10.8.1 VLERËSIMI I EMISIONEVE TË CO<sub>2</sub> GJER NË VITIN 2030 PËR SEKTORIN E NDËRTEHAVE

Duke përdorur modelin LEAP në bazë të rezultateve të analizave të konsumit të energjisë në vitin referentë 2017 dhe tendencat e pritshme të konsumit të energjisë në vitin 2030, parashikimet janë bërë për skenarin BSZ në sektorin e ndërtesave në Komunën e Deçanit. Emisionet e CO<sub>2</sub> nga konsumi i burimeve të ndryshme të energjisë në sektorin e ndërtesave në vitin 2017 dhe parashikimi i emisioneve të CO<sub>2</sub> nga konsumi i energjisë në vitin 2030 janë paraqitur në Tabelën 30 dhe 31.

**Tabela 30. Emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin referues 2017 për burimet e energjisë dhe nënsektorët në sektorin e ndërtesave**

Nënspektori	Emisionet CO <sub>2</sub> (t), 2017				
	Energjia elektrike	Dizeli	Lignit	LPG -gazi	<b>GJITHESEJT</b>
Ndërtesat në pronësi të komunës	684.01	148.05	0.00	0.00	<b>832.06</b>
Spektori i shërbimeve dhe komercial	13,823.66	1,612.50	4,327.91	1,004.68	<b>20,768.75</b>
Spektori banimi - amvisëritë	28,487.59	1,070.95	711.07	465.68	<b>30,735.30</b>
<b>GJITHESEJT</b>	<b>42,995.26</b>	<b>2,831.50</b>	<b>5,038.99</b>	<b>1,470.37</b>	<b>52,336.11</b>






Fig 17. Emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin referues 2017 për burimet e energjisë dhe nënsektorët në sektorin e ndërtesave

**Tabela 31. Parashikimet e emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për skenarin pa masa për sektorin e ndërtesave**

Nënsektori	Emisionet CO <sub>2</sub> (t), 2030				
	Energjia elektrike	Dizeli	Lignit	LPG -gazi	<b>GJITHESEJT</b>
Ndërtesat në pronësi të komunës	713.97	154.40	0.00	0.00	<b>868.37</b>
Sektori i shërbimeve dhe komercial	14,417.96	1,681.53	4,513.46	1,047.92	<b>21,660.87</b>
Sektori banimi - amvisëritë	29,714.40	1,117.02	741.55	485.80	<b>32,058.77</b>
<b>GJITHESEJT</b>	<b>44,846.33</b>	<b>2,952.95</b>	<b>5,255.01</b>	<b>1,533.71</b>	<b>54,588.00</b>

Gjithsejtë emisionet e CO<sub>2</sub> nga sektori i ndërtesave ne Komunën e Deçanit në vitin 2017 ishin **52,336.11 t CO<sub>2</sub>**. Në rast të dështimit për të ndërmarrë masat e efijencës së energjisë, emisionet e CO<sub>2</sub> nga sektori i ndërtesave në vitin 2030 do të rritet në **54,588.00 tCO<sub>2</sub>** ose do të jenë **4.3%** më të larta se emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin 2017 si viti referent.




Fig 18. Emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për burimet e energjisë dhe nënsektorët në sektorin e ndërtesave

#### 10.8.2 VLERËSIMI I EMISIONEVE TOTALE TË CO<sub>2</sub> GJER NË VITIN 2030 NË SKENARIN BSZ

Përcaktimi i parashikimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për të gjithë tri sektorët e konsumit të energjisë në Komunën e Deçanit: transporti, ndërtesat dhe ndriçimi publik, është bërë duke përdorur modelin kompjuterik LEAP. Parashikimi i tillë është bërë duke konsideruar që faktorët e emisionit të CO<sub>2</sub> nga burimet prezente energjetike janë identike me ato të përdorura në përgatitjen e Inventarit të Baze për vitin 2017 dhe me supozimin që faktorët e emisioneve indirekte të CO<sub>2</sub>, të cilat ndryshojnë nga viti në vit për shkak të mënyrës së prodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes, janë pothuajse identike me faktorët e shfrytëzuar për përgatitjen e inventarit bazë.

Tabela 32. jep një pasqyrë të inventarit të emisioneve totale në vitin 2030 sipas sektorëve të konsumit të energjisë për skenarin pa masa.

Tabela 32 Parashikimi i rritjes së përgjithshme të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 sipas sektorëve të konsumit të energjisë për skenarin pa masa

Skenari	Sektori	Emisioni, t CO <sub>2</sub>		% e krahasuar me 2017
		2017	2030	
Skenari BSZ	Transporti	12,985.42	19,761	52.2 %
	Ndërtesat	52,336.15	54,588.00	4.3 %
	Ndriçimi publik	323.46	419.5	29.7 %
	<b>GJITHESEJT</b>	<b>65,645.04</b>	<b>75,084</b>	<b>14.4 %</b>

Gjithsejste emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin 2030 në Komunën e Deçanit, sipas skenarit BSZ do të arrijnë në **75.1 ktCO<sub>2</sub>**, që krahasuar me vitin 2017, do të jetë një rritje prej **9.4 kt CO<sub>2</sub>** apo **14.4%**.

### 10.8.3 VLERËSIMI I EMISIONI TË CO<sub>2</sub> GJER NË VITIN 2030 PËR SKENARIN ME MASA

Skenari me masa, merr parasysh uljen e konsumit të energjisë dhe emisionet e CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 nëpërmjet zbatimit të gjitha masave të identifikuar të efikasitetit të energjisë për transport, ndërtesa dhe sektorët e ndriçimit publik të paraqitura në Kapitullin 9.

Masat janë të ndara në nënsektorë dhe për çdo masë janë llogaritur kursimet potenciale dhe zvogëlimi i emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 në krahasim me vitin referues 2017.

### 10.8.4 VLERËSIMI I EMISIONEVE TË CO<sub>2</sub> GJER NË VITIN 2030 PËR SEKTORIN E NDËRTESAVE

Vlerësimi i zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 në sektorin e ndërtesave për skenarin me masa është kryer duke përdorur të dhënat nga modeli LEAP duke vlerësuar zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> për secilën nga masat e propozuara në Kapitullin 9.2.

Sipas metodologjisë së përshkruar, vlerësimi i zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 për skenarin me masa në sektorin e ndërtesave sipas nënsektorëve, për çdo masë të identifikuar është paraqitur në Tabelën 10.7.

**Tabela 10.7** Zvogëlimi i emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 për skenarin me masa në sektorin e ndërtesave për secilën masë.

SEKTORI I NDËRTESAVE		Reduktimi i CO <sub>2</sub> (ton)
<b>Masat e përgjithshme</b>		
1	Edukimi dhe ndryshimi i sjelljeve të punëtorëve / shfrytëzuesve të ndërtesave në pronësi të komunës së Deçanit	41.90
2	Edukimi dhe promovimi i efikasitetit të energjisë për qytetarët e Deçanit	4,414.00
3	Pakoja e instrumenteve për promovimin e instalimit të kolektorëve solar për ngrohjen e ujit	0.00
4	Rrjeti këshillues për energjinë – Qendrat informative për efikasitetin e energjisë	0.00
5	Edukimi dhe trajnimi i mëtutjeshëm për profesionistët e energjisë	0.00
6	Skema e certifikimit për ndërtesa	189.00
<b>TOTAL nënsektori</b>		<b>4,644.90</b>
<b>Ndërtesat në pronësi të komunës dhe të kompanive publike</b>		
7	Instalimi i kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit në ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit	41.00
8	Modernizimi i sistemit të ndriçimit në 400 klase në institucionet arsimore në pronësi të Komunës së Deçanit	35.00
9	Instalimi i termometrave në çdo dhomë të objekteve në pronësi të Komunës së Deçanit	3.00
10	Izolimi termik i fasadave dhe kulmeve në 45 ndërtesa në pronësi të Komunës së Deçanit	65.50
11	Vendosja e dritareve me performancën të lartë dhe energji-efikase në 25 ndërtesa në pronësi të Komunës së Deçanit	30.00
12	Instalimi i valvulave termostatike në radiatorë në të gjitha ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit	3.00
13	Futja e kriterëve të prokurimit publik të gjelbër për blerjen e pajisjeve elektrike në ndërtesa në pronësi të Komunës së Deçanit	102.00
14	Instalimi i llambave për kursimin e energjisë në ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit	43.00
15	Ndërrimi i kaldajave të vjetra ekzistuese me lëndë djegëse të ngjashme, me kaldaja të reja eficiente me biomasë në ndërtesat në pronësi të komunës	23.00
16	Futja në përdorim të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Energjisë në ndërtesat në pronësi të komunës	32.00
<b>TOTAL nënsektori</b>		<b>377.50</b>
<b>Ndërtesat në sektorin e banimit</b>		
17	Skema e stimulimit për renovimin e plotë të blloqeve multi-apartament (MFH)	225.00
18	Skema e stimulimit për instalimin e kolektorëve diellorë në 500 ndërtesat ekzistuese të banimit	1,582.00
19	Vendosja e sistemeve të ngrohjes me pellet me efikasitet të lartë të shfrytëzimit, në vend të ngrohjes me rrymë në sektorin e familjeve	306.00
20	Instalimi i llambave të cilat kursejnë energjinë në të gjitha amvisëritë në zonat e komunës së Deçanit	5,660.00
<b>Ndërtesat në sektorin komercial dhe të shërbimeve</b>		<b>7,773.00</b>
21	Promovimi i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Energjisë në sektorin komercial dhe të shërbimeve	347.00
22	Promovimi i potencialit për subvencionimin e ndërtesave të cilat janë afër Zero Konsumit të Energjisë - NaZE	104.00
23	Vendosja e sistemeve të ngrohjes me pellet me efikasitet të lartë të shfrytëzimit, në vend të ngrohjes me rrymë në sektorin komercial dhe të shërbimeve	4,070.00
24	Vendosja e sistemeve të ngrohjes me pellet me efikasitet të lartë të shfrytëzimit, në vend të ngrohjes me linjtë në sektorin komercial dhe të shërbimeve	2,921.00
25	Vendosja e sistemeve të ngrohjes me pellet me efikasitet të lartë të shfrytëzimit, në vend të ngrohjes me dizel në sektorin komercial dhe të shërbimeve	938.00
26	Subvencionet për përdorimin e burimeve të ripërtërishe të energjisë në sektorin ekzistues komercial dhe të shërbimeve	556.00
27	Instalimi i llambave për kursimin e energjisë në ndërtesat e sektorit komercial dhe të shërbimeve	2,074.00
28	Miratimi i rregulloreve komunale për të stimuluar përdorimin e burimeve të ripërtërishe të energjisë për ndërtesat e reja në sektorin komercial dhe të shërbimeve	833.00
<b>TOTAL nënsektori</b>		<b>11,843.00</b>
<b>TOTAL SEKTORI I NDËRTESAVE</b>		<b>24,638.40</b>

Zbatimi i të gjitha masave të propozuara në Kapitullin 9.2 do të rezultojë në reduktimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> sipas kategorisë dhe nënsektorët e dhëna në tabelën 33.

**Tabela 33 Reduktimi i emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 për skenarin me masa në sektorin e ndërtesave për nënsektorët**

Sektori i ndërtesave sipas nënsektorëve	Zvogëlimi i pritur i CO <sub>2</sub> (kt)
Masat e përgjithshme	4,64
Ndërtesat në pronësi të Komunës	0.38
Sektori banimi - amvisëritë	7.77
Sektori i shërbimeve-komerciale	11.84
<b>GJITHSEJTË – SEKTORI I NDËRTESAVE</b>	<b>24.64</b>

Sipas Inventarit të Baze të Emisioneve (Kapitulli 7), emisionet e CO<sub>2</sub> në sektorin e ndërtesave në vitin 2017 arrijnë në **52.3 ktCO<sub>2</sub>**. Zbatimi i të gjitha masave të propozuara në Kapitullin 9.2 do të rezultojë në reduktim të emisioneve të CO<sub>2</sub> deri në **24.64 ktCO<sub>2</sub>** dhe do të arrijnë në vlerën **27.66 ktCO<sub>2</sub>**, e qe është ulje prej **47.11%**.

#### 10.8.5 VLERËSIMI I EMISIONI TË CO<sub>2</sub> GJER NË VITIN 2030 PËR SEKTORIN E TRANSPORTIT

Vlerësimi i zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 në sektorin e transportit për skenarin me masat është kryer duke përdorur të dhënat nga modeli LEAP duke vlerësuar zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> për secilën nga masat e propozuara në Kapitullin 9.3.

Sipas metodologjisë së përshkruar, vlerësimi i zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 për skenarin me masa në sektorin e transportit sipas nënsektorëve për çdo masë të identifikuar është paraqitur në Tabelën 10.9.

**Tabela 10.9** Zvogëlimi i emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 për skenarin me masat e sektorit të transportit për secilën masë

SEKTORI I TRANSPORTIT		Reduktimi i CO <sub>2</sub> (ton)
<b>Masat e ligjore dhe plaifikimi</b>		
29	Politika e parkingut në Komunën e Deçanit	246
30	Masat për përmirësimin e fluksit të trafikut në Komunën e Deçanit	87
31	Masat për përmirësimin e sigurisë në trafik	75
32	Ndërtimi i parkingjeve për makina në hyrjet e qytetit (pjesa periferike)	373
33	Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta nëpër qendër të komunës	75
34	Ndërtimi i pikave të parkimit për biçikleta dhe mopedë	37
<b>TOTAL</b>		<b>893</b>
<b>Promovimi, informimi dhe masat arsimore</b>		
35	Masat dhe aktivitetet për promovimin, informimin dhe arsimimin	253
36	Promovimi i përdorimit të karburanteve alternative	112
37	Fushata informuese për mënyrën efiçiente të ngasjes	262
38	Fushata me moton: “Një dite në javë pa makina”	247
<b>TOTAL</b>		<b>874</b>
<b>Automjetet në pronësi/të përdorura nga Komuna e Deçanit</b>		
39	Prokurimi publik i gjelbër për automjetet në pronësi të Komunës së Deçanit	6
<b>TOTAL</b>		<b>6</b>
<b>Transporti publik</b>		
40	Stimulimi i transportit me biçikleta në Komunën e Deçanit	71
<b>TOTAL</b>		<b>71</b>
<b>Automjetet private dhe komerciale</b>		
41	Promovimi i modelit për shfrytëzim të përbashkët të makinave për lëvizshmëri më efikase	239
42	Promovimi i zëvendësimit të automjeteve të vjetra	373
<b>TOTAL</b>		<b>612</b>
<b>TOTAL-SEKTORI I TRANSPORTIT</b>		<b>2456</b>

Sipas Inventarit Baze të Emisioneve (Kapitulli 7), emisionet e CO<sub>2</sub> nga sektori i transportit në vitin 2017 arrijnë në **12.99 kt CO<sub>2</sub>**. Zbatimi i të gjitha masave të propozuara në Kapitullin 9.3

do të rezultojë në reduktim të emisioneve të CO<sub>2</sub> për **2.46 ktCO<sub>2</sub>** dhe do të arrijnë në vlerën **10.53 ktCO<sub>2</sub>** që është ulje prej **19%**.

#### 10.8.6 VLERËSIMI I EMISIONEVE TOTALE TË CO<sub>2</sub> NGA VITI 2030 NE SKENARIN ME MASA

Parashikimet e emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për të tre sektorët e konsumit final të energjisë në Komunën e Deçanit: transport, ndërtesa dhe ndriçimin publik janë të vendosur duke përdorur faktorët e emisionit të njëjta si për përgatitjen e IEB.

Tabela 10.11 jep një pasqyrë të inventarit të emisioneve totale në vitin 2030 sipas sektorëve të konsumit të energjisë për skenarin me masa.

**Tabela 34 Krahasimi i emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2017 dhe 2030 sipas sektorëve të konsumit të energjisë për skenarin me masat**

Skenari	Sektori	Emisioni, kt CO <sub>2</sub>		% krahasuar me 2017
		2017	2030	
Skenari me masat	Transporti	12.99	10.53	-19
	Ndërtesat	52.3	27.66	-47.11
	Ndriçimi publik	0.33	0.2	-39.4
	<b>TOTAL</b>	<b>65.6</b>	<b>38.39</b>	<b>-41.5</b>

Totali i emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 në Komunën e Deçanit sipas skenarit me masa do të arrijnë në **38.39 kt CO<sub>2</sub>**, që krahasuar me vitin 2017, shënon një rënie prej **27.21 kt CO<sub>2</sub>** ose **41.5%**.

Zbatimi i të gjitha masave të identifikuar do të rezultojë në zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në vitin 2030 për sektorin e ndërtesave gjer në 48.11 %, në sektorin e transportit me 19 % dhe ndriçimin publik me 39.4 %. Emision i përgjithshëm për skenarin me masa në vitin 2030 në krahasim me emisionet bazë në vitin 2017 do të jetë **41.5 %** më i ulët, kështu që mund të konkludohet se objektivi i planifikuar për zvogëlimin e CO<sub>2</sub> për së paku **40%** gjer në vitin 2030 dot të përmbushet në rast të zbatimit të masave të për përmirësimin e efijencës së energjisë të parapara në këtë dokument.


#### 10.8.7 KRAHASIMI I PROJEKSIONEVE TË EMISIONEVE TË CO<sub>2</sub> NË VITIN 2030 NË BAZË TË SKENARËVE

#### 10.8.8 KRAHASIMI I PROJEKSIONEVE TË EMISIONEVE TË CO<sub>2</sub> NË VITIN 2030 NË BAZË TË SKENARËVE PËR SEKTORIN E NDËRTESAVE

Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 në bazë të skenarëve për sektorin e ndërtesave është dhënë në tabelën 10.12 dhe Figurën 10.12.

**Tabela 35. Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për sektorin e ndërtesave për dy skenarë**

Skenari	Emisioni, kt CO <sub>2</sub>		% e krahasuar me 2017
	2017	2030	
Skenari pa masa	52.3	54.6	+4.4
Skenari me masa	52.3	27.66	-47.1



*Figura 19 Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për sektorin e ndërtesave për dy skenarë*

Në rast të dështimit për të ndërmarrë masat e efijencës së energjisë, emisionet e CO<sub>2</sub> nga sektori i ndërtesave në vitin 2030 do të rriten në **54.6 kt CO<sub>2</sub>** ose do të jenë **4.4 %** më të larta se emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin 2017.

Nëse gjatë periudhës dhjetë vjeçare gjer në vitin 2030, do të zbatohen të gjitha masat e identifikuar në Kapitullin 9. 2, emisionet e CO<sub>2</sub> në sektorin e ndërtesave në vitin 2030 do të reduktohet me **47.1 %**.

#### 10.8.9 KRAHASIMI I PROJEKSIONEVE TË EMISIONEVE TË CO<sub>2</sub> NË VITIN 2030 NË BAZË TË SKENARËVE PËR SEKTORIN E TRANSPORTIT

Krahasimi i parashikimeve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 në bazë të skenarëve për sektorin e transportit është dhënë në tabelën 10.13.

**Tabela 36. Krahasimi i parashikimeve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për sektorin e transportit për të dy skenarët**

Skenari	Emisioni, kt CO <sub>2</sub>		% e krahasuar me 2017
	2017	2030	
Skenari pa masa	12.99	19.76	+34
Skenari me masa	12.99	10.53	-19

Në figurën 10.1 janë krahasuar skenarët e emitimit të CO<sub>2</sub> për nësektorët e transportit duke konsideruar që i tërë reduktimi i emitimit të CO<sub>2</sub> si rezultat i masave ligjore, të promovimit dhe të informimit reflektohet në sektorin e automjeteve personale dhe komerciale.




Fig 20 Krahasimi i parashikimeve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për sektorin e transportit për të dy skenarët




Figura 21: Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për sektorin e ndërtesave për të dy skenarët

Në qoftë se konsumi i energjisë në sektorin e transportit do të lihet trendëve të tregut pa zbatimin sistematik të masave të efijencës së energjisë, emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin 2030 do të rriten me 34%.

Në rastin e zbatimit sistematik të masave të propozuara, emisionet e CO<sub>2</sub> nga sektori i transportit në vitin 2030 do të jenë 31.69% më të ulëta se në vitin 2017.


**10.4.4 Krahasimi i parashikimeve të përgjithshme të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 në bazë të skenarëve**

Krahasimi i parashikimeve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për të gjitha tri sektorët e konsumit final të energjisë në Komunën e Deçanit për dy skenarë është dhënë në Tabelën 10.15.

**Tabela 37 Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për skenarin BSZ dhe skenarin me masat**

Skenari	Sektori	Emisionet ktCO <sub>2</sub>		% e krahasuar me 2017
		2017	2030	
Skenari pa masa	Transporti	12.99	19.76	+34
	Ndërtesat	52.3	54.6	+4.4
	Ndriçimi publik	0.33	0.419	+26.1
	<b>TOTAL</b>	<b>65.6</b>	<b>75.08</b>	<b>+14.4</b>
Skenari me masa	Transporti	12.99	10.53	-19
	Ndërtesat	52.3	27.66	-47.1
	Ndriçimi publik	0.33	0.2	-39.4
	<b>TOTAL</b>	<b>65.6</b>	<b>38.39</b>	<b>-41.5</b>

Potenciali i përgjithshëm i zvogëlimit të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për Komunën e Deçanit është **27.21 ktCO<sub>2</sub>**. Sektori i ndërtesave është sektori me potencialin më të madh për reduktimin e emisioneve, të cilat arrijnë në **26.64 kt CO<sub>2</sub>**, i ndjekur nga sektori i transportit me **2.46 kt CO<sub>2</sub>** dhe sektori i ndriçimit publik me **0.13 kt CO<sub>2</sub>**.





*Fig 22 Krahasimi i projeksioneve të emisioneve të CO<sub>2</sub> në vitin 2030 për skenarin BSZ dhe skenarin me masat*

Emisionet ne skenarin BSZ në vitin 2030 do të arrijnë në **75.08 ktCO<sub>2</sub>**, ndërsa zbatimi i të gjitha masave do reduktojë emisionet e CO<sub>2</sub> në vitin 2030 në **38.39 ktCO<sub>2</sub>**. Mund të konkludohet se ulja e përgjithshme e Inventarizimit në vitin 2030 mund të jetë **41.5 %** në krahasim me vitin bazë.

## 11. PLANI I VEPRIMIT

Bazuar ne gjendjen ekzistuese te analizuar situatën në fushën e efijencës së energjisë dhe përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Komunën e Deçanit dhe në konsultim me personat përkatës përgjegjës për këto fusha në komunë, janë propozuar projektet vijuese me prioritet për zbatimin në periudhën nga viti 2023 deri në vitin 2030. Kjo nuk përjashton mundësinë e hapjes edhe për projekte të tjera, por fokusi është vënë në projektet e vijuese, shih tabelën më poshtë

### 11.1 ZBATIMI I MASAVE TË POLITITKAVE LOKALE, TË PROMOVIMIT DHE NDRYSHIMIT TË SHPREHIVE E SJELLJES

Nr.	Masa e efijencë të energjisë	2023		2024	2025
		Burimi i financimit [euro]		Burimi i financimit [euro]	
		Komuna bashkëfinancim		Komuna bashkëfinancim	Tjetër
1.	Menaxhimi i energjise		Pa koste GIZ		
2.	Permisimi i shërbimeve përmes identifikimit te potencialit te masave te EE dhe BRE	30,000.00			
3.	Fushate informuese per masa te EE dhe BRE				50,000.00
<b>Përmbledhje</b>		<b>30,000.00</b>			<b>50,000.00</b>

Si total për tri vite pritet të investohen rreth 80,000.00 Euro na ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve për menaxhim të energjisë dhe informimit potencialin e kursimit të energjisë dhe BRE.

#### 11.2 ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK

Nr	Masat e eficiency së energjisë	2023	2024	2025
1	Zbatimi i masave të EE në ndriçim publik dhe ndriçim të ndërtesave	1.89 mi.€		
2	Zbatimi i masave të EE në Pallatin e Kulturës -	313,272.08€		
3	Zbatimi i masave të EE në “Esad Mekuli” Maznik	47,962,99€		
4	Zbatimi i masave të EE dhe BRE në ndërtesat në pronësi të Komunës		1.53mil. €	1.5mil. €
5	Zbatimi i masave të EE dhe BRE në QKMF			207,900.00€
6	Zbatimi i masave të EE “Sylejman Vokshi” Prejlep,			52,280.00€
7	Zbatimi i masave të EE “Ardhmeria” Beleg			43,200.00€
8	Zbatimi i masave të EE “Syle Alaj” Drenoc			234,000.00€
9	Zbatimi i masave të EE dhe BRE në KK Deçan			57,000.00€
Total		5,827,652.00 €		

Si total për tri vite e ardhshme pritet të investohen rreth 5,827,652.00 milion Euro.

#### 11.3 ZBATIMI I MASAVE NË BUJQËSI

Nr	Masat e eficiency së energjisë	2023	2024	2025
1	Subvencionimi me zëvendësim të makinerisë bujqësore	-	75,000	75,000
2	Skema subvencionimit të sektorit të bujqësisë me fotovoltajk.	-	50,000	50,000
Total		250,000 €		

#### 11.4 ZBATIMI I MASAVE NË TRANSPORT

Nr	Masat e eficiency së energjisë	2023	2024	2025
1	Studimi i fzbilitetit për shtigje të biciklave	-	30,000.00	
Total		30,000.00 €		

#### 11.4.1 AUTOMJETET KOMUNALE

Nr	Masat e efijencës së energjisë	2023	2024	2025
1	zbatimi i masave të EE në transport përmes zëvendësimit të flotës komunale	-	210,000.00	210,000.00
Total		420,000.00 €		

#### 11.4.2 TRANSPORTI PUBLIK

Nr	Masat e efijencës së energjisë	2023	2024	2025
1	Promovimi i modelit për shfrytëzim të përbashkët të makinave për lëvizshmëri më efikase	-	50,000	50,000
Total		100,000 €		

### ZBATIMI I MASAVE NE SEKTORIN E BANIMIT

Numri/Masa/Emri i aktivitetit	3. zbatimi i masave të EE në sektorin e banimit
Autoriteti implementues	Komuna e Deçanit
Implementimi fillon/mbaron(vitet)	2023-2030
Vlerësimi i kostos (matni pjesën individuale ose vlerësimin e gjithëmbarshtëm) €	21,306,048.00
Vlerësimi i energjisë së kursyer (MWh)	31,770,990
Vlerësimi i zvogëlimit të (t CO <sub>2</sub> )	4,055
Financimi për implementimin e masës	Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë Donator Komuna
Përshkrimi i shkurtë /komentet	Termo izolimi shtëpive ose ndërtesave kolektive Zëvendësimi i dritareve Zëvendësimi i paisjeve elektroshtepiake jo eficient me ato eficient

## **12. MONITORIMI DHE RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E PVKEK/PLANIT TË VEPRIMIT**

Monitorimi, kontrolli dhe raportimi i vazhdueshëm mbi zbatimin e planit të veprimit është komponent i rëndësishëm.

Monitorimi dhe raportimi i PKVEK ve behet ne AKEE/ME. Raportimi ne Konveten e Kryetarev behet vetëm nëse Komuna anëtarësohet ne Konveten e Kryetareve.

Raporti i tillë duhet të përfshijë një inventar të përditësuar të monitorimit të emetimeve (MIE). Autoritetet lokale inkurajohen të përpilojnë inventarë të emetimeve të CO2 në baza vjetore, megjithatë nëse autoriteti vendor konsideron se inventarë të tillë të rregullt vënë shumë presion mbi burimet njerëzore ose financiare, mund të vendosë të kryejë inventarët në intervale më të mëdha.

Bazuar ne ligjin per EE Komunat obligohen te raportojnë cdo vjet me se largu deri me 30 mars për masat e implementuara ne AKEE, me crast do te raportohet dhe monitorohet e inventari i emetimeve.

Raportimi i Veprimit përmban kryesisht informacion cilësor në lidhje me zbatimin e PVKEK, duke përfshirë barrierat e hasura gjatë zbatimit, statusin e zbatimit të secilit veprim, etj. Raportimi i plotë, përmes MIE, lejon analizimin e evolucionit për sa i përket konsumit të energjisë, prodhimit të energjisë nga BRE dhe emetimet e CO2 duke përcaktuar masat korrigjuese dhe parandaluese kur kjo kërkohet.

### **12.1 MENAXHIMI I ENERGJISË KOMUNALE (MUND TË PËRDORET NGA SKEMA E MENAXHIMIT TË ENERGJISË, E PËRGATITUR NGA GIZ) - PVKEK**

Komunat kanë rol të rëndësishëm në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe reduktimin e gazrave me efekt serrë nga sektori i energjisë nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit të energjisë. Kjo mund të bëhet përmes menaxhimit më të mirë të energjisë në nivel komunal, duke filluar me objektet që janë në përgjegjësi të drejtpërdrejtë të komunës.

Pra, për menaxhim të mirë të energjisë komunat duhet të kenë një kontroll të organizuar, të strukturuar, sistematik dhe të përhershëm të parametrave të rrjedhjes së energjisë brenda objekteve të tyre, duke filluar nga blerja e energjisë, përmes procesit të transformimit, e deri në shfrytëzimin përfundimtar të energjisë si dhe raportimin për nevojat e institucioneve qendrore dhe më tej. Prandaj për të ndërtuar një sistem të menaxhimit të energjisë, i cili duhet të behet pjesë integrale menaxhimit të energjisë në nivel vendi, duhet të këtë kuadër dhe strukturë organizative me përgjegjësi brenda një komunë të caktuar për arritjen e qëllimeve të politikës energjetike të vendosur sipas dokumenteve strategjike dhe planeve.

Sistemi i Menaxhimit të Energjisë do të ndihmojë komunën për të:

- Krijuar dhe përditësuar një Bazë të Dhënash të Konsumit të Energjisë në nivel komune;
- Menaxhuar në mënyrë aktive konsumin dhe koston e energjisë;
- Zvogëluar ndotjen në mjedis pa ndikuar negativisht tek funksionimi dhe cilësia e shërbimeve për komunitetin;
- Përmirësuar në vazhdimësi efikasitetin e përdorimit të energjisë;

- Evidentuar mundësitë e kursimeve si për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm (p.sh. kreditimi i emetimeve).

Me qëllim të zhvillimit të sistemit të menaxhimit të energjisë, GIZ ka mundësuar aplikimin e instrumenteve si MVP (Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit) dhe ENMA Soft (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë).

Softueri ENMASOFT, mundëson krijimin e bazës së të dhënave, përpunimin e tyre si dhe raportimin lidhur me progresin në fushën e EE. Për përdorimin e këtij instrumenti GIZ ka organizuar trajnim për zyrtarët komunal përfshi edhe komunën e Deçanit

Zbatimi i suksesshëm i planit Komunal të Deçanit për EE kërkon angazhim të palëve të interesuara. Në mënyrë që të arrihet kjo, është e nevojshme që të kryhet një analizë e sektorit për të përcaktuar sfidat dhe masat e nevojshme si dhe përfitimin e njohurive të cilat duhet të zhvillohen dhe komunikohen tek palët e interesuara. Që të zbatohet në mënyrë të suksesshme plani i EE dhe që të nisë kursimi i energjisë dhe përmirsimi i shërbimeve komunale, komuna e Deçanit duhet të fokusohet në këto çështje kryesore:

- Aprovimi i PVKEK nga asamableja komunale, ashtu që ky plan të jetë obligativ për t'u zbatuar;
- Zhvillimi dhe promovimi i mekanizmave financiar të qëndrueshëm të EE përmes të cilëve do të mundësohen investimet në fushën e EE, dhe me këtë të arrihen kursimet e energjisë;
- Ngritja e kapaciteteve brenda komunës dhe fuqizimi i një njësie të veçantë (Zyra për energji) e cila do të jetë përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të planit EE dhe raportimin lidhur me progresin te strukturat tjera brenda komunës dhe jashtë saj.

## 12.2 KOORDINIMI – PVKEK

Aktualisht në komunën e Deçanit është i emëruar menaxheri për energji i cili po kryen të gjithë punën e koordinimit brenda komunës dhe me institucione jashtë saj si me ME. Megjithatë për zbatimin e suksesshëm të planit të EE është me rëndësi që të krijohen kapacitetet institucionale, me krijimin dhe funksionalizimin e Zyrës Komunale të Energjisë në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 09/2017, do krijoheshin rrethana më të volitshme sa i përket procesit të menaxhimit me energji dhe koordinimit të të gjitha aktiviteteve rreth energjisë, përfshi koordinimin me donatorë në zbatim të projekteve të planifikuara me plan.

Deri në krijimin e zyrës për energji, Meaxheri i energjisë shërben si koordinator për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me energji. Ai koordinon punët me drejtoritë relevante brenda komunës, institucionet qendrore dhe donatorët e jashtëm.

## 12.3 RAPORTIMI

Raportimi për aktivitetet në fushën e energjisë si dhe për realizimin dhe përparimin e këtij Plani duhet të bëhet brenda hierarkisë komunale si dhe në nivelin qendror.

Tabela 0-1 Kompleksiteti në procesin e raportimit dhe metodologji

KATEGORIA	INDIKATORET	Kompleksiteti i mbledhjes së të dhënave 1 - I thjeshtë 2 – I mesëm 3 - Kompleks	Vegla monitorimi
TRANSPORTI	Numri i udhëtarëve në vit	1	Përzgjedhja e rrugëve të autobusëve që do të monitorohen
	Gjatësia e shtigjeve të biçikletave në komunë	1	Komuna
	Gjatësia e shtigjeve në komunë	1	Komuna
	Numri i automjeteve që kalojnë pikën e kontrollit në vit/muaj (përcaktimi i rrugës në të cilën do të bëhen matjet)	2	Instalimi i sporteleve të automjeteve në pikën e kontrollit (nstreet)
	Konsumi total i energjisë së automjeteve në pronësi të Komunës së Deçanit	1	Të dhënat e sakta nga faturat e karburantit me shndërrimin e tyre në kWh
	Konsumi total i energjisë së automjeteve për transportin e udhëtarëve, duke përdorë lëndë djegëse alternative	1	Të dhënat nga faturat e karburantit të konvertuara në kWh
	Përqindja (%) e banorëve të komunës që kanë qasje të favorshme në transportin publik	3	Realizimi i anketës me banorët në pjesët e paracaktuara të Komunës
	Kilometrat mesatarë gjatë bllokimeve ditore të trafikut në Komunë	2	Analiza e rrjedhës së trafikut në pjesët e paracaktuara të Komunës
	Sasia vjetore e lëndëve djegëse fosile dhe alternativat e shitura në pompat e para të benzinës të përcaktuara në pjesë të ndryshme të Komunës	1	Marrëveshje me stacionet e gazit të paracaktuara për mbledhjen dhe shpërndarjen e vazhdueshme të të dhënave

NDËRTESTASAT	Konsumi total i energjisë në ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit	1	Krijimi i sistemit të informacionit për mbledhjen e të dhënave
	Metra katrorë të kolektorëve diellorë të instaluar në komunën e Deçanit	3	Të dhëna për dhënien e subvencioneve dhe kredive për instalimin e kolektorëve diellorë (nëse ka). Një studim i kryer në pjesët e paracaktuara të Komunës.
	Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike në shtëpi	1	Të dhënat nga shpërndarësi komunal i energjisë elektrike
	Numri i auditimeve të energjisë të kryera në ndërtesat publike	1	Të dhënat nga ME ose Zyra Komunale e Energjisë
	Numri i ndërtesave publike në Komunë	2	Të dhënat e siguruara nga ME dhe Urbanizëm ose nga Zyra Komunale e Energjisë
	Numri i biomasës që mund të instalohet në Komunë	2	Të dhënat nga sektori i Prokurimit ose Zyra Komunale e Energjisë
SEKTORI PËR NDRIÇIMIN PUBLIK të Qytetit	Numri i instaluar i llambave të lehta për energji efektive dhe ekologjikisht miqësore/vit	2	Të dhënat nga sektori i Prokurimit ose Zyra Komunale e Energjisë
	Konsumi vjetor i energjisë në sektorin e ndriçimit publik	1	Të dhënat nga sektori i shërbimeve publike ose Zyra Komunale e Energjisë
Kompanitë e ujit	Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike
	Konsumi i përgjithshëm i karburantit		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike
	Gjithsej m <sup>3</sup> ujë të furnizuar		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike
Menaxhimi i mbeturinave	Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike

	Konsumi i përgjithshëm i karburantit		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike
	Total ton mbeturina të grumbulluara dhe të përpunuara në deponi		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike
	Total ton mbeturina të ndara në burim		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike
Bujqësia	Sipërfaqja e tokës së re të pyllëzuar		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike
	Sipërfaqja e tokës së re të shpyllëzuar		Të dhëna nga sektori i shërbimeve publike
Sektori i Shërbimeve	Numri i subjekteve juridike të regjistruara për shërbime të ndryshme energjetike, kompani ESCO, prodhues dhe shpërndarës të pajisjeve diellore, etj. në zonën e komunës	2	Regjistri i subjekteve tregtare në Komunë
QYTETARË	Numri i qytetarëve të Komunës që marrin pjesë në ngjarje të ndryshme të lidhura me energjinë (forume diskutimi, punëtori, seminare)	1	Organizimi i 4 seminareve tematike në vit në fushën e efizienzës të energjisë, përdorimit të Bres, ndërtesave të qëndrueshme, etj.
	Numri i ngjarjeve të organizuara energjetike për vetëdijesimin e publikut	1	Të dhëna nga shërbimet publike dhe ME, për ngjarjet që promovojnë EE (p.sh. fushata EE, spote në radio, etj.)
PROKURIM PUBLIK I GJELBËR	Përzgjedhja e kategorive të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve me efikasitet energjetik (p.sh. llambat e kursimit të energjisë në ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit)	2	Monitorimi dhe krahasimi i performancës dhe sasia e llambave të ndriçimit të blera për ndërtesat në pronësi të komunës së Deçanit

	Tokë e zhveshur	Toke e mbjellë
--	-----------------	----------------



tCO <sub>2</sub> /ha <sup>2</sup>	975-1050	868-900

## 12.4 MONITORIMI DHE RAPORTIMI I BRENDSHËM - PVKEK

Sipas legjislacionit në fuqi, definohet forma e monitorimit dhe raportimit brenda komunës.

- Komunat monitorojnë rregullisht zbatimin e planit dhe arritjen e objektivave të kursimit të energjisë. Për këtë qëllim, komunat duhet të krijojnë dhe menaxhojnë një informacion të sistemit mbi mbledhjen e të dhënave mbi konsumin e energjisë në ndërtesat komunale dhe të monitorojnë kursimet e realizuara nga zbatimi i masave në ndërtesat publike, duke përdorë platformën e bazuar në faqen zyrtare të internetit për raportim, monitorim dhe verifikim Platforma (MVP).
- Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga marrja e raportit, ME/ME vlerëson progresin e arritur, vlerëson nevojat dhe propozon masa përmirësuese ose të tjera për zbatimin në nivel lokal. Bazuar në vërejtjet e ME/ME, Komunat ndryshojnë, nëse kërkohet, Planin Komunal të Energjisë dhe Klimës për periudhën e mbetur për zbatim

## 12.5 RAPORTIMI TE QEVERIA QENDRORE (KEEA)- (MVP- SOFTWARE)- PVKEK

Sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 09/2017, për Zyrat Komunale të Energjisë - Zyrat Komunale të Energjisë bashkëpunojnë me Ministrinë, ME-në dhe komunat, si dhe institucionet e tjera përkatëse në mënyrë që të koordinojnë punën dhe aktivitetet për planifikimin dhe zbatimin e politikave të energjisë në nivel lokal.

Sipas të njëjtit Udhëzim Administrativ, zyrat komunale të energjisë do të përgatisin dhe dorëzojnë raporte periodike dhe vjetore në DKA, si dhe informacione të tjera sipas kërkesës, për çështjet brenda përgjegjësisë së tyre.

Çdo vit dhe jo më vonë se më 30 prill, Kuvendi Komunal miraton dhe i paraqet ME-së raportin e progresit për zbatimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (që do të përcaktohet) për vitin paraprak. Komunat duhet të përdorin një platformë të veçantë softuerike dhe/ose faqe të të dhënave për raportim. Platforma e Monitorimit dhe Verifikimi ofrohet nga KEEA.

## 13. MODELI DHE BURIMET E FINANCIMIT TË ZBATIMIT TË MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERJISË - PVKEK DHE PVKEK

Komuna e Deçanit ka në dispozicion mundësi të mira për financimin e masave dhe aktiviteve të propozuara në bazë të këtij plani nga të hyrat e veta, në formën e granteve nëpërmjet instrumenteve të ndryshme financiare ndërkombëtare, grantet nga niveli qendrorë i qeverisë

<sup>2</sup> [PA00KWWK.pdf \(usaid.gov\)](#)

dhe nëpërmjet mekanizmave të huamarrjes në koordinim me Ministrinë e Financave e cila është aktori kryesorë për miratimin e huamarrjeve të tillë.

Me qëllim të përfitimit të përkrahjes financiare të nevojshme për realizimin e PVKEK, komuna duhet të ngritjen e kapaciteve njerëzore dhe institucionale, me qëllim të përgatitjes së projekteve për të aplikuar në kuadër të programeve të ndryshme. Për të përmbushur këtë parakusht, në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë, Komuna e Deçanit është duke ndërtuar kapacitetet njerëzore përmes krijimit të strukturës së komunës në kuadër të administratës komunale, në veçanti zyra për energji e cila do të merret me çështjet e energjisë-efiçences së energjisë në nivel komunal. Kjo strukturë do të mbështetë zyrën komunale për zhvillimin e projekteve për të zhvilluar projektet dhe planet ideore, do të monitorin zbatimin dhe rezultatet e tij në përputhje me kërkesat e parashtruara.

### 13.1 FINANCIMI ME BUXHETIN KOMUNAL

Buxheti i Komunës së Deçanit është i përbërë nga të hyrat vetanake, grantet qeveritare, dhe potencialisht prej huamarrjes nga bankat komerciale. Totali i buxhetit komunal për vitin 2022 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në kuadër të buxhetit kombëtar të konsoliduar për Komunën e Deçanit është përafërsisht. 21.3 mil €.

Bazuar në ndarjen e të hyrave komunale vetanake dhe granteve kombëtare, të hyrat vetanake paraqesin rreth 12% të buxhetit total të komunës të cilat janë mbledhur nga burimet e mëposhtme:

- Taksat dhe tatimet komunale në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të lejeve për ndërtesa/konstruktim;
- Taksat komunale, licencat dhe lejet, certifikatat dhe dokumentet e tjera zyrtare, taksa për automjete, etj;
- Taksat dhe tatimet komunale për veprimtaritë ekonomike të bizneseve të vogla, të ardhurat nga qiraja, restorantet, kafenetë dhe shërbime të tjera;
- Taksat dhe tatimet tjera të parapara me ligj.

Me ligjin për vetëqeverisjen lokale 03/L-040 dhe ligjin për financimin e qeverisjes lokale 03/L-049, komunat janë të autorizuar që në mënyrë të pavarur të krijojnë të hyra për të financuar funksionet ekskluzive nën juridiksionin e tyre.

Qeveria qendrore siguron fonde për komunat për ti përmbushur kërkesat për sigurimin e funksioneve të përbashkëta dhe të deleguara posaçërisht në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Granti i qeverisë është i përbërë nga granti i përgjithshëm, granti i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe granti për arsim.

Strukturat ekzistuese të buxhetit përfshijnë të gjitha burimet dhe shpenzimet e fondeve. Struktura e të ardhurave dhe financimit janë paraqitur më poshtë.

### 13.2 FINANCIMI NGA BUXHETI I QEVERISË QENDRORE

Instrumentet kryesore për financimin e projekteve nga buxheti i qeverisë janë si më poshtë:

- Huamarrja dhe Angazhimet Komunale (Huamarrja Komunale dhe Angazhimet Afatgjata)

- Instrumentet financiare kombëtare - Transfertat qeveritare
- Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë

### 13.3 FINANCIMI NGA DONATORËT DHE KREDIT

Disa nga donatorët potencialë nga të cilët mund të kërkohet financimi i projektit janë:

- Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor- WBIF
- Lehtësimi i financimit të drejtpërdrejtë të energjisë nga Ballkani Perëndimor (WeBSEDF);
- GIZ - Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore (ORF)
- Banka Evropiane e Investimeve (EIB)
- Banka Gjermane për Rindërtim (KfW)
- Banka Botërore
- ESCO Kompanit
- FKEE
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
- USAID,
- Millennium Foundation Kosova (MFK)
- Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë etj.

### 13.4 FINANCIMI NGA BE-

Disa nga donatorët potencialë nga të cilët mund të kërkohet financimi i projektit janë:

- Fondet IPA (Instrumentet për Ndhmën e Paraanëtarësimit), janë mjetet me të cilat BE mbështet vendet partnere me ndihmë financiare dhe teknike
- TAIEX (Ndihma Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit) është një instrument i BE-së që ndihmon vendet partnere të familjarizohen me ligjet e BE-së, t'i zbatojnë dhe t'i jetësojnë ato, si dhe të monitorojnë përparimin e tyre. TAIEX financon ndihmë teknike afatshkurtër nga kolegët përmes këshillimit dhe trajnimit, kryesisht në 3 mënyra:
  - punëtori të ndjekura nga zyrtarë të administratave përfituese;
  - misione ekspertësh që japin këshilla të hollësishme për administratat përfituese;
  - vizita studimore në administratat e vendeve të BE-së.

## 14. PËRMBYLLJE

Qëllimi kryesor i Planit të Energjisë dhe Klimës të Komunës është identifikimi i masave të mundshme për zvogëlimin e konsumit të energjisë në nivel komunal, zvogëlimin e emetimit të CO<sub>2</sub> për të përmbushur objektivat kombëtare, si dhe zbatimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

Të gjithë sektorët dhe nënsektorët e mbuluar nga ky plan duhet të përshkruhen duke përfshirë konsumin total të energjisë për secilin sektor, zvogëlimin e emetimit të CO<sub>2</sub> me zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë dhe BRE.

Përshkrim i shkurtër i masave të identifikuara për zvogëlimin e emetimit të CO<sub>2</sub> mund të paraqiten për:

Sektorin e ndërtimit (Ndërtesa banimi, ndërtesa në pronësi të Komunës, ndërtesa të shërbimeve publike, etj.)

Sektori i bujqësisë

Sektori i transportit (Flota komunale, transporti publik, automjetet private dhe komerciale, etj.)

## 15. REFERENCA

Referencat përkatëse për mbledhjen e të dhënave dhe përfundimin e raportit që do të paraqiten në këtë kapitull:

- Planet Zhvillimore Komunale
- Plani i Efikasitetit të Energjisë në Komunën e Deçanit 2015-2020
- Plani Komunal për Energji të Qëndrueshme 2019-2030
- Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit

### **Konkluzionet dhe rekomandimet**

Qëllimi kryesor i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshëm në Komunën e Deçanit është që të identifikohen masat konkrete për sektorët e konsumit të menjëhershëm të energjisë në nivel komunal, realizimi i të cilave do të rezultojë në zvogëlimin e emisionit të CO<sub>2</sub> për së paku 40% gjatë vitin 2030, krahasuar me vitin 2017 si vit bazë. Metodologjia për zhvillimin e Planit të Veprimit është në përputhje me përmbajtjen e draft Planit Kombëtarë për Energji dhe Klimë

Sektorët e konsumit të menjëhershëm të energjisë në nivel komunal, përfshijnë: ndërtesat, transportin dhe ndriçimin publik. Analizat e detajuara të energjisë përkatëse dhe Inventarit të Emisioneve Bazë (IEB) për vitin 2017, janë zhvilluar për secilin sektor. Për më tepër, IEB i Komunës së Deçanit është bërë në përputhje me Protokollin e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimin e Klimës (PPNNK).

Në mënyrë që të kryhet analiza e detajuar e energjisë, sektori i ndërtesave është ndarë në tri nënsektorët e mëposhtme:

- Ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit;
- Objektet e banimit (amvisëritë);
- Objektet komerciale dhe të shërbimeve në Deçanit.

Sektori i transportit ka tre nënsektorë:

- Autoparku në pronësi të Komunës së Deçanit;
- Transporti publik në Komunë;
- Automjetet personale dhe komerciale.
- Sektori ndriçimi publik nuk ka nënsektorë.

Për sektorët e lartpërmendur dhe nënsektorët, janë mbledhur parametrat e nevojshëm të energjisë për vitin 2017, dhe në bazë të tyre janë kryer analiza të detajuara të energjisë. Konsumi total i energjisë prej sektorëve përkatës në Komunën e Deçanit është **907 TJ**, nga të cilat **739.86 (81.53%)** është shpenzuar në sektorin e ndërtesave, e ndjekur nga sektori i transportit me konsumin prej **166.77 TJ (18.38%)** dhe ndriçimi publik me **0.81 TJ (0.09%)**.

Energjia nga druri (**519.83 TJ**) është energjia me përqindjen më të madhe në sektorin e ndërtesave, ndërkohë që sektori i transportit konsumon kryesisht naftë (**150.97 TJ**) benzinë (**15.27 TJ**) dhe Gaz **0.52 TJ**.

Emision i përgjithshëm i inventarit është **65.6 kt CO<sub>2</sub>**. Burimi më i madh emisionit, dhe burimi i konsumit të energjisë, është sektori i ndërtesave me emisionet që arrijnë në **52.3 kt CO<sub>2</sub>**, i pasuar nga sektori i transportit me emisionet prej **12.99 kt CO<sub>2</sub>** dhe ndriçimi publik me **0.3 kt CO<sub>2</sub>**.

Bazuar në analizën e kryer për energjinë dhe situatën aktuale në Deçan, masat e identifikuar janë ndarë në tri grupe kryesore:

- Masat për zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> në sektorin e ndërtesave;
- Masat për uljen e emisioneve të CO<sub>2</sub> në sektorin e transportit;
- Masat për zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> në sektorin e ndriçimin publik.

Sa i përket sektorit të ndërtesave, janë identifikuar gjithsej 28 masa për uljen e konsumit të energjisë dhe emisionit të CO<sub>2</sub> si vijon me poshtë:

- Masat e përgjithshme - 6 masa;
- Ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit - 10 masa;
- Objektet e banimit (amvisëritë) - 4 masa;
- Objektet komerciale dhe të shërbimeve – 8 masa.

Masat e identifikuar për sektorin e transportit të Komunës së Deçanit (14), janë ndarë në kategoritë e mëposhtme:

- Masat ligjore dhe të planifikimit – 6 masa;
- Masat promovuese, informuese dhe arsimore - 4 masa;

- Automjetet në pronësi/në shfrytëzim nga Komuna e Deçanit - 1 masë;
- Transporti publik - 1 masë;
- Automjetet private dhe komerciale - 2 masa;

Në sektorin e ndriçimit publik është identifikuar 1 masë e cila do të përcillet me kursim të energjisë dhe reduktim të emitimit të CO<sub>2</sub>.

Realizimi i të gjitha masave të propozuara në të tri sektorët e analizuar të konsumit të energjisë në Komunën e Deçanit do të rezultojnë në zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> gjer në 41.5 % në raport me emisionet në vitin bazë 2017. Duke pasur parasysh se qëllimi indikativ është reduktimi për së paku 40%, nënkupton që në për realizimin e planit aktual të veprimit ekziston një fleksibilitet i votël i cili lejon mundëson e zgjedhjes së disa e masave më të pranueshme. Masat e identifikuar janë prezantuar në tabela me parametrat e mëposhtëm:

- Titulli dhe numri i masës;
- Autoriteti zbatues;
- Afati kohor i zbatimit (në fillim dhe në fund);
- Kostot e vlerësuara (Euro);
- Kursimi i vlerësuar i energjisë (MWh ose TJ);
- Reduktimi i emisioneve potenciale të (tCO<sub>2</sub>);
- Instrumente financiare në dispozicion për implementim (kombëtare ose ndërkombëtare);
- Përshkrim i shkurtër/komenti.

Në përgjithësi, dhjetë rekomandimet themelore për arritjen e zbatimit maksimal të efijencës së PVKEK-s janë:

- Të sigurohet mbështetja e numrit sa më të madh të aktorëve si (organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare);
- Ndërtimi i strukturës organizative për zbatimin e PVKEK-s bazuar në njohuritë dhe aftësitë;
- Krijimi i skemës së suksesshme për grumbullimin e vazhdueshëm të treguesve të kërkuar energjetike për secilin nënsektor;
- Krijimi i menaxhimit sistematik të energjisë në ndërtesat në pronësi të Komunës së Deçanit;
- Identifikimi i burimeve financiare kombëtare dhe ndërkombëtare në dispozicion për zbatimin e PVKEK-s. Buxheti i komunës duhet të jetë opsioni i fundit, nëse fare nuk ka burime të tjera financiare;
- Të përgatiten projekte kualitative për energji të qëndrueshme në të gjithë sektorët dhe nënsektorët e energjisë në nivel komunal: Një projekt i mirë do të gjene gjithmonë investitorët e tij !;
- Hartimi i Inventari i cili rregullisht do të përcjell emisionet në nivelin komunal;
- Zbatimi i masave të propozuara në mënyrë sistematike dhe të përgjegjshme;

- Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të PVKEK-s në mënyrë sistematike dhe me përgjegjësi;
- Informimi me kohë dhe përfshirja e palëve të interesuara dhe qytetarëve të Komunës së Deçanit në lidhje me gjithë procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të PVKEK-s.

Hapat më të rëndësishëm që duhet të ndiqen për ndërtimin e strukturës së suksesshme organizative për zbatimin e PVKEK janë:

- Sigurimi i burimeve të nevojshme (njerëzore, materiale, pajisjeve, etj.) për zbatimin e masave;
- Emërimi i koordinatorit të procesit për përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e PVKEK-s;
- Caktimi i Këshillin Komunal të Energjisë si organ këshillues profesional;
- Caktimi i grupit punues për zbatimin e PVKEK-s;
- Identifikimi i mekanizmave optimale kombëtare ose ndërkombëtare të financimit për secilën prej masave të planifikuara.

Koordinatori i procesit të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të Planit të Veprimit duhet të jetë një person nga administrata komunale, i cili ka njohuri të mëdha për çështjet e energjisë në kuadër të administratës komunale. Koordinatori është figura kyçe në zbatimin e Planit të Veprimit, i cili i merr të gjitha vendimet e rëndësishme nga fillimi, dhe i cili propozon themelimin e të gjitha grupeve punuese dhe organeve monitoruese të nevojshme për zbatim. Këshilli komunal i energjisë duhet të mbledh ekspertë të njohur me përvojë të madhe dhe vizion.

Rekomandimet për të siguruar burimet e nevojshme financiare për të zbatuar masat e identifikuar janë në vijim:

- Krijimi i Trupit Koordinues të Komunës së Deçanit për të siguruar mbështetje profesionale për zyrat komunale, departamentet dhe institucionet për të aplikuar për fondet në dispozicion;
- Organizimi i seminareve trajnuese për punonjësit e zyrave administrative, departamenteve dhe institucioneve komunale për mekanizmat e financimit në dispozicion dhe mënyrat e aplikacioneve të suksesshme për këto fonde;
- Informimi i vazhdueshëm i zyrave komunale, departamenteve dhe institucioneve për mundësitë financiare (fonde të brendshme dhe programet e BE-së, etj.);
- Të behet analiza e informacionit të mbledhur për mundësitë e identifikuar për të aplikuar dhe ti dërgojnë ato në zyrat përkatëse komunale, departamentet dhe institucionet;
- Monitorimi i vazhdueshëm dhe raportimin tek autoritetet komunale në lidhje me rezultatet dhe problemet dhe pengesat e mundshme të identifikuar dhe për eliminimin e tyre me kohë;
- Monitorimi sistematik dhe raportimi mbi zbatimin e projekteve të BE-së që synojnë përmirësimin e dinamikës dhe performancës.

Bazuar në situatën energjetike në Komunë, analizat e kryera të energjisë dhe dokumentet zyrtare të Komunës, rekomandimet e synuara për zbatimin e suksesshëm të këtij Plani të Veprimit përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:

- *Themelimi i menaxhmentit të projektit për çdo masë individuale në kuadër të Komunës* - duhet të krijohet ekipi përgjegjës për zbatimin e projektit për secilën masë të propozuar në Planin e Veprimit. Organizimi i menaxhimit të projektit në nivelin e masës do të sigurojë ekspertin e nevojshëm dhe burimet teknike për zbatimin e suksesshëm të asaj mase;
- Menaxhimi i të dhënave të mbledhura në mënyrë sistematike për energjinë në komunë;
- Organizimi i vazhdueshëm i ngjarjeve të shumta informative dhe edukative për promovimin e efikasitetit të energjisë për grupe të ndryshme të qytetarëve - Ditët e energjisë në komunë, , Ditët e lëvizshmërisë (qarkullimit)- E në komunë, etj.
- *Menaxhimi i suksesshëm financiar për zbatimin e PVKEK-s* - Bashkëpunimi i mirë i Trupit Koordinues me zyrat komunale, departamentet dhe institucionet në mënyrë që të identifikohen strukturat optimale financiare për zbatimin e masave të identifikuar - së bashku me mbështetjen e publikut është e nevojshme të marrin në konsideratë përfshirjen sa më të madhe të mekanizmave të tregut përmes modeleve SPK dhe PPP për projekte komerciale të qëndrueshme;
- *Themelimi dhe monitorimi sistematik i treguesve të identifikuar të efikasitetit të energjisë në Komunë* - numrin e auditimeve energjetike të kryera dhe certifikatat e energjisë të lëshuara; numri i ngjarjeve të rëndësishme arsimore dhe informative dhe numrin e pjesëmarrësve; Numri i dokumentacioneve të përgatitura të projekteve; Numri i autobusëve me bionaftë, etj.;
- *Vazhdimi i të gjitha aktiviteteve*, qëllim të ndërtimit të një Komune me energji të qëndrueshme të bazuar në mbrojtjen e mjedisit, efikasitetin e energjisë dhe burimet e ripërtërishme të energjisë si parakushte të rëndësishme për rritjen e cilësisë së jetës të gjithë qytetarëve të saj.

Zbatimi i masave të propozuara do të mundësojë energji të drejtpërdrejtë dhe kursime financiare, do të zvogëlojë efektet e dëmshme, do të përmirësojë cilësinë e jetës, dhe do ta rrit nivelin e përgjegjësisë dhe vetëdijen mes qytetarëve, e cila është angazhimi strategjik dhe qëllimi i politikës së qeverisë së përgjegjshme në Komunën e Deçanit.